

Fragment nga libri me kujtime “Jeta ime me Jakovin”, shkruar nga bashkëshortja e shkrimtarit, Dhurata Xoxa, botuar nga “Buzuku”, Prishtinë

DHURATA XOKA Si u njoha me Jakovin, burrin tim të ardhshëm



Si e përjetova lajmin për ikjen e mësuesit dhe mikut tim të madh Rexhep Qosja

Qosja, Një Monument.

Nga Agim Vinca

Rexhep Qosja nuk është një individ, por një institucion. Me ikjen e tij mbyllet një epokë në letërsinë dhe kulturën shqiptare, por edhe në jetën tonë kombëtare: “Epoka Qosja”. Njeri me energji të pashtershme krijuese dhe me përkushtim të madh ndaj punës krijuese, letrare dhe shkencore, për të mund të thuhet se krijoi një Vepër, pa të cilën nuk mund të imagjinohet kultura shqiptare e gjysmës së dytë të shekullit XX dhe e çerekut të parë të këtij shekulli.

(fq. 13)

Ironia dhe estetika në romanet e Rexhep Qosjes

Nga Shefkije Islamaj

Shkrimtari Rexhep Qosja nuk shkruan për ta argëtuar lexuesin, por për ta përfshirë në ato që ndodhin në botën artistike të romaneve të tij, në të vërtetë ai shkruan për ta ndryshuar lexuesin. Dhe, arma e tij e fuqishme për këtë qëllim të lartë është pikërisht ironia.

(fq. 10)



SHËNIME MBI LIBRAT

Proza e Zija Çelës

GROTESK DHE IRONI MADHËRISHT LETRARE

Nga Bashkim Kuçuku (fq. 5)

Mbi romanin “Brenja” të Pashko R. Camajt
Romani “Brenja”, xën vendin
e vet të merituem në letërsinë
shqipe-memuaristike

Nga Lisandri Kola (fq. 6)

UNIVERSI LETRAR I NDUE UKAJT: NDËRGEGJJA NË KOHË KRIZASH

Nga Granit Zela (fq. 7)

Vëllimi me novela “Gruaja e ambasadorit” të
Arbër Ahmetaj, “RL Bruksel”, 2026
Një kuartet demonësh të fatit

Nga Agron Tufa (fq. 9)

Besim Golemi iku, duke
lënë pas bojërat, penelat,
kanavacat

Nga Fatbardh Amursi (fq. 8)

Letra më e vjetër
e dashurisë në botë,
e dashuruar pas
540 vjetësh, zbulon
dilemën: dashuria
kundrejt parave

(fq. 22)

“Anna Ahmatova”

Ese nga
Aleksander Solzhenicin

Botimi, përgatitja e tekstit,
shënimi hyrës nga bashkëshortja
e shkrimtarit (fq. 20)

Natalia Dimitrievna Solzhenicina



BIBLIOTEKË

Irena Dragoti (fq. 14)

Gratë e moshës sime

Enton Bido (fq. 16)

Vdekja e mësueses

Faruk Myrtaj (fq. 17)

Prej avujve, sapo
kishin mësuar...

Sally Rooney (fq. 18)

Njerëz normalë

Përktheu: Andreas Dushi

Natsume Soseki (fq. 23)

Vigjilja e Njëqind Viteve

Përktheu: Artemisa Kuznetsova

Arben Meksi (fq. 24)


Karikatura e së shtunës

Romani i një dashurie të madhe,
të penguar dhe tragjike.
Ribotohet “Frosina e Janinës”
e shkrimtares Mira Meksi (fq. 16)

Libri shqip
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta
brenda SHBA-së

www.albibris.al



BEOGRADI

Ishte fillimdhjetori i vitit 1947.

Ne, një grup rinjsh, vajza e djem, po niseshim për studime në Beograd. Ishim mbledhur te porti i Durrësit dhe prisnim të na thërrisnin emrat, për të hyrë mandej në anijen që do të na çonte në një botë tjetër, larg vendit tonë. Familjarët qëndronin pranë portit dhe na shoqëronin me sy mallëngjyes. Disa prej tyre nuk i mbajtën as lotët. Ishin çaste plot trishtim dhe mallëngjim.

Ndonëse i jepnim zemër njëri-tjetrit, sërish beteja e ndarjes bëhej dominuese.

– Po mos bëni kështu! Mos derdhni lot! Nuk po i nisim për luftë, për studime po shkojmë! Të ditur do të kthehen! – dëgjohej ndonjë zë tek-tuk, që përpiqej të qetësonte të tjerët.

– Po, sigurisht, s'po nisen për keq! – përgjigjeshin disa.

– Pushoni ju andej, – u dëgjua një zë i fortë. – Po thërrasim emrat! Andromaqi Hajdari. Hip në anije! – Kështu lista vijoi me të tjerët, si Piro Naçe, Agllai Zoto, Despina Siliqi, Janko Nishku, Dhurata Tako, Shpresa Gega, Kthansipi Vavako, Margarita Shenkalli, Jakov Xoxa, Skënder Begeja, Kthansipi Mulliqi, etj...

Secili nga ne që dëgjonte emrin, merrte valixhen e ç'të kish me vete dhe ngjitej ngadalë shkallëve të anijes, duke kthyer kokën dhe vështrimin orë e çast andej nga ishin njerëzit tanë, të cilët na shikonin, duke na përshëndetur, sa me duar e me shami, apo ç'të kishin tjetër nëpër duar.

Anija vinte e vogël dhe ngjante më shumë me një maune të madhe transporti, ku secili nga ne ngjiste shkallët e saj, futej në një derë dhe zhdukej menjëherë në thellësi të saj.

Në kuvertë na prisnin dy marinarë, që na drejtonin për te një sallë, e cila, siç dukej, shërbente edhe për të grumbulluar pasagjerët. Ingjante një salle, rrethuar nga të katërta anët me tryeza, të ngulura në dysheme e me stola të gjatë anash.

U ulëm mbi to dhe mbështetëm bërrylat mbi disa tryeza të gjata, vendosur përpara stolave.

Të gjithë flisnim gati njëherësh, duke bërë më shumë zhurmë sesa bisedonin, të mbërthyer tek impresionet e para. Për të gjithë ishte hera e parë që lundronin jashtë shtetit, e me anije. Mua më vajtën sytë të tryezat. Mbi to kish mbeturina të vogla thërrimesh e ndonjë njollë e lehtë vaji.

– Siç duket, do të kenë ngrënë marinarët pak më përpara, – foli Andromaqi, e cila ishte afër meje dhe kish ndjekur vështrimin tim, – Me sa duket, këtu duhet të jetë mensë.

– Hë?! – ia ktheu një djalosh i cili rrinte pranë saj. Dukej që s'e kishte mendjen aty.

– Kovi, – dëgjova një zë tjetër djali pas shpine, – për studime po shkojmë. Mos rri i mërzhitur! E ku ka si jeta e studentit! Do ta shohësh! –

– Jo, o Pipi, por më vjen ligsht për prindërit! – u përgjigj ai, që u quajt Kovi.

– E po s'kanë faj! Lekoja, yt vëlla për studime, ti po kështu...! Mamaja e para, e di si ndihet...! – foli qetë Pipi. – Po Lekoja yt vëlla, në Europë?

– Po, po, Lekoja në Francë, për mjekësi –

Ndërkohë, atypërreth nesh po mblidheshin edhe të tjerë dhe u bëmë një grup me dje e vajza që sa vinte e rritej. Mbërrinte dikush duke hequr zvarrë ndonjë stol të vetmuar, të tjerë uleshin te karriget apo tryezat, ndërsa anija edhe aty ku ishte në port, lëkundej e jo pak.

– Mos u mërzhit! – foli një tjetër. – Nëna juaj do të jetë e lumtur një ditë për ju... –

– Po, vërtet, Kovi! E kush është si ajo! – i dha kurajë Despina, që ishte përballë meje.

– Keni të drejtë, – foli përsëri Jakovi. – Por, eh ta dinit ju si na ka rritur... Lindi nëntë fëmijë dhe i mbetëm vetëm ne të dy! I griu malaria... – dhe sytë iu lëngëzuan.

– Sa keq! – po mendoja, ashtu siç isha ulur gati përballë tij e që pa dashur i vura re sytë në të lotuar.

– E po, do na bëhesh shkrimtar ti, Kovi...! – e mbylli gëzuar Pipi.

Kur dëgjova "shkrimtar", ngrita kokën dhe e vështrova me kureshtje. Mendova, mos ishte

Fragment nga libri me kujtime "Jeta ime me Jakovin", shkruar nga bashkëshortja e shkrimtarit, Dhurata Xoxa, botuar nga "Buzuku", Prishtinë

DHURATA XOXA

Si u njoha me Jakovin, burrin tim të ardhshëm

gjë Jakov Xoxa?

Ai qeshi, por mendjen prapëseprapë s'e kishte aty. Pastaj foli ngadalë:

– Për fat, u mbetëm ne të dy, – vazhdoi Jakovi. – E për çudi, si nuk na i zënë kurrë në gojë, bëjnë sikur t'i kenë harruar... Por shpirti ua di! Eh, të shkretët! Përpiqen që të rritemi pa mungesa, duke na dhënë edhe shkollë! Kështu, Lekon dhe mua na nisën për studime e ne i lamë vetëm...

– Po! – tha Despina, – Shumë e hidhur kjo që dëgjuam Kovi, vërtet e hidhur!

Unë po rrija e po tresja brenda hidhërimit e tij, ndërkohë që anija ishte nisur.

Horizonti drejt detit përpara ishte si prej plumbi dhe me re të zeza e të murrme, që

lëviznin me shpejtësi për nga juglindja. Kishte filluar një erë e fortë në det të hapur. Bregu filloi të largohej si me magji, si të ishte një dorë që po na largonte nga ai vend a nga njerëzit tanë, që sa vinin e zvogëloheshin e megjithatë vazhdonin t'i lëviznin me duar, ç'të kishin në to.

Bregu pas pak mbeti larg. Njerëzit tashmë dukeshin si miza a njolla picrrake, derisa u zhdukën në horizont.

Ne sikur na kishte prerë njeri gjuhën. Rrinim në heshtje dhe vështronim pa ia ndarë sytë bregut, teksa horizonti bëhej si vijë toke.

Pas pak ishim larguar aq, sa tashmë njerëzit tanë nuk dukeshin më.

Era po frynte edhe më fort.

– Ore, po ç'anije zeza qenka kjo! – u dëgjua papritmas një zë. – Shikoni sa tundet, si kamion mallrash e jo anije deti!

– Me varkë na paskan nisur, jo me anije! – ia ktheu një tjetër bashkëstudent.

– Djema, – foli një marinar aty afër, që siç duket na kishte dëgjuar. – Po të mos ketë dallgë, do t'ia kalonim shumë mirë. Por do lundrojmë pranë bregut dhe udhëtimi nuk është i gjatë.

Ndërkohë, një dallgë e madhe u përplas me bashin e anijes dhe piklat e kripura e të shumëzuara u shpërndanë mbi ne dhe mbi marinarin, i cili fshiu fytyrën me mëngë, duke buzëqeshur si në faj.

U futëm brenda dhe u ulëm nëpër stola pranë plaçkave dhe filluan të flisnim, si për të larguar mendjen nga deti, që sa vinte dhe egërsohej. Dikush mendohej të bënte shaka, ndërsa një tjetër hapte çantën me ushqime e fillonte të hante në heshtje.

Ndërkohë, zëra të tjerë vinin e iknin jehonë, pa mundur të përqendroheshin.

– Po na hyn frika nga ky udhëtim, nga kjo maune e mallkuar! – foli Greta serioze duke fshirë sytë e duke u përpjekur të vinte paksa buzën në gaz.

– Mos! – ia priti një marinar. – Mos mallko anijen e as ditën, se ndjell keq!

Ndërsa unë vazhdoja të mendoja...

Më dilte përpara ajo fytyra e hijshme dhe e bukur e motrës, ata sytë e saj të kaltër e të mëdhenj. Ende më tingëllonin në vesh fjalët e saj: "Lum ti, motrushka ime, që po shkon për studime! Por lum edhe ne, që po na bëhesh universitare! E para, në familje!" Dhe më kishte përqaftuar me lot në sy.

Ndërkohë, një anim i fortë i anijes lart e poshtë, më nxori nga mendimet.

Jakovi ishte diku aty afër në këmbë dhe rrinte mbështetur te një si banak anës murit të druntë, ndërsa kokën e kishte mbështetur te pëllëmbët e duarve. I foli të avitej e të ulej, se ndoshta i vinte mirë të mbështeste kokën mbi tryezë.

Më vështroi një çast e mirënjohës më tha: – Faleminderit, po kudo njëllon është! – dhe përsëri mbylli sytë, mbështetur kokën te duart.


Unë isha pranë derës dhe mbaja stomakun me duar. Kështu bënin edhe pjesa më e madhe e pasagjerëve, sidomos vajzat, sepse Anija batohej e s'po kursente askënd. Një pjesë kishte filluar t'i vinte për të nxjerrë zorrët jashtë, e ja, kur ndonjëri hidhej jashtë te parmakët mbi det dhe nxirrte... E pas pak, hynte prapë në sallë dyllë i verdhë.

– Si po e nisim këtë jetë jashtë vendit, larg familjes... Sa keq! – tha Despina e psherëtiu.

– Ç'na u desh! – pasoi një tjetër.

Tani dallgët po ngriheshin aq lart, sa s'kishte çfarë t'i ndalonte të sillnin shumë uji deri te ne, aq sa të lageshim e të pinim pa dashje nga ai ujë i ftohtë dhe kripë. – Po na futet deti brenda! – thirri Pipi, i shqetësuar edhe ai.

Marinarët, të lagur nga koka te këmbët, me mushama të zeza dhe kapuça, shkonin e vinin



sa mbi kuvertë e sa në dhomën tonë. Mendoreshin të na jepnin guxim, por dukej qartë se s'kishin kohë e mend shumë për ne. Merrnin e jepnin me litarë, që ishin kudo mbi kuvertë.

Ndërsa ne rrinim struktur te njëri-tjetri pa fjalë, vajza me vajza e djem me djem e që ishim nisur me aq qejf e dëshirë.

Në Tiranë kishin thënë se, pasi të mbërrinim në Dubrovnik, do merrnin rrugën të ndarë në dy grupe me tren: njëri për Beograd e tjetri për Zagreb.

– Udhëtimi po vështirësohet! – foli thatë timonieri

– Kam frikë se shtrëngata po vjen pas pak! – ia ktheu një tjetër, që nga uniforma duke si kapiteni anijes. – Më mirë të kthejmë e të ndalemi diku sa më afër...!, e i bërtiti me zë të lartë timonierit, – Ndrysho drejtim, që të qëndrojmë pranë portit më të afërt...!

Ne kishim ngrirë dhe ishim mbledhur edhe më tepër te njëri-tjetri.

Sa mbaroi ato fjalë, kur anija u ngrit përpjetë e pastaj zuri të lëkundej e të dridhej. Dukej si lëvizogë arre mbi detin tashmë të tërbuar keq.

Ndërkohë vështrova Jakovin që qëndronte në këmbë dhe shkonte sa në njëren anë të stolit në tjetrën, kur pas pak, një lëkundje tjetër e përplasi jashtë, afër derës së mensës. Pashë Pipin dhe një tjetër që i shkuan pranë, duke i vënë duart në bark.

Kështu mezi iknin minutat e udhëtimi na dukej sikur s'do mbaronte kurrë...

Ndërkohë, si të shkundeshim nga stepja, dëgjuam një zë të fortë që u ngrit mbi zhurmën e dallgëve:

– Po arrijmë në port! Qetësohuni...!

Ishte zëri i kapitenit, i cili na kaloi përpara të gjithëve, për të na qetësuar. Me sa kuptuam, edhe ai vetë kishte filluar të shqetësohej për ne dhe për gjithçka tjetër.

Më në fund arritëm.

Në port na hipën në një tren me vagonë të vegjël e mbi ca shina të ngushta, që s'i kishim parë kund, duke na nisur për në një qytet, ku të ndarë në dy grupe, hipëm nëpër vagona pasagjerësh treni të rregullt e ashtu vazhduam udhëtimin, në dy drejtime të ndryshme.

Në Beograd, na pritën disa djem të rritur nga fakultete të ndryshme. Ata ishin përgjegjesa studentësh se e mbaj mend më pas, na morën e na grumbulluan në një sallë të madhe të Fakultetit të Inxhënerisë.

Aty na njoftuan emër për emër degët ku do vazhdonim studimet.

– Dhurata Tako, inxhinieri, arkitekturë... – dëgjova dhe u shtanga. S'e mbajta dot një britmë:

– Po unë s'e bëj dot, nuk di të vizatoj...! – shpërtheva.

Ai që njoftonte degët e ndërpreu fjalën dhe foli me zë të lartë, se ata që kishin vërejtje, të qëndronin pas mbledhjes.

Unë kisha ulur kokën e mendoresha të fshija lotët.

Ashtu e humbur në problemin tim dhe shumë e shqetësuar, nuk e pata më mendjen të dëgjoja emrat e tjerë dhe degët e tyre, që përmendeshin njëri pas tjetrit.

U përmenda nga ky shqetësim, vetëm kur pashë sallën të braktisur dhe përgjegjës, që po mendohej të më qetësonte:

– Por ti ke nota shumë të mira sa kam këtu, – më thonte ai, duke parë nëpër letra, – Arkitektura pastaj, bëhet me vullnet, prandaj mos rri e dëshpëruar e kaq në merak! – e më vuri dorën në sup me dhembshuri, duke dalë për në korridor.

U çudita, kur aty pashë Jakovin që po më priste:

– Ke shokë me atë shqetësim, Dhuratë! – foli ngadalë. – As mua s'më dhanë degën e dëshiruar...!

– Pse, ti çfarë...? – e pyeta, pa ditur ç't'i thosha.

– Kam vite që ëndërroj letërsi, e më dhanë drejtësi. Pra, siç duket, do vazhdoj juridikun...

Pastaj qeshi, duke më ndjekur me sytë e tij të mëdhenj e mirëdashës.

Në fakt, ai ishte disi i përgatitur, sepse ia kishin hedhur një fjalë në Tiranë, nëpër korridorët e Ministrisë së Arsimit, kurse unë, deri atë çast, as që kisha menduar se mund të më jepnin degë tjetër nga sa kisha kërkuar... Letërsi kisha kërkuar edhe unë dhe s'kisha patur shqetësim për të.

– Tani ejani, se na kanë regjistruar në mensë! – tha Shpresa me gëzim. – Shkojmë e hamë të gjithë bashkë...

Më pas, me Behijen na çuan në dhomën e fjetjes.

Hodha një vështrim përreth. Ishin dhoma të mëdha dhe mbanin dymbëdhjetë krevate. Unë e Behija ndënjëm pranë e pranë, në shtretët të mesit. Shtretërit e tjerë ishin të studenteve vendase. Ato i kishin filluar studimet në shtator, në degën e kërkuar e në gjuhën e tyre, ndërsa ne po fillonim në dhjetor e në gjuhë të huaj.

Për fat, vitin e fundit të shkollës së mesme si gjuhë të huaj kishim bërë serbokroatisht e nuk ishte për mua fare e panjohur ajo gjuhë.

Në Beograd më dolën të njohur, studentë edhe ata. Disa vajza, për shembull, me të cilat kishim qenë nxënëse në shkollën pedagogjike.

Djemtë i kishin caktuar në konviktin "Iv Lola Ribar", më i madhi nga konviktet që ishte afër konviktit tonë. Për të ngrënë ata vinin aty dhe mblidheshim të gjithë.

Aty pashë Jakovin të afrohej.

– Edhe ne në këtë mensë do të hamë, – tha dhe më erdhi ngrohtë, sikur ta kisha njeri të afërm.

– Për të fjetur, do të rrimë në një konvikt këtu pranë, "Gajret" ia thonë emrin dhe është i përzier, djem e vajza, – foli Teodori, që na ish afuar. – Si e quajnë këtë konvikt? – pyeti ai.

– "Dom Studentkinje" me vajza jugosllave, – ia ktheva me pakënaqësi. – Tani jemi edhe ne...

Pas pak erdhën edhe Shpresa, Greta, Despina, si dhe të tjera të konviktit "Gajret".

– Unë dhe Skënderi këtu në mensën tuaj do hamë. Ne kemi zënë një dhomë në shtëpi private këtu pranë, – foli Kthansipi, shoqe e dikurshme në Pedagogjike, tani më dukej edhe më e afërt.

– Oh, sa mirë! – thashë duke e përqafuar dhe shtova: – Sa më gëzove!

– Të gëzova, të gëzova, por pa ndrysho një çikë këtë kështu... Shiko Jakovin si e mban veten! Dhe mua më duket se ai ka më shumë të drejtë se ndonjë





tjetër që të ankohet për degën...-mbaroi ajo, me butësi dhe dorën mbi krahun tim.

Diku afër, në një tryezë të madhe pashë Jakovin me Teodorin duke ngrënë.

Jakovi ngriti kokën dhe vështrioi nga salla, si për të parë ata të rinj që gumëzhinin, duke ngrënë, duke folur e duke qeshur njëkohësisht. Më bënin përshtypje ata sytë e tij gështenjë, të mëdhenj e me një vështrim të butë e të ëmbël.

Nga këshillat e të gjithëve, më në fund vendosa të qëndroj në Beograd, e t'i futesha inxhinierisë dhe arkitekturës. E kuptoja që do të vuaja, por do të mundohesha ama me të gjitha forcat t'ia dilja. Nuk i trembesha studimit dhe lëndëve por faktit nëse një ditë do mund të bëhesha vërtet një arkitekte e mirë. Dhe a do ta mbaroja atë fakultet me po ato rezultate si në Pedagogjike? Si do bëja me ato duar, të zonjat për çdo punë, por për vizatim jo? Këtë mendoja vazhdimisht.

- Do të jemi bashkë, mos ki merak! - më qetësonte Valentina, shoqe e porsanjuhur, e kujdesëshme, e qetë, që kishte ardhur për të studiuar arkitekturë. - Do të të ndihmoj unë në vizatim! - mbaronte ajo e më fuste krahun për të shkuar në konviktit.

- E ke kollaj të flasësh, Valentina! Ti e ke kërkuar arkitekturën. Ke mbaruar gjimnazin dhe e ke dhunti vizatimin! Ti e ke të sigurt se do marrësh diplomën me sukses dhe madje, me rezultate shumë të mira. Po unë? S'mund të m'i bësh ti përherë detyrat e mia! - mbaroja në ankth.

- Edhe ti do ta dalësh mirë, hë tani, pa merak! Do ta shohësh! - vazhdonte ajo.

- Si të mos bëhem merak! Unë jam me Pedagogjike dhe dihet çfarë shkolle është. Jam e fortë, por jam aty ku ajo shkollë është e tillë: në mësimdhënie, letërsi, kulturë të përgjithshme... Kam merak, se kam mungesa këtu. Ndihej e pazonja të vizatoj një lule, e jo më portrete, peizazhe e forma, që i kërkon arkitektura, - vazhdoja, duke u munduar të mos më rridhnin lot.

Pa rrugëdalje, fillova të ndiqja fakultetin, leksionet, detyrat e lodhshme në vizatim.

Ndërkohë edhe Jakovi kishte filluar kursin e tij në fakultetin e drejtësisë. Pa dëshirë, pa gëzim edhe ai, pa atë shtytjen që ndien kur ulesh e studion atë që ke dëshirë e pasion. Së paku, ai i kishte mundësinë për t'ia dalë mbanë. Drejtësia është teorike, është lëndë që s'kërkon anë teknike si vizatimi, bukur në vetvete, por gati i pamundur për mua.

Ai ishte lidhur dhe ndiqte lëndët me Ksanthipin dhe Skënderin, me të cilët njiheshin që herët. Edhe ata, ishin në të njëjtin fakultet me të. Dhe bashkë me Agllainë e dy të tjerë mbledheshin te dhoma e tyre private, ku studionin bashkë, duke e nisur së pari nga përkthimi i kapitujve të lëndëve të ndryshme, e pastaj për të hyrë në leksione. Ashtu ndihmonin njëri-tjetrin, duke i ndarë punët. Njëri gjente një fjalë në fjalor, tjetri një tjetër fjalë; dikush ndërtonte frazën, kujtonte këtë apo atë shprehje e pak nga pak

filluan t'i futeshin terminologjisë së lëndëve, përmbajtjes dhe puna po u ecte mbarë.

Ditët kalonin. Shkonim në fakultet çdo ditë, por si fillim kuptonim shumë pak gjëra. Në mensë hynim e dilnim tri herë në ditë dhe e gjithë koha tjetër ishte vetëm mësim.

Jetonim me disiplinë. Edhe kur dilnim për çlodhje a për pak shëtitje, dilnim bashkë, siç bënim edhe për kursin e gjuhës. Aty ishim të detyruar të shkonim bashkë, se serbokroatishtja na duhej të gjithëve si buka. Aty në atë lëndë, shënonim dhe zgjidhnim fjalë e fraza, që një ditë më parë nuk na kishin bindur se i kishim kuptuar mirë, me kontekstin e leksionit. Përpiqeshim t'i merrnim sa më shumë që të ishte e mundur material pedagogut të gjuhës, për të cilën ai nuk u kursye.

Shumë rrallë shkonim në kinema. Edhe atje shkonim së bashku, krah për krah, pa asnjë paragjykim apo ndjesi tjetër. Studimi i ethshëm sikur na kishte ftohur çdo tjetër shqisë e gjithçka ishte përqendruar te ngarkesa që na krijonin lëndët dhe gjuha e panjohur.

Kur shkonim në kinema, përgjegjësit tanë na shikonin e na kontrollonin nëse dilnim në çifte. E në ndonjë rast, kur ndodhte, ata mbanin qëmtrimin e u rrinin rëndë, sikur u jepnin atyre që e bënin, një lloj "leksioni" me rreptësinë e vështrimit; e që ata dhe kushdo tjetër ta kuptonim se s'duhej ta bënim më.

Kurse Ksanthipi dhe Skënderi erdhën të martuar dhe kjo gjë i bëri ata të ishin jashtë kësaj "loje". Ata, që në fillim bashkëjetuan në dhomën e tyre, jashtë konvikteve tona dhe nuk u trazuan nga ky lloj "kontrolli".

Kur e mendoj sot, ajo situatë nuk ka qenë aspak e lehtë për ne, të rinj e të reja, të sapodalë nga lufta, me ideale për liri dhe emancipim më të zhvilluar sesa çlirimi i vendit. Por aty ndiem se ishim si në "survejim" të vazhdueshëm, ngelur sidomos nga koha fare e afërt e Koçi Xoxes, ish-ministrit të Brendshëm. Kjo ndihej në jetën tonë të mbyllur; në atë "kontroll" të rreptë e të vazhdueshëm; në vështrimet e rrepta therëse të "përgjegjësve tanë", si dhe në atë disiplinë e bindje pa lëkundje që shoqëroi gjithë jetën tone në Beograd.

Ne, studentët, ato vitet e para pas çlirimit, ishim të moshave të ndryshme dhe nuk ishim të gjithë të sapodalë nga shkollat e mesme. Kishte shumë prej nesh që lufta ia kishte ndërprerë studimet e filluara në Itali, Francë, etj., e që në fund të luftës të dytë botërore dhe të lidhur me Lëvizjen Nacional Çlirimtare, morën të drejtën të mbaronin studimet në vendet e ashtuquajtura, të demokracive popullore, si Jugosllavi, Bashkimi Sovjetik, Bullgari, Çekoslovakia, Hungari, etj.

Shumë prej tyre e të mësuar me kushte si në vendet perëndimore e kishin të vështirë t'i nënshtroheshin asaj disiplinë e atij "survejimi", por shumica tyre, të konsideruar "të mëdhenj" e më me përvojë, ishin bërë "përgjegjës" e kështu që përfitonin liri më të madhe nga ne të tjerët.

Konvikti "Dom Studentkinje" ndodhej në një rrugë të gjerë e të shtruar të Beogradit, jo larg nga qendra. Ishte një ndërtesë e madhe dhe e lartë, pa oborr a kopsh. Nga jashtë hyej menjëherë nëpër shkallë, sipër së cilave ishte porta.

Nga aty futeshim në korridor, ku ndodhej dera e mensës, pastaj ajo e drejtorisë, dhomës së vizitave dhe, ngjitur me të, nisnin shkallët që çonin në katet e sipërme, ku ishin sallat e fjetjes.

Që aty shihej mirë rruga poshtë me shtëpi anash, disa të larta e disa të ulëta. Tek-tuk të zinte syri ndonjë pemë, por jo gjelbërim a zburim tjetër. Në ato dritare të ngushta e të larta nuk mund të rrije të sodisje hënën, njerëzit që lëviznin në rrugë apo shtëpitë përballë, dritat e tyre ndezura natën, banorët që hynin e dilnin.

Në mëngjes shkonim në fakultet dhe ndiqnim leksionet, ku mund të merrnim vesh diçka, ose bënim konsultime matematike e fizike me shokët shqiptarë të inxhinierisë të viteve të larta, të cilët na ndihmuan shumë në ushtrimet e matematikës, ku filluam të dalloheshim ngadalë Valentina dhe unë. Madje arritëm pas disa muajsh, të ngriheshim në dërrasat e zeza të auditorëve e të zgjidhnim ndonjë ushtrim, kur nuk e zgjidhnim kolegët jugosllavë të vitit të parë.

Ata çuditeshin me ne se si ia arrinim, por nuk e merrnim dot me mend se si dhe sa shumë punonim.

Sa gjë e mrekullueshme më duket sot, kur dëgjoj se studentët që dalin jashtë shtetit për studime, qëndrojnë një vit a më shumë vetëm për të mësuar gjuhën, pa frekuentuar mësimin dhe lëndë të tjera. Lum ata! Por edhe ne ia dolëm, ama!

Fakultetet i kishim pranë konviktit.

Ai i inxhinierisë ndodhej në një rrugë të madhe e kryesore, plot pallate, me më shumë gjelbërim dhe i rregullt, si diçka që ndryshonte mjaft nga rrugët dhe konviktet tona. Rrallëherë dilnim në qendër, te "Piazza Terazia", ku vinin varg hotele të bukura, si dhe një pallat që ishte më i madhi i Beogradit, e që mbante emrin "Albania". Beogradi i atëhershëm, thonë, ka ndryshuar aq shumë sa nuk njihet. Në "Piazza Terazia", ndodheshin kinematë, ku ne shkonim për ndonjë film të dielave a të shtunave, kur ishim më të lirë nga mësimet. Flinim pak orë dhe bisedat me njëri-tjetrin i bënim në mensë, duke pritur radhën për të ngrënë a për të tretur ushqimin. Apo në sallën e studimit ku takoheshim me ata të konviktit "Gajret".

Aty ishte edhe Jakovi.

Ditët e para ecnim të gjithë bashkë, por si kaloi kohë, ecnim bashkë deri diku e pas pak, papritur, veç kur mbeteshim vetëm ne të dy. As tani s'e kujtoj dot në qenë të rastit, a në njëfarë mënyre e krijonte ai, që të ngelnim vetëm. Por di se ato çaste që ishim vetëm, kishin filluar të ktheheshin për mua gjithnjë e më tepër kënaqësi, ku prisja takimin dhe "vetminë" e radhës.

Atij i pëlqente se si unë këndoja. Dhe shpesh, kur qëndronim në korridorin para mensës, ai dhe shoqet më pas më luteshin të këndoja. Dikur kisha marrë pjesë në korin e qytetit e më pas edhe në korin e shtetit bashkë me motrën, Norën. Kisha mësuar këngë të bukura, madje edhe mund të këndoja, me zërin tim të pamësuar, arie operash. Kjo, ngaqë dëgjonim në radio këngë e arie, që unë i mësoja përmendsh dhe i këndoja pastaj nëpër shtëpi me zërin tim prej altoje.

Më kujtohet një mbrëmje, kur si hëngërm darkë dhe jashtë bënte stuhi me shi e erë të marrë, ne studentët e "Gajretit" që s'mund të iknim me atë kohë, u grumbulluam aty në korridor, afër kaloriferit. Me ne u bashkuar edhe shumë studentët të "Dom Studentkinjes" dhe po rrinim e po bisedonim. Me lutjen e dikujt, Despina ia mori një këngë. Unë hyra në këngë dhe e shoqërova me zë të dytë. Pati duartrokkitje. Na pëlqyen shumë. Atëherë drejtoresha e konviktit që na kish ndjekur, na hapi derën e mensës e na ftoi të rrinim aty, derisa të mbaroi stuhia.

Të gjithë u ulëm nëpër stola dhe ai ambient u kthye në një skenë koncerti. Na duartrokisnin pas çdo kënge. Unë dhe Despina

kënduam të gjithë "repertorin" tonë! Pasi "koncerti" mbaroi, falënderuam drejtoreshën dhe u futëm në mensë, ku përsëri zumë vend të gjithë pranë njëri tjetrit dhe përreth kaloriferit. Jashtë era kish ndalur dhe stuhia ishte kthyer në dëborë të dendur, që binte qetë-qetë e me flokë të mëdha. Rruga kish filluar të zbardhej prej dëborës.

Aty diku në mensë dhe afër kaloriferit, përballë meje ishin ulur Teodori, Jakovi dhe të tjerë. Jakovi s'para merrte pjesë në ato biseda, shaka e barsolleta. Kur papritur, Teodori i foli:

- Kushedi ç'djalë i urtë ke qenë ti, Jakov! Edhe si fëmijë, njësoj do kesh qenë!

Jakovi s'e la të mbaronte e ia dha një të qeshure, që na habiti dhe kthym vështrimin nga ai.

- Po, shumë i urtë kam qenë, - foli ai, duke e theksuar "i urtë". - A doni t'ju tregoj diçka të fëmijërisë time?

- Hë Jakov, mos përto! - e nxitëm njëzëri.

Dhe Jakovi filloi të tregonte një ngjarje nga fëmijëria e tij, kur jetonte në Nartë, aty ku mbledheshin kripa në formë piramidash e ndërsa ai shkonte në Vlorë, në shkollë, në një mënyrë shumë interesante për atë kohë, me një tren të vogël e kur askush nga ne s'kishte dëgjuar se atje paskësh patur linjë hekurudhe, që çonte kripën nga kriporet e Nartës për në Portin e Vlorës.

Shumë më vonë, kur lexova në dorëshkrim romanin "Lulja e kripës", e gjeta këtë ngjarje që Jakovi tregoi atë mbrëmje, në figurën fëmijërore të Pacit. Por ajo tregoi, ndodhi shumë më vonë se çapëkëllëqet e fëmijërisë së tij, na ndodhi me Agronin, djalin e dytë, kur një ditë si dëgjoj fjalën "komplet", e pyeti të atin: - Babi, çfarë do të thotë fjala "komplet"?

Jakovi ia shpjegoi dhe ndodhi po ajo që i ndodhi Pacit në romanin "Lulja e Kripës".

Por më mirë po e jap atë siç e ka shkruar në roman, sesa ato që mbaj mend unë:

"Paci atë të shtunë u kthye nga shkolla me sy të skuqur. Ai kish qarë gjithë udhës në tram, megjithëse shokët e tij ishin të gjithë të gëzuar dhe të qeshur. Të nesërmen fi llonin pushimet e verës. Xha Sadiku e ngacmoi sa e ngacmoi, duke i thënë që të mos qante, se ja, shkolla do të hapej prapë në vjeshtë dhe pastaj, i vuri në dorë kamxhikun, që të ngiste kalin. Nga lemza që po mekte fëmijën, xha Sadiku filloi t'ia merrte me gjithë mend atë dënese, e jo si përherë në çapëkëllëqet e tij. Pyeti fëmijët dhe ahëre mësoi se ai kish marrë prapë dysh në mësimin e gjeografisë.

Paci nuk ishte nxënës i keq. Vërtet ai luante me vagonët nëpër shina, me typ nëpër tavat e braktisura, me piligorkat nëpër besa dhe me peshqit nëpër kanalethe, por ai i kishte të zhvilluar sedrën dhe vullnetin e nxënësit të klasës së katërt të fillores. Ai i shtrohej mësimin natën, kur nuk lozte dot. Por, kur mësonte, përqendrohej aq shumë, sa as fluturat rreth petromaksit nuk ia hiqnin dot vëmendjen andej. Sigurisht, ato cilësi shkollari nuk kishin lindur bashkë me të, siç kishte lindur ta zëmë, "bilbili" i tij. Po "bilbil" i tij kishte një histori më vete.

Njëherë Paci dëgjoj Milton, tek po fliste me gratë e kripores për veshmbathjet që i kish sjellë sinjor Danieli nga Italia, të përdorte fjalën "komplet". E pyeti të atin se ç'donte të thoshte ajo fjalë. Ishte në moshën e kërshërisë së madhe. Miltoja, i mërzhitur tashmë nga roli i fjalorit, me të cilin e kish ngarkuar i vogli, dhe, duke dashur ta kthente bezdinë në shaka dha këtë shpjegim: "Komplet u thonë gjërave që janë të plota, që i kanë të gjitha ato që duhet të kenë; që s'u mungon asgjë. Kështu, p.sh., ti si fëmijë je komplet: ke kokë, ke sy, ke veshë, gojë, hundë, ke duar, këmbë, ke dhe bike për të hedhur pipinë larg, që të mos lagësh pantallonat e të të shajë nëna... Pra, je komplet...".

Paci, i kënaqur nga ky shpjegim e për ta bindur t'anë se e kish kuptuar, tha shpejt e shpejt: "Ahëre Lika e teto Everminut nuk është komplet...".

Sigurisht që Miltoja dhe gratë e kripores ia dhanë të qeshurit, kurse Pip Spiceri nxori përfundimin se fëmija kish të drejtë, mbasi gruaja bëhet komplet vetëm kur martohet."

Letërsia shqipe e këtyre tridhjetepesë vjetëve të fundit ka marrë një përmasë të re për nga pesha e rëndësës, dhe cilësi të re për nga origjinalizmi, nëpërmjet prozës së Zija Çelës. Të dhënat statistikore, mbi tridhjetë tituj librash: romane, novela, vëllime me tregime, në disa mijëra faqe, kanë rëndësinë e tyre, sepse, në to, shihet intensiteti, ritmi, aftësitë dhe frytshmëria e madhe krijuese, edhe këto të rralla, në letërsinë shqipe, për numërshmërinë, shpeshhtësinë e daljes në ditë. Përmasa e re është edhe cilësi e re, pa të cilën nuk mund të jetë a të përbjë përmasë. Vet cilësia e saj, përcaktuese e vlerave, është origjinalizmi, aq i theksuar dhe ndryshe, sa Zija Çelës nuk i gjendet asnjë paraardhës, në prozën shqipe, dhe, siç ndodh në raste të tilla, nuk shpresohet të ketë as pasardhës në llojin e vet, ngjashëm, bie fjala, me "fatin" e Becket-it. Edhe lloji i prozës së tij, një tërësi risore poetikash, është e pangjashme me asnjë tjetër, të krijuar para saj, apo, në të njëjtën kohë me të, e cila përbën një degëzim më vete në trungun gjenealogjik të letërsisë shqipe.

Në këtë ndërkohë, edhe romanet më të rëndësishëm, kanë një pikënisje dhe bazë lëndore, thuajse, dhe një këndvështrim të përbashkët: realitetin e të shkuarës së afërt pa liri mendimi, gjithashtu, pasojat e saj shoqërore, psiko-shpirtërore dhe morale në rrethanat e lirisë. Proza e tij është jashtë këtij uniformizmi, edhe pse gjysmën e jetës e ka kaluar në atë realitet, shoqërisht dhe psikologjikisht i rëndë, madje, me ndodhi të rrezikshme për vet atë. Jashtësia e saj ka ardhur, sepse, ai u shkëput nga koha dhe realiteti jetësor i mëparshëm dhe kaloi në kohën dhe realitetin jetësor tjetër, në të sotmen pluraliste. Shkëputjen e parë, dhe ylberin e censurës, e pati kapërcyer dukshëm me romanin atipik dhe paradigmatic *Mali i tejdukshëm* (1990). Ajo nuk ishte thjesht lëvizje mekanike në kohë, as në realitetin e jashtëm hapësinor. Ishte lëvizje e brendshme, shndërrim metafizik, botëkuptimor, psikologjik, mendësish dhe shpirtëror. Pikënisja e re, e jashtme, u bë realiteti i kohës së sotme, i perceptuar dhe i mishëruar letrarisht jo më pak problematik dhe traumatizues, se i mëparshmi. Me shkëputjen nga e shkuara, u shkëput edhe nga gjedhja krijuese e përgjithshme dhe vetjake, që ishte përngjasim i realitetit shoqëror në ecurinë kauzale. Nga shndërrimi i tij psiko-mendor u përfutuan marrdhënie të tjera mes objektit të krijimit, realitetit jetësor, dhe subjektit krijues, shkrintarit prej të cilave ka dalë vepra e tij madhore në cilësi dhe autonomi arti, tepër e dallueshme në origjinalizëm. Parësor është krijimi prej imagjinatës, njëmendësia letrare, që është njëmendësia, e vërteta e shkrintarit, krijimi i saj prej imagjinatës, metafizikes, abstrakte, që shndërrohet në shëmbëlltyra njerëzore, figura objektsh lëndore dhe realitetesh jetësore. E pa qena, abstraktja, e paperceptueshmja, fryt i imagjinatës, bëhet e qenë, konkrete, e perceptueshme, e ngjashme me jetësoren. Një simbiozë mes konvencionale dhe jetësore, që shpalo botën njerëzore në ngjyra dhe ngjyresa nga më të ndryshmet, prej errësirës së pavetëdijes, në të errtat, gritë dhe të çeltat e vetëdijes, te drita e besimit, e mira, e bukura njerëzore.

Imagjinata është e epërme, përmbi veprën dhe përmbi lexuesin, e vrullshme, progresive në vijimësinë e saj, herë-herë e "shfrenuar", tejet e liruar, thyerë e logjikës së përditshmërisë, në çdo rast e pranueshme, kënaqësive artistike, e cila e ka shpënë letrarësinë, sidomos groteskun dhe ironinë, në kufij të pabesueshëm, ndërsa, atmosferën, shëmbëlltyrat dhe marrdhëniet njerëzore, mjediset e veprimit janë të ngritura në shkallare dhe përmasa madhërisht letrare.

Në procesin tjetërsues të shkrintarit dhe të veprës së tij, u tjetërsuan edhe marrdhëniet me lexuesin, i cili pranon dhe përshtatet me paktin e ri të leximit, i prejardhur nga vet lloji i prozës. Prandaj, në marrdhënie të tilla, krahasimi vlerësues i saj me realitetin shoqëror, me jetën është i kufizuar, për të mos thënë, shpesh, përjashtues. Lexuesi tërhiqet

GROTESK DHE IRONI MADHËRISHT LETRARE - Proza e Zija Çelës -

Nga Bashkim Kuçuku



fort emocionalisht në horizonte të larta imagjinatë dhe perceptime të reja të një bote letrare, e pangjashme me ato, që ka përjetuar nga lexime të mëparshme të shkrintarëve të tjerë. Realiteti shoqëror i shëmbëlltyrës, në të, është dytësor, plotësues i të vërtetës së shkrintarit me të vërtetën e jetës. Edhe kur është i shëmbëlltyrës, nuk është plotësisht shëmbëlltyrës.

Rrëfim-përshkrimi i saj nuk ka asnjërinë e realizmit, as objektivizmin e modernizmit, por subjektivizmin dhe subjektivizimin e një rrëfimtari autor nëpërmjet të cilit subjektivizohen, në trajta, mënyra dhe forma nga më të ndryshme, ngjarjet, ndodhitë, dialogjet, monologjet, introspeksioni a retrospeksioni. Këndvështrimet, gjendjet dhe qëndrimet emocionale, për nga subjektivizmi, vende-vende, përngjajnë me subjektin lirik të poezisë, një hiperndjeshmëri në të cilin rrëfim-përshkrimi shndërrohet në një lloj ligjërimi lirik. Mirëpo, nuk mbetet i tillë, sepse edhe ai ka objektivizmin dhe objektivizimin e vet, perin e hollë të sublimimit të humanizmit, i pashkëputur, i cili buthton si impuls vlerësimi

gjallues, në situata rrëfimi dhe gjendje përshkrimi, i dukshëm dhe i padukshëm, përherë i ndjeshëm.

Në tablonë gjerësisht të shtrirë të problemeve, dukurive dhe konflikteve qeniesore/ ekzistenciale të shoqërive të sotme, në qendër dhe në tërësinë e saj, është dehumanizimi i njeriut, i jetës dhe i botës, në të cilën virtytet janë tjetërsuar në vese, mirësjellja në hipokrizi dhe hipokrizia në sentimentalizëm të shtirur, dashuria erotike në interes lëndor dhe karrierë shoqërore, mediokri hero, i padituri superior dhe fitues, fisnikëria në pangopshmëri fitimesh, atdhetarizmi në megalomani protagonizmi, ngushtësia dhe inferiorizmi provincial në "ndërkomunikim", njohje dhe "lavdi" planetare. Tabloja e saj është kakofonia hiperbolike, e thënë me termin letrar, distopia e shoqërisë së sotme globale, që jeton në një delir hiperbolik të pangopshmërisë dhe kënaqësive vetjake, të keqdashjes dhe keqbjërjes, ligësisë dhe cinizmit, të cilat gërryejnë marrdhëniet shoqërore, shkelin brutalisht mbi respektin dhe të drejtën e tjetrit.

Dukuritë, tiparet njerëzore të dehumanizuara, sikur kanë mbetur të vetmet, pa pasur më përballë në njëmendësi virtyte dhe tipare pozitive njerëzore. Mes të keqes universale, a ka ndonjë ideal të gjallë dhe besim tek ideali? Ideal është humanizmi, besimi te njeriu dhe bota njerëzore e pashpërbërë, prandaj, në mungesë të tyre, shkrintari ka ngritur flamurin e humanizmit abstrakt dhe të përjetshëm, të struktur, duke sublimuar në të edhe dashurinë e vet për njeriun, jetën e virtytshme.


Trajtat dhe qëndrimet ndaj së keqes së tejzmadhuar, nëpërmjet hiperbolave, groteskut ironisë, që janë dhe përbërësit themelorë të stilit të tij, e kanë zanafillën, bazën mbështetëse dhe vlerësuese te humanizmi. Ato janë përfutuar nga përpjekja për ta rihumanizuar njeriun dhe botën, aty ku mungon, dhe të ruhet aty ku është. Për nga shumëpërfshirja, madhështia e imagjinatës, herë ngjan me atë të botës rableane, dhe, herë me atë suiftiane, vetëm kur përmendesh prej leximit, kupton, se je në botën letrare, kaq origjinale të Zija Çelës. Duke pasur paraysh veprën e tij të bëhet të mendosh, se shtrirja letrare e madhe e hiperbolave, groteskut dhe ironisë është në përpjestim me humanizmin, prej të cilit janë përfutuar, ose, anasjellas, humanizmit i është dhënë shtrirja dhe shkallarja e groteskut dhe e ironisë për të qenë mendimi në përputhje me shprehjen.

Autorët e hiperbolave, groteskeve, ironive të mëdha gjithmonë kanë qenë humanistë të mëdhenj (Dante, Servantes, Rable, Gogol, Kamy, Kafka, Markez, Kadare)

Proza e tij, edhe pse mes poetikave të modernizmit dhe pasmodernizmit, ka edhe disa veçori të tjera, dalluese, jashtë trajtave të tyre, prej të cilave është më dinamike, më e rrjedhshme, me lexueshmëri të madhe. Rrëfimi tregues, zakonisht, intensiv, me rrjedhë të shpejtë, këmbëhet me rrëfimin introspektiv dhe ekstensiv, më tej kalon në një regjistër tjetër, përngjasues me rrëfimin legjendar, në përshtatje me groteskun dhe ironinë zmadhuar. Rrjedha e tij e shpejtë përftohet edhe nga një elokuencë dhe oratori ironike, e ngjashme me ligjërimin gojor të përditshëm, pa kaluar në retorikë.

Ndryshe nga poetikat e llojeve të modernizmit, në të cilat veprimi është i tkurrur, ose, mjaft i tkurrur, si lëmsh i mbledhur në vetvete, shtjellimi i historisë, dinamika strukturore dhe e zbulimit të shëmbëlltyrave njerëzore, e prirë nga veprimi, ndërpritet dhe priret nga rrëfimi, të cilët, duke hapur në dy mënyra horizontin e veprës, hapin, po në dy mënyra, dhe horizontin e perceptimit dhe të kuptimit të lexuesit. Edhe veprimi është bifunksional, shëmbëllim i veprimeve njerëzore të natyrshme, dhe konvencional, veprim skenik si në dramaturgji. Megjithëse, shpërfaqen drama të rënda të bjerrjes njerëzore, ato rrallë kanë konflikte të ndeshjeve, sepse, edhe në njëmendësinë e jetës, njeriu "pa cilësi" i të sotmes, dramën e bjerrjes së vet, nga që nuk e kupton, e luan si komedi, edhe pse pasojat janë dramatike. Zija Çela, përmes ironisë dhe groteskut, shpalo drama komike të tilla, paradoksale, në thelb, të absurdes.

Tiranë, prill 2026



Prej Mhill Markut që e botoi romanin e parë në anglisht në 1955 me titull *The Red Pioneer*, i cili përqendrohet mbi instalimin e diktaturës enveriste në dekadën e parë të saj, e deri te romani *Brenga*, i autorit Pashko Camaj na ndajnë 70 vjet. Në këto shtatë dekada, në mënyrë aktive flitet për një diktaturë e cila për ma shumë se 45 vjet mbeti proces i një qeverimit atipik komunist në rajon e ma gjanë, dhe për pjesën tjetër postenverizmi shqiptar, mbeti një proces i penguem i një shoqnie që nuk e pau kurrë me sy të lirë shëmtinë e vet në kurrfarëloj pasqyre të mundshme.

Si një lexues e shkollor që ka kontribuue kjashtas, si në Shqipëri ashtu edhe në Amerikë, për letërsinë shqipe, e sidomos për letërsinë e ekzilit dhe të pos-komunizmit shqiptar, kur e lexova romanin *Brenga*, nuk mujta me ndëjtë pa u brengue. 35 vjet mbrapa, dhe tematikat e hoxhialisë janë prezente në letërsinë shqipe. Kjo tregon se arkivi i kujtesës shqiptare ashtu i painventarizuem plotsisht dhe i parehabilituem, çka të ban me mendue se intenca (apo qëllimi) i autorit mund të ketë burue përtej shpjegimeve vetjake që ka mundsue për lexuesin në prolog. Asht njimend me interes me mendue sesi Pashko Camaj, i lemë në ish Jugosllavi, i emigruem në Shtetet e Bashkueme të Amerikës njëzetëherë kur dikatori Hoxha dha shpirt, përkitazi i njohun me enverizmin shqiptar, trajton një temë të Shqipnisë në komunizmin e saj ekstrem. Paralelisht na bjen me mendue se Martin Camaj, i lemë në Shqipëri, i arratisun në 1948, i zatetun në Beograd, i zhvenduem në Romë, dhe mandej i paqtuem në Mynih kurrë nuk e ka përjetue dhe letrarizue sinkronin e enverizmit përpos se alegorikisht e me shumë sofistikim. Ndryshe ban Arshi Pipa në veprën e tij madhore *Libri i burgut*. Nësa autori për të cilin u mblodhën më 19 Prill, 2026 në Michigan, flet për një postfactum enverian dhe tematizon diktaturën e Shqipnisë komuniste. Këtu në krye të herës me lejoni me përmendë, se synimi i shkrimit tim nuk asht me folë thelpsisht për fabulën e romanit; këtë send der tash e kanë krye respektivisht shkrime të publikueme nga autorë të ndryshëm. Unë kam dëshirë me u ndalë te letërsia memuaristike, stilistika e veprës, funksionaliteti gjuhësor dhe sesi mund të përshënjojhet kjo vepër në tri dekada e gjysë të postnarrativës enveriane.

Romani siç vrehet ka në thelb një hero, i cili asht si shumë të tjerë asht një i arratisun prej Shqipnisë enveriste, i tranzituem në ish Jugosllavi dhe Itali, i ardhun në Amerikë, ku ka lidhë themele të reja, punue me faqe të bardhë dhe ku ka kontribuue për komunitetin shqiptar simbas informacioneve që mund të gjejmë mbi të. Mbrapa, në telat me gjamba ka lanë shokun e jetës, Markun, i cili personifikon fëtyrën e njimend të dikaturës së Hoxhës, e ma vonë Alisë. Një flit e bamë për hir të absurdit të një pushteti skizofren dhe me baza radikale. Në një vend ku mujshe lirisht me u dënue dhe për mendime që mund të mos i kishe pasë kurrë si p.sh. Mirash Ivanaj, Arshi Pipa e sa sosh. Lëne ma me folë për bashkëpunime, që u kthenin në akuza të çuditshme, por merrnin jetë reale në gjyqsore të atëhershme.

Stili i autorit përhet drej një letërsie të fakticitetit, si shembulli i disa autorëve shqiptarë mbas 90s; gjuhë kronikane, dokumentative, e zhërvjellte, emotive kryesisht dhe me dinamizëm deri diku të mirë.

Çka asht realizue mirë në këtë roman? Synimi me e ba personazhin kryesor protagonist të një rangu universal, dhe jo sesi e paraqiste një shkrim/recensë, si kryengritje të Malësive të Veriut të Shqipnisë. Kjo kjashtas tregon se autorja Konda ka perceptim rajonal, dhe për pasojë dhe religjional, tue iu referue vetë protagonistit të romanit. Mbas mendjes sime, rasti i

Mbi romanin *Brenga* të Pashko R. Camaj

Romani *Brenga*, xën vendin e vet të merituem në letërsinë shqipe-memuaristike

Nga Lisandri Kola

Tonin Mirakajt asht shembull ekuivalent i disidencës së Europës Lindore në gjysën e dytë të shekullit XX. Por këtu kurrsesi nuk duhet me u barabitë me rastet e arratisjes së M. Camajt, A. Pipës a të ndokujt tjetër. Kjo e këtyne asht disidencë intelektuale-politike, sidomos te Pipa, i cili kaloi 10 vjet burg dhe u arratis me not bashkë me të motrën dhe letrat e duhanit qepë për tesha ku ishte shkruar *Libri i burgut*, botue së pari në Romë, në 1959. Rasti i Pipës asht ndër ma unikët në faqen e ish bllokut. Rasti i Marakajt në gjykimin tim asht disidencë rrethanore-politike; fis me Mirakajt e anatemuem prej enverizmit, ndër ma të përndjekunit, etc. Kurse sa i takon historive të arratisjeve në Shqipëri totalitare mundemi me shestue se ajo e familjes Mirakaj përfshihet ndër arratisjet spektakolare, të ngjashme në Shqipëri e asokohe, si për mal si për ujë, ku disa janë ma të zashme e disa ma pak të zashme.


Tjera, që duhet çmue në këtë roman asht narrativa e integritetit. Të gjithë shënjesit

në roman të bajnë me kuptue se nyjet shtjellojnë narrativën e një persone (jo personi) në odiseadën e integritetit në një vend të huej, mbasi ka vendosë me u arratisë tue parakuptue e pranue kostot jetësore, për ato jetë që la mbrapa në Shqipëri e bunkertë. Në krah tjetër qitet paralele dhe me kalvarin e Markut, konkretisht me viktimat e regjimit. Der këtu mundemi me thanë se Pashko Camaj e ka qitë mjeshtrisht kulmin e shtëpisë ashtu si ato me baskija në vendlindjen e protagonistit të romanit të tij. Kjo gja e ka futë këtë vepër në rreshtin e letërsisë shqipe-memuaristike si proces *ex auditu* (pra me të ndieme prej tejtërkujt). Edhe kjo asht punë bukur e zorshme, me ndëjtë për krahu letërsisë *ex visu* (pra përjetue direkt) si Arshi Pipa, Visar Zhiti, Fatos Lubonja, At Zef Pllumi, Dom Simon Jubani, Fra Konrad Gjollaj, Maks Velo, Lekë Tasi, Ejëll Çoba etc.

Çka mund të ishte ba ma mirë në këtë roman? E para, romani duhet të kishte pasë një redaktim ma profesional. Ka momente

që vepra ka lëshime drejtshkrimore (khs *Iter për lter* në citimin e Mateut 5, 23-24 përkthimi i Dom S. Filipajt); dyshoj kështu edhe për emnin e *Vocërr Prelës*, gjyshit të protagonistit, që del *Vocërr* (f. 18-passim); njëjtë emnat mashkullorë në shqipe, si *Petro* e *Mark* kur dalin të trajtë të shqueme janë *Petroja* e *Marku*. Po kështu gjuha në do momente del e automatizue: "*Kur u kthyen, Preka u shpall i vdekur*" (24) ndërkohë që krejt natyrshëm kishte me qenë "*Kur u kthyen, u mor vesh se Preka kishte vdekur*"; "*Të premtën pasuese, Tonini...*" (113) ndërkohë "*Të premtën tjetër, Tonini...*". Ka momente që gjuha, tue ndjekë përvijë standardin e shqipes, ka humbë regjistrin familjar dhe kontekstin e personazheve gegëfolëse që bahen viktimë e kësaj gjae. P.sh, dikund flitet për Marash Dedën, një çoban që thotë "*Shto dru në zjarr*", - i pëshpëriti së shoqes. "*Mund të kenë stohte*". Ndërkohë që "*Qiti dru zjerrmit*", e kishte dinamizue diskursin e ba ma të prekshme botën e folësit. Po kështu asht kudo protagonistin, që nuk bart asnjë element gegë në gjuhën e tij. Po ndalem vetëm në një pasazh të fundit: "*Te shkijet?*" - i pyeti ai prerë, sikur po i provonte fjalët për helm. - "*Doni t'u drejtohem serbëve për ndihmë? Atyre... Ata janë armiq të tanë! Si Sigurimin, ata kanë UDB-në dhe janë po aq komunistë. Janë identikë, përveç faktit se Tito dhe Hoxha janë në hasmëri me njëri-tjetrin. Ky është i vetmi ndryshim. Protesta e tij u shua në heshtje.*" (61-2). P.sh, në nivel redaktimor kemi probleme teknike në disa aspekte. Përdorja e etnocizmit *shkje/shkije*, mund të parakuptohet dhe kontekstualizohet në *Lahutën e Malcís*, po jo në një roman të 2025. Këtu kujtoj, mes tjetërve që munden, regjizorin serb dhe me protagonistin i lëvizjes artistike jugosllave *Crni val*, Želimir Žilnik, në *Rani Radovi* (1969) e tenton eliminimin e përdorimit të termit *shqiptari* prej gojës së një prej protagonistëve të filmit. Këtu protagonistja Jugoslava e korrigjon shokun e vet marksist, se duhet me iu drejtue ndryshe pa konotacion etnik. Tjetra "*Sikur po i provonte fjalët për helm*" kuptimi del i turbullt në nivel semantik. E mandej krejt çka vijon e ban Toninin të panatyrshëm gjuhësisht në rezistencën e tij. Për ta mbyllë, me një sugjerim ma shumë se miqsor, në ribotimin e këtij romanit tue pá se ka qarkullue pëlqyeshëm dhe ka me pasë nevojë për një botim së shpejti, tham se autori duhet me ia besue veprën një profesionisti në redaktim, që me ardhë ma cilësisht.

E si konkluzion final, mundemi me pohue se romani *Brenga*, xën vendin e vet të merituem në letërsinë shqipe-memuaristike dhe i ban ftesë publikut me folë, me kuptue, dhe reflektue mbi të shkuemen e Shqipnisë totalitare, aq ma tepër gjeneratës së re, si mbenda vendit si jashtë vendit, për me u aktivizue në vepra që thërrasin drejtsi sociale dhe katharsis kombtar. Deri të mbërrihet kjo punë, procesi real i studimit të komunizmit shqiptar ka me qenë brenga e çdo shqiptari që e don njimend Shqipërinë.



Proza e shkurtër e Ndue Ukaj ndërtohet mbi një tension të vazhdueshëm midis historisë dhe ndërgjegjes, midis mitit dhe përvojës individuale, midis pushtetit dhe njeriut. Dy vëllimet e tij me tregime, “Mbretëria e ëndrrave” (Onufri 2021) dhe “Shtegu i të verbërve” (2024), dëshmojnë një projekt të qartë estetik: krijimin e një universi alegorik ku njeriu vihet përballë vetes, kujtesës dhe iluzioneve të tij. Në këtë univers, rrëfimi është një akt reflektimi filozofik dhe moral.

Që në tregimet e para, të vëllimit “Mbretëria e ëndrrave” (2021) Ukaj vendos në qendër figurën e njeriut të pushtetit, të cilin e çmonton përmes një dramatike të brendshme. Në tregimin “Ëndrra e Perandorit”, pushteti përballë me kufirin e tij më të madh: ndërgjegjen. Një ëndërr e vetme mjafton për ta rrëzuar perandorin nga maja e lavdisë në humnerën e ankthit. Ai nuk mposhtet nga kundërshtarët, por nga një vizion i brendshëm që e zhvesh nga iluzioni i madhështisë. “Unë s’mund të bëj asgjë. Më vrau një ëndërr” – kjo fjali sintetizon thelbin e poetikës së Ukajt: njeriu është i pambrojtur përballë vetes.

Motivi i njeriut të pushtetit rishfaqet në tregime si “Pasqyra e një gjenerali”, ku pasqyra shndërrohet në simbol të së vërtetës së fshehur. Gjenerali nuk rrëzohet nga armiku, por nga përballja me plagën e vet morale. Ukaj përdor këtu një intertekst të fuqishëm biblik – episodën e Tomës dhe Krishtit – për të theksuar se njohja e së vërtetës kërkon prekjen e plagës. Në këtë mënyrë, proza e tij fiton një dimension universal, duke e vendosur dramën individuale në një horizont të përjetshëm etik.

Në tregime të tjera, si “Shpërfillja e një udhëheqësi”, shfaqet një kritikë e mprehtë ndaj pushtetit si spektakël. Ndërtimi i një truporeje gjigante për të tërhequr vëmendjen e popullit është një metaforë e qartë e manipulimit përmes simboleve. Ukaj e sheh artin si të rrezikuar nga instrumentalizimi politik, duke krijuar një kontrast domethënës me figurën e artistit që mbetet në ndërgjegjen e njerëzve, përtej pushtetit.

Një nga linjat më të rëndësishme të kësaj proze është raporti midis individit dhe turmës. Në tregimin “Shtegu i të verbërve”, “Shtegu i të verbërve” (Onufri 2024), kjo marrëdhënie merr trajtë alegorike: një turmë ndjek një prijës të rremë drejt një parajse të rreme, për të zbuluar në fund zbrazëtinë e besimit të verbër. Kjo është një nga figurat më të fuqishme të Ukajt për të përshkruar mekanizmat e manipulimit dhe nevojën e njeriut për të besuar, edhe kur besimi e çon drejt humbjes.

Në këtë kuptim, proza e Ukajt ngre pyetje mbi përgjegjësinë individuale, mbi lirinë dhe mbi rrezikun e dorëzimit ndaj kolektives. “Njeriu gjithmonë do të ekzistojë në histori për të treguar se njeriu vërtet ekziston” – kjo ide, e artikuluar në tregimin “Konsumatorët”, përbën një lloj aksiome të gjithë veprës së tij.

Një dimension tjetër thelbësor është ai i kujtesës dhe historisë. Ukaj ndërton një rrjet të dendur referencash që shtrihen nga Bibla te mitologjia dhe historia botërore. Figura si Kaini dhe Abeli, Krishti, Pilati, Babeli, apo edhe Gjergj Kastrioti, rikthehen si imazhe që ndriçojnë të tashmen. Në tregimin “Kalendar festash”, historia universale dhe historia personale përplasen, duke krijuar një ndjesi të fortë relativizimi: ngjarjet e mëdha të njerëzimit dhe ato të vogla të individit bashkëjetojnë në një tension të pazgjidhshëm.

Ukaj ndërton një poetikë të “ngjarjeve të mëdha dhe të vogla”, ku drama intime shpesh ka më shumë peshë se historia kolektive. Kjo shihet qartë në tregimin ku një moment i vogël personal – dëshira për t’u parë nga një vajzë – përplasat me

UNIVERSI LETRAR I NDUE UKAJT: NDËRGEGJJA NË KOHË KRIZASH

Nga Granit Zela



ritualet ideologjike të kohës, duke zbuluar një konflikt të thellë midis kalendarit individual dhe atij shoqëror.

Një tjetër bosht i rëndësishëm është arti si strehë dhe si provë. Në tregime si “Pikëllimi i artistit”, krijuesi përballë me kompromisin dhe me humbjen e së bukurës. Shitja e një pikturë të dashur nuk është thjesht një akt ekonomik, por një plagë shpirtërore që e gërryen artistin nga brenda. Ukaj e sheh artin si një hapësirë sakrificë, ku vlera e vërtetë kërkon një çmim të lartë.

Në vëllimin “Shtegu i të verbërve”, kjo botë zgjeron dimensionin e saj historik dhe ekzistencial, duke u përqendruar më fort në përvojën e Kosovës para dhe pas luftës. Tregime si “Njeriu që fjeti me dritë ndezur” apo “Kufijtë” sjellin traumën e dhunës, të përndjekjes dhe të emigrimit. Personazhet e Ukajt jetojnë në një kohë të dyfishtë: në kohën e ngjarjes dhe në kohën e kujtesës, ku trauma vazhdon të jetojë si një dritë e ndezur në errësirë.

Në këtë kontekst, liria shfaqet si një problem kompleks. Pas luftës, ajo nuk është më një ideal kolektiv, por një kërkim individual: “Po unë doja liri edhe për vete”. Ky kalim nga liria kolektive te ajo personale përbën një nga temat më të rëndësishme të Ukajt dhe një reflektim të thellë mbi realitetin bashkëkohor.

Proza e Ukajt karakterizohet nga një ndërthurje e rrëfimit me eseizmin. Narratori shpesh është një mendimtar që ndërpret rrëfimin për të reflektuar mbi kuptimin e jetës, historisë dhe artit. Kjo e afron prozën e tij me traditën e tregimit filozofik, ku ngjarja është vetëm një pretekst për meditim.

Në këtë linjë interpretimi, proza e shkurtër e Ukajt fiton një kuptim më të plotë kur vihet në raport me prozën e tij të gjatë, veçanërisht me romanin “Dritarja e Marin Shkrelit” (Onufri 2023). Një nga tiparet më të dukshme që kalon nga proza e shkurtër në roman është përqendrimi te individi si bartës i përvojës historike. Në tregime,

perandori, gjenerali apo artisti janë figura të ndërgjegjes; në roman, kjo figurë mishërohet te Marin Shkrelit, një protagonist i ndërtuar si vëzhgues, përjetues, mendimtar dhe njëkohësisht si veprues. Ky kompleksitet i personazhit është një zgjerim i asaj që në tregime shfaqet si moment epifanik: në roman, epifania shndërrohet në proces të gjatë vetëdijeje.

Një tjetër element që rishfaqet është ndërthurja e kohëve – e kaluara dhe e tashmja. Si në tregime ku historia universale dhe personale përplasen, ashtu edhe në roman rrëfimi lëviz midis luftës, pasluftës dhe së tashmes, duke u endur në kohë dhe në kujtesë. Kjo strukturë i jep prozës së Ukajt një dimension reflektiv, ku e tashmja nuk kuptohet pa të kaluarën, përvoja e luftës dhe trauma kolektive përkthehen në përjetim individual. Kjo është e njëjta logjikë që vepron në tregimet e Ukajt: historia nuk rrëfhet si kronikë, por si përvojë e brendshme, si plagë shpirtërore.

Motivet themelore të tregimeve – pushteti, liria, trauma, kujtesa, dashuria – rishfaqen në roman me një shtrirje më të gjerë. Dashuria, për shembull, që në tregime shfaqet si një ndjesi shpëtuese dhe si kundërpeshë ndaj dhunës, në roman bëhet boshti emocional i rrëfimit: marrëdhënia e Marinut me Donikën është një formë rezistence ndaj shkatërrimit të botës nga lufta. Po kështu, tema e lirisë – e trajtuar në tregime si dilemë etike – në roman merr përmasa ekzistenciale dhe historike.

Një element tjetër i rëndësishëm stilistik është ndërthurja e rrëfimit me përsiatjen. Në tregime, narratori shpesh ndalet për të reflektuar mbi kuptimin e jetës; në roman, kjo shfaqet përmes ndërthurjes së rrëfimit objektiv me atë subjektiv, përmes letrave dhe monologëve të brendshëm të protagonistit. Kjo krijon një teksturë të dyfishtë narrative, ku rrëfimi dhe mendimi bashkëjetojnë.

Edhe gjuha dhe stili mbeten në thelb të njëjta: një gjuhë e kthjellët, e pasur, por pa teprime retorike, që synon më shumë fuqinë e mendimit sesa ornamentin stilistik.

Proza e shkurtër e Ndue Ukajt mund të lexohet si një hartë e ndërgjegjes njerëzore në kohë krizash. Ajo është një letërsi që nuk kënaqet me përshkrimin e realitetit, por kërkon ta deshifrojë atë përmes simbolit, alegorisë dhe reflektimit. Në këtë univers, njeriu është gjithmonë në udhëkryq: midis dritës dhe errësirës, midis lirisë dhe nënshtrimit, midis kujtesës dhe harresës. Nga ana tjetër, proza e gjatë e Ukajt ruan të njëjtat struktura themelore – alegorinë, reflektimin, ndërthurjen e historisë me ndërgjegjen – duke e zhvilluar ato në një formë më të gjerë narrative.

Në tërësi, krijimtaria e Ndue Ukajt përbën një sistem të unifikuar letrar. Është një letërsi që lëviz nga simboli te historia, nga ëndrra te trauma, nga individi te kolektivja – për të na kujtuar se drama më e madhe, pavarësisht kohës dhe formës, ndodh gjithmonë brenda njeriut.



Kur shihja në galerinë MOMA të Nju Jorkut tablo të artit modern, më kujtohej Besim Golemi, sidomos koha: kur rrinim bashkë dhe në Bibliotekën Kombëtare shfletonim albume me piktorë abstrakt, ndaj të cilëve Besimi linte mendjen dhe unë tregohesha i rezervuar. Nëse pëlqente një gjë, ai e përjetonte si të kishte rënë në kontakt me mrekullinë dhe ti duhej t'ia mbaje anën për t' mos ia prishur atë marrëdhënie hyjnore. I ndruhesha reagimeve impulsive të tij, që, në kohën e vrulleve revolucionare, të hapnin avaze. Ishte krejt i zbuluar, nëse doje ta dëmtoje. Të ishe i dashuruar me ngjyrat, në kohën e realitetit bardhezi, vetvetiu e mbartje rrezikun.


Kur ulem të pi kafe me llafë në Lushnje, përsëri më kujtohet Besimi, thuajse i harruar, në mos i quajtur i tejkaluar nga pretendentët e radhës. (Besimi nuk ka qenë aq i qeshur, sa duan ta skicojnë, as aq i vetmuar sa duan ta vizatojnë, as aq i luftuar, sa duan ta pikturojnë. Në esen "Gjaku i ëmbël i Besim Golemit" Xhevahir Lleshi e portretizon kështu: "E kam të fiksuar portretin e tij: fytyra pakëz gjatoshë, tiparet e skalitura fort, sytë e zjarrtë si gaca që të digjin, vështrimi i tij pak flu, por i kujdesshëm në përqendrim, dhe e qeshura e tij e çuditshme, pak si e fshehur dhe pastaj çelëj e shtrihej në gjithë tiparet e fytyrës.")

Nuk njoh një të dytë, të besonte aq shumë tek vetja, i sklavëruar ndaj gjithçkaje që bënte, i dalldisur, me zjarrmi dhe hove, mbushur me energji të skajshme, duke u matur veçse me të mëdhenjtë e artit, si e vetmja referencë e tij. Meqë të mëdhejtë i përkasin panteonit e qiellit dhe ai, nxitoi të ikte: më shumë i shtyrë nga e rëndomta se sa i tërhequr nga e magjishmja, ndaj dhe qielli e mori shpejt. Njësia matëse: i krahasueshëm me të mëdhenjtë, ia njihje aq natyrshëm vetes, sa dhe ne u mësua, t'ia merrnin si normalitet, sikurse e kujton dhe Mimoza Ahmeti: "Më erdhi njëherë nga Gjermania Besim Golemi. Më ka dashur shumë dhe më ka vlerësuar shumë! Më quante dhe magjistaria e fjalës. Pa një dhomë të thjeshtë, dy fëmijët, dy piktura. I tronditur nga pikturat më tha: "Ç' a bën ti këtu moj me këto kalamjë?!-dhe shtriu dorën sikur të ishin sende.-Ç' a është ky para teje, po ai!-dhe më përmendi ca emra.-Ti je magjistaria e fjalës?!" Aty kuptova se midis një mashkulli gjenial siç ishte ai, dhe një gruaje qoftë dhe gjeniale siç mund të isha unë! Në atë kohë kam qenë vërtetë e jashtëzakonshme!" Besimi, kur heshte të dukej si murg dhe kur ekzaltohej, teatral. Teksa të hidhte vështrimin, të kqyrte në mënyrë të tillë, sikur po të peshonte: vleve apo nuk vleve si portret, se për të tjerat as që donte t'ia dinte. Ndodhte t'ia thoshte dikujt: "Mos lëviz!", nxirrte bllokun dhe hidhte vetëtimthi impresionet e para dhe, kushedi se në ç' tablo do ta mbaje frymën. Më kishte rastisur ta shihja në studjo duke pikturuar, ku shtati i gjatë me lëvizje të dallueshme, ngjashëm me mizanskenat e një dirigjenti, t'ia afrohej tablos me hapin kompas, sikur donte ta përpinte telajon dhe, me lëvizje të shkathta të penelit hidhte imazhe dhe, po aq vrullshëm tërhiqej pas, duke mbyllur njërin sy, i fiksuar



Besim Golemi iku, duke lënë pas bojërat, penelat, kanavacat

Ese nga Fatbardh Amursi (Rustemi)



Besimi Golemi me piktorin e shquar Sali Shijaku

gjatë dhe pasi bindej për çka duhej të bënte më tej, një hap i dytë dhe peneli vallëzonte në telajo. Nëse gjithë ky ritual përfundonte sipas pritshmërive të tij, atëherë kujtohej për praninë tënde dhe të jepte një të qeshur. Domethënë, shkoi mirë! Në rast se jo, i shtoj nervozizmi, ku peneli trazohej në tavallaz dhe njolla e fshirë ia linte vendin një tjetre. Uroja, që të mos ndodhte kjo e dyta, se tersi do quhesha unë. Kur bënte portrete, rrinte gjatë në studjo, ndërsa paisazhet i gjuante në natyrë, duke ecur kilometra të tëra deri sa t'ia mbushej mendja se ku duhej t'ia ngulte kambalecat. Ishte po aq realist sa të tjerët, ndërkohë një kamuflues i regjuri për të fshehur eksperimentimet të yshtura nga albumet me piktorë modernë. Kurajon asnjëherë nuk e çoi në lartësinë e guximit, por, shpirtin novator s' e zbriti në konformizëm. Në gjykimin tim, moderniteti i tij kaloi paq, ngaqë ai ishte një vizatues i shkëlqyer, duke mos e tradhëtuar figurën, objektin.


"Unë nuk i mbaj mëri atdheut" titullohet një intervistë e tij e vitit 1991 në një media

gjermane. Kjo intervistë ka vlerën e një autoportreti. Shihni se kujt ia drejton ai mirënjohjen: "Unë kam mendimin se nënë më bëri artist, -e cila i thoshte se: fillimisht ti ke vizatuar me sy." Në fakt, mirënjohja duhet të shkonte për njeriun, që e zbuloi dhe u kujdes për arsimimin e tij, duke shkuar tek ministri i arsimit për kohën, Thoma Dejlana, dhe ky ishte: Fasli Haliti. Ndodhur para një kompozimi të Besimit, ekspozuar në sallën e katit të dytë në shtëpinë e vjetër të kulturës, mësuesi i vizatimit do më thoshte për ish-nxënësin e tij: "Këtu në çdo centimetër katror ka art." Pyetjes së gazetarit gjerman, se cilët ishin miqtë dhe shoqëruarit e tij në Shqipëri, ai i përgjigjet: "Nëna, Xhek London, babai, Shopenhaueri, Dielli duke përënduar, vëllezërit, kali i bardhë, Pikaso, Van Gogu, gratë, Bluzi amerikan, Tina Turner, Dostojevski". Nuk përmend asnjë artist shqiptar, le mik apo shok, as Mimosën, që në numër mund t'ia kishte më shumë se kushdo tjetër. Më qeshet kur shoh ndonjë, që tenton ta privatizojë njohjen me të, pasi ai nuk ngurronte të thoshte, sidomos në çaste dëshpërimi: "Njerëzit për mua janë si punë e stiletit, kur i mbaron boja e hedh." Për pikturën ishte gati të hidhte në erë dhe veten. Duke u shprehur: "Unë nuk i mbaj mëri atdheut", përkundër atyre që për dështimet e tyre fajsojnë atdheun, inatet duhet t'ia ketë me ata, që i mbajnë peng krijimtarinë të dhuruar prej tij.

Besim Golemi ishte aq i veçantë sa dhe piktura e tij, tek e cila shkriu të gjithë talentin, duke e lënë veten në plan të dytë. Më pas në plan të tretë, të katër, të pestë, deri sa i dha fund jetës me hedhje nga një lartësi pallati. Qe i bindur, se vdekja nga lartësia, ku ai qe ngjitur, do i vinte. Kujtoj mbrëmjen e fundit, kur Besimi nga trotuari përtej rrugës do më thërriste: "Fatbardh Rustemi je i madh!" Për Besimin nuk kishte të mesme: o i madh, o i vogël. I ngrita dorën dhe teksa mori rrugën për më tej, pashë t'ia merreshin këmbët. Ishte hera e parë, që e shihja të dehur. (Drejtori i shkollës ku Besimi ishte mësues, më ishte ankuar për neglizhencat e tij në punë. "Mos e luaj. Lëre në botën e tij!" - i thashë. I fyer, ngaqë Besimi nuk e pyeste, drejtori nis t'ia jepte shembuj të shkeljeve disiplinore të mësuesit të vizatimit, sikurse e njihje ai. "Në atë shkollë pësoni më i rëndësishëm është ai.-ia preva shkurt. Nga Gjermania kishte përfunduar në

një mësues fshati. Nuk më la kohë të bëja më të mirën për të.) Të nesërmen, kur po shkoja në një mbledhje në prefekturën e Fierit, tek ura e Sheqit, pashë Besimin, që ecte nëpër shi, i lagur. E mora me mend, që kishte shkuar të takonte të birin, i cili jetonte me të ëmën në Fier. Ishte duke kapërcyer një urë, një kohë apo vetë jetën? Të nesërmen mora vesh lajmin e hedhjes së tij nga pallati. "Një porosi kam për popullin tim: të ecësh, të ecësh drejtë, por gjithmonë duke vështruar Evropën në sy: boll me frikë tek hiletë dhe tek kurthet." - e mbyll ai intervistën me gazetarin gjerman. Edhe këtu, ai i drejtohet të mëdhenjëve dhe popullit, i bindur se hilet dhe kurthet i bëjnë veçse të vegjëlit, që ai i injoronte, pa i shkuar në mend se ata mund të hakmerren dhe në postmortumin e tij.

Në gazetën "Koha jonë" e 18 prillit 1998, 28 vite më parë, vdekja tragjike e piktorit Besim Golemi shoqërohet dhe me dy shkrime homazh nga shkrimtari Bujar Xhaferi dhe piktori Vladimir Myrtezai. "Ai pikturoi gjithë jetën ëndërrën e tij me një penel të lirë... pikturonte duke klithur nën zë... Ai ishte ndër të paktët që në vend të herarkëve pikturoi koka të bukura minatorësh dhe shkrimtarësh. Për të sjellë ndërmend këtu portretin e Dritero Agollit, Ismail Kadaresë, Petro Zhejit e Rudolf Markut." -vë në dukje Bujari, duke shtuar: "Tek pinim kafe në hollin e hotel Dajtit në Tiranë, më tronditi kur më tha se po punonte pikturën e tij të fundit...Besimi kishte pikturuar për herë të parë dhe të fundit vetveten." Ndërsa Vladimir Myrteza ndalet në vlerat e artit të tij: "Natyrë artistike dhe shumë i talentuar! Me temperament të vrullshëm në shfaqjet e tij...I vetmi dhe i mrekullueshmi në llojin e tij. Vdekja e Besimit që e dhimbshme dhe tragjike. Më vjen të skuqem pak, kur mendoj që Golemi me vetëpërgjashtimin e tij, sikur sfidon të gjithë racën e kalkulatorëve të vetëquajtur dhe të vetëzgjedhur "kritikë" dhe "artistë" dhe vazhdojnë e luajnë komikisht në arenën e artit, ku me një cinizëm vulgar, bashkë me shtetin dhe racionalitetin e tyre, pozojnë brenda kësaj arene." Ndoshta tek të tillët duhet kërkuar, që për Besimin s'po kujtohet askush. Të shohim se c'ka në mend të bëjë Mimoza Ahmeti, e cila ka premtuar të shkruaj një kapitull më vete për Besim Golemin. "Në të majtë të hollit dallova një figurë të gjatë, diçka midis një prifti dhe një dinozauri; ky ishte vetë Besim Golemi...Unë dhe Besimi ndenjëm gjatë aty mes pikturave, ku filloi edhe ajo miqësi e çuditshme për të cilën do të shkruaj një tjetër kapitull. Para se të nisej në emigrim, në Gjermani, ai erdhi disa herë në apartamentin ku jetoja asokohe te Rruga e Durrësit, me Aurelin. Më kishte bërë edhe një portret, që e ruaj edhe sot e kësaj dite, edhe kur u transferova e mora. Aureli ishte zakonisht indiferent, plot impenjim me botën e tij të përkthimeve dhe zbulimeve letrare. Besoj se ka qenë para ikjes në Gjermani, kur Besimi më la një seri nga bojërat e tij, furça dhe kanavace dhe më tha: "Përdori!"...Besimi më kishte prurë nga Gjermania libra arti, Munch, Van Gog...Me dedikime për mua: "Magjistares së madhe të fjalës". Kam vite, që e kam ngritur zërin për ta shpëtuar Besim Golemin nga harrimi, i vetmi që më është përgjigjur, një ish nxënësi i tij nga Divjaka, Enea Janko, i cili disa punime të Besimit i ekspozoi me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, duke u bërë dhe korniza nga më të shtrenjtat, të cilat më pas iu kthyen familjarëve. Iku nga kjo botë, duke lënë bojëra, furça dhe kanavacë, që të përdoren...



Një libër që nuk rrëfen ngjarje, por momentet kur njeriu thyhet përfundimisht. Në "Gruaja e Ambasadorit" të Arbër Ahmetajt, tragjedia nuk shpërthen: ajo piqet ngadalë, derisa bëhet e pashmangshme. Ka libra që fillojnë me një histori dhe mbarojnë me një kuptim. Dhe ka të tjerë që, përkundrazi, fillojnë me një fund, me një pamje të mbyllur, ku gjithçka ka ndodhur tashmë, dhe ku lexuesi ftohet të kuptojë jo çfarë ndodhi, por pse ndodhi.

Një nga këto çaste përmbyllëse, që funksionon si një çelës leximi për gjithë vëllimin, është një skenë e thjeshtë në dukje: një kryeqytet nën shi, tavolina të zbrazura, gazeta të shpërndara nga era - dhe një titull që mbërrin gjithmonë shumë vonë për të kuptuar atë që ka ndodhur:

"Të nesërmen në mesditë, shiu që nisi befasi me rrëshqerje zbrazi tavolinat e bareve. Njerëzit hynë ku të mundnin, karriget nisën poteren e u ngritën në ajër nga era e tërbuar, karrocet ngjasonin me ca kuti shkrepsësh që tundeshin e shkudeshin në mëshirë të fatit e kuajt varën kokat. Gazetat e lëna si mall pa zot fluturuan qiellit. Njëra prej tyre u ngjiti në dritaren e pajtonit. Një dorë elegante burri, veshur me doreza të zeza, guxoi të dilte jashtë dhe ta kapte. Ndonëse e lagur, gerrat e titujve kryesorë lexoheshin qartë.

- Pa hë, ç'thonë gazetaret sot? - pyeti të shoqin zonja Kambon. - Apo flasin për kthimin tim pas dy muajve në malet e Zvicrës, - u përpoq të bënte humor duke iu varur krahëve.

Zhyl Kambon u sforcua të buzëqeshte.

- Kështu do të jetë gjithmonë: ca ikin e ca vijnë, - foli gati me vete ai, pa ia ndarë sytë gazetës: "Ambasadori i perandorisë osmane dhe bashkëshortja e tij mbyllin jetën tragjikisht nga dëshpërimi se Franca njohu një shtet të ri në territoret e saj, Shqipërinë!". (fq. 209-210)

Kjo skenë nuk është thjesht një epilog narrativ. Ajo është forma e ftohtë e historisë, mënyra si tragjedia intime përkthehet në një titull gazete, si sakrifica dhe vetëvrasia reduktohen në një fjalë informuese. Dhe pikërisht në këtë hendek, midis zjarrit të përvojës dhe gjuhës që e ftoh atë, nis territori i këtij vëllimi.

Katër novela, katër hyrje në të njëjtin territor të errët, ku nderi, trupi, ideologjia dhe pafajësia nuk janë më kategori të qëndrueshme, por valuta që zhvlerësohen sipas një kursi të padukshëm moral.

Rexha, nga novela e parë, "Letra e një vrasësi", më i vogli i djemve të kullës së Oso Hysës, pak muajsh i martuar me Rozën e bukur, fsheh dramën e të qenit i paaftë për shtrat - jo burrë në intimitet, por që e shpall burrërinë e tij përtej çdo mase në çastin vendimtar: kur komanda gjermane rrethon kullën dhe kërkon ushtarin italian të strehuar në besë, ai del përpara dhe, në italishten e mësuar prej tij, pohon: "Unë jam Luixhi Pedesta di Torino", duke larë me jetën e vet nderin e shtëpisë dhe duke shpëtuar të gjithë të tjerët.

Në skajin tjetër të kësaj etike sakrifikuase (në novelën "Gruaja e ambasadorit") qëndron një ambasador, i cili e shndërron trupin e bashkëshortes në instrument diplomatik, duke e shtyrë drejt një akti që historia do ta regjistrojë vetëm si fakt dhe jo si tragjedi.

Ndërsa në një plan tjetër, më i ftohtë dhe më i errët, shfaqet gjuha e pushtetit, e reduktuar në raport dhe në procedurë:

"Kërkojmë praninë ose ndihmën e një mjeku për të kuptuar një fenomen të çuditshëm fiziologjik, armiqësor dhe provokues... Kemi vënë re se pas varjes në litar apo pushkatimit të armiqve burra, organi i tyre seksual çohet."

"Mors erectio", mendoj komisari. ("Ereksioni i të vdekurit")

Këtu tragjedia nuk përjetohet më: ajo administrohet. Reduktohet në term, në pikë,

Vëllimi me novela "Gruaja e ambasadorit" të Arbër Ahmetajt, "RL Bruksel", 2026

Një kuartet demonësh të fatit

Nga Agron Tufa



në raport. Dhe pikërisht në këtë reduktim lind grotesku më i fortë i vëllimit: një botë ku edhe vdekja kërkon interpretim teknik, ndërsa trupi i pajetë vazhdon të provokojë ideologjinë.

Dhe, në fund, një fëmijë, tashmë i rritur, që kthehet mbi një kujtim që nuk është më i pafajshëm, por i arkivuar si dëshmi kundër vetvetes:

"Pas shumë vitesh, në kohën e lirisë... Si dëshmi u përdor autokritika ime... M'u qesh. Gjithçka e së kaluarës mund të përdoret kundër së ardhmes sime... më duket sikur shoh trupin sa një lis të çobanit pararojë, duke i grahur... një kopeje njerëzish të mërdhirë pas një dimri të gjatë..." ("Qumështi armik")

Këtu historia nuk është më zjarr, as raport, por ironi e vonuar. Një e kaluar që rikthehet si dokument, si akuzë, si absurditet që nuk shuhet.

Nëse do të kërkohej një fjalë për t'i përmbledhur këto katër botë, ajo nuk do

të ishte as "tragjike", as "absurde", por "e pashmangshme". Sepse në universin e Ahmetajt, vendimet nuk merren: ato piqen në heshtje, si plagë që kërkojnë çarje.

Ajo që e bën këtë kuartet të funksionojë si një trup i vetëm është një ontologji e përbashkët e djegies. Personazhet janë pika ndezjeje, ku historia dhe ndërgjegjja përplasen derisa prodhojnë aktin - dhe ky akt është gjithmonë përfundimtar.

Leximi, për pasojë, nuk është rrjedhë, por akumulim tensioni. Një ngjeshje e ngadaltë që shpërthen në momente që nuk të befasojnë vetëm me të papriturat, por edhe me domosdoshmërinë e tyre të vonuar.

Në planin e gjuhës kemi një polifoni të kontrolluar: epika e sakrificës, gjuha burokratike e vdekjes, absurdi grotesk dhe refleksioni ironik i kujtesës. Të gjitha këto janë forma të ndryshme të së njëjtës përjepjeje për të thënë të pathënshmen.

Dhe pikërisht aty ku gjuha duket se

e arrin kufirin e saj, lind efekti më i fortë: ndjesia se ajo që lexojmë është mbetje e djegur e përvojës, diçka që ka kaluar nëpër zjarr dhe ka mbetur si dëshmi.

Këto botë përftohen në një "linjë të vazhdueshme zjarri", ku vendimet shpesh dalin të papritura, sikur kërcejnë nga thellësitë e fjetura. Kjo bën që lexuesi të përfshihet padurimthi në një lexim të ethshëm, pa pasur ndonjë siguri mbi perspektivën e rrëfimit. Pikërisht kjo "djegie e brendshme" i jep katër rrëfimeve tiparin e mprehtë të kinonovelave: ato mund të lexohen dhe njëkohësisht të përfytyrohen vizualisht si katër filma artistikë, secili me një këndvështrim stilistik dhe poetik të veçantë, ku çdo detaj i historisë shfaqet si një skenë e vetme, e ndërtuar me kujdes dhe tension të përhershëm.

Në mishërimin artistik të këtij kuarteti novelash i përket shijes së lexuesit të vendosë nëse parapëlqen linjat e shtruar apo ato me kërcime fabulare. Gjithsesi, në një farë poetike kompozicionale, te novela e parë, "Letra e një vrasësi", pavarësisht karakterit të saj të shtruar e të organizuar në dy linja binare me retrospektivat e vazhdueshme, që shtrihen në një hark kohor gjysmëshekullor, mund të ishin kursyer disa episode, që shprehin tensionin e "faktit të fshehur". Ato më shumë i shkojnë një kinonovele për film artistik (dhe novela paraqet një skenar thujse krejt të gatshëm) dhe me lënie jashtë të tyre, novela veçse do fitonte një "temperaturë" dhe "ngjeshje atmosferë" rreth bërthamës së saj. Dhe forca e saj do të shtohej edhe më fort.

Të njëjtën gjë mendoj edhe për novelën e dytë, "Gruaja e ambasadorit". Në këtë rast me fare pak episode më pak, tensioni do ta bënte lexuesin më të varur nga enigma që sjell trandjen në fund me tragjedinë, ndjesinë dhe perspektivën e hidhur meditative.

Përkundrazi, novela e tretë "Ereksioni i të vdekurit" dhe novela e katërt "Qumështi armik", janë përsosmërisht të paprekshme në ndërtimin e tyre. Kjo pak gjë i shton apo i heq harmonisë së errët e ngjashmë të këtij kuarteti harqesh me kujën mbi fatet individuale, shoqërore si lodër në duart e historisë dhe koniunkturave hierarkike të pushteteve.

Një gjë e them me siguri: vëllimi "Gruaja e ambasadorit" është një eksperiment mbi kufijtë e përballueshmërisë. Sa mund të mbajë një njeri? Sa mund të deformohet një e vërtetë? Sa mund të ftohet një tragjedi pa humbur krejtësisht kuptimin e saj? Dhe ndoshta përgjigjja gjendet pikërisht aty ku libri mbaron: midis një titulli gazete dhe një kujtese që nuk shuhet kurrë: aty ku heshtja mbetet më e saktë se çdo rrëfim.

Me këtë botim të ri, Arbër Ahmetaj përplotëson portretin e tij krijues me fillimet si poet, si mjeshtër i tregimit të shkurtrë miniaturesk, i tregimit klasik, i romanit modern dhe tani, me zhanrin tejet simpatik të novelës, si instancë e ndërmjetme në prozën e tij të pasur në sharmin stilistik, tematik e diskursiv.



Ironia është një mjet i fuqishëm i letërsisë. Studiuuesit e ironisë, madje, thonë se nuk ka letërsi pa ironi. Se është e tillë e vërteton të kuptuarit dhe të interpretuarit e shënuesve ironikë brenda një konteksti shoqëror, në të vërtetë të kuptuarit e gjuhës a të ligjëritit ironik.

Ironia - term që vjen nga greqishtja (*eironeia*) me kuptimin shndërrim, përqeshje, që në retorikën e moçme është quajtur trop, kurse sot në literaturën teorike konsiderohet figurë dhe trop, varësisht nëse realizohet përmes fjalës (trop) apo përmes një tërësie më të gjatë tekstore. Pas rrugëtimit të saj të gjatë nëpër shekuj, ironia ka ruajtur deri sot vendin e saj të rëndësishëm në letërsi, prandaj edhe në letërsinë moderne e sidomos postmoderne ajo zë vend qendror si strategji narrative¹.

Ironia konsiderohet edhe mjet stilistik dhe në këtë trajtesë për ironinë e Rexhep Qosjes në pesë romanet e tij si dhe në novelën e dramën e tij, ajo trajtohet si e tillë, pra si mjet stilistik, përkatësisht si veprim mbizotërues stilistik me ton diskursiv-mendimor i cili trajtohet përmes tipologjisë së veprimeve ironike dhe shënuesve stilistikë të kodit ironik. Po kështu, pos si figurë mbizotëruese stilistike, ironia trajtohet këtu edhe si qëndrim i autorit, si qëndrim i rrëfimitarit dhe si qëndrim i personazheve, sepse ironia e Rexhep Qosjes, me dallim prej figurave të tjera si metafora, alegoria, antiteza, oksimoroni, paradoksi, provokon fuqishëm emocionalisht si te ata që e kuptojnë ashtu edhe te ata që nuk e kuptojnë.

Nuk lihet anash gjatë trajtimit as semantika e ironisë dhe formësimi i kuptimit të saj, gjithnjë duke pasur parasysh ndërvarësinë e madhe të kontekstit të Rexhep Qosjes me kontekstin. Të gjitha veprat e tij, nisur nga "Vdekja më vjen prej syve të tillë", kërkojnë "lexim paralel: të lexohet teksti përballë kontekstit"².

Rexhep Qosja, si shkrimtar dhe si studiuues e kritik letërsie, e di fare mirë raportin letërsi - shoqëri dhe e di mirë si krijohet e si realizohet ironia. Duke qenë se ironia është jo vetëm proces i ndërlikuar i marrëdhënieve, i përdallimit dhe i kombinimit të kuptimit të thënë dhe të kuptimit të pathënë, por edhe proces i formësuar brenda një kulture³, për të realizuar ironinë duhet paraprakisht të kesh një shoqëri a opinion përkatës, në mënyrë që shigjeta e mprehtë e ironisë të godasë si duhet e ku duhet. Prandaj, ironia e Rexhep Qosjes është jo vetëm e shumëkuptimshme dhe e shumëllojshme, por edhe shumëdrejtimshe e shumëaspektore.

Jo rastësisht, ironia është konsideruar armë elitare dhe jo rastësisht është zhvilluar në qarqet intelektuale. Shkrimtari Rexhep Qosja me veprën e tij të vëllimshme e të shumanshme ka zgjeruar kufijtë e ngushtë të këtyre qarqeve, përkatësisht i ka rrënuar kufijtë e shoqërive të mbyllura. Ironia e tij ka shpërthyer kufij vendorë e kombëtarë dhe ka marrë tiparet e një ironie origjinale në letërsinë e në kulturën tonë.

Studiuuesit e njohur të ironisë më shumë se njëherë kanë shprehur "rrezikun" e ironisë, përkatësisht pasigurinë që ajo të moskuptohet prej atyre të cilëve u është drejtuar. Këtë "pasiguri" e këtë "rrezik" ironia e Rexhep Qosjes e ka tejkualuar mjeshtërisht, sepse teksti i tij është i lidhur shumëfishtë dhe ngushtësisht me kontekstin, pavarësisht nëse romanet e tij janë botuar në vitet '70, ose në njëzet vjetët e fundit, ose madje edhe sot.

Duke qenë e tillë ironia e Rexhep Qosjes, interpretimi i saj është shumë kërkuar dhe njëkohësisht jo i lehtë për trajtim, sepse

Ironia dhe estetika në romanet e Rexhep Qosjes

Nga Shefkije ISLAMAJ



duhet të përmbajë më shumë strategji e më shumë synime, kurse qëllimi i këtij vështrimi është dukshëm më i ngushtë dhe pashmangshëm jo gjithëpërfshirës, sepse ironia realizohet në ligjërim e kjo do të thotë se semantika e saj dhe përmasa e saj përgjithësuese nuk mund të trajtohet a studiohet ndaras aspektit shoqëror, politik, historik, kulturor, sociologjik dhe etik të kontekstit, ndërsa kjo gjerësi problemore i tejkalon kufijtë e një trajtimi gjuhësor e stilistik të ironisë si mjet dhe figurë stilistike.

Së këndejmi, ky vështrim gjuhësor e stilistik ka parasysh, pos të tjerash, faktin se ç'rol kanë emocionet në të kuptuarit dhe në përcaktimin e ironisë, gjithnjë duke pasur parasysh funksionin ekspresiv të gjuhës, sipas Jakobsonit, dhe gjithnjë duke ruajtur natyrën, formësimin dhe ndikimin e saj të jo drejtpërdrejtë. Ironia e Rexhep Qosjes nga ky aspekt paraqet një regjistër përcaktues, në të vërtetë shkallëzues të "fuqisë" së saj sipas funksioneve që ka. Fuqia e ironisë së tij lëviz prej shkallës më të ulët e deri te shkalla më e lartë e ngarkesës emocionale.

Të shohim dy shembuj:

"Kasandra di të parathotë të ardhmen, por Kasandra di edhe të bëjë shaka, i them.

Po të dija të bëja shaka unë në rrugë siç bëjnë ata në teatrin politik do t'i kisha punët më mirë se ç'i kam, jo, u shpreha gabimisht: do t'i kisha punët siç i kanë ata." ("Nata është dita jonë", 53)

Atdheu ynë po ndryshon me shpejtësi marramendëse.

Jemi të parët në Evropë! Me ekonominë tonë entuziaste! Me liberalizimin e tregtisë! Shqipëria 1 lek!

Jemi të parët në Evropë me shkallën e rritjes ekonomike - sivjet 9 për qind, kurse vitin tjetër do të jetë 13 për qind. Çfarë mrekullie! Franca ka rritjen ekonomike 2 për qind, kurse Shqipëria 9 për qind; Italia ka rritje zero për qind, kurse Shqipëria ka rritje 9 për qind; Gjermania ka rritje 2 për qind, kurse Shqipëria ka rritje 9 për qind; Anglia ka rritje 3 për qind, kurse Shqipëria ka rritje 9 për qind!

Jemi kampionë të Evropës:

me mirëqenien dhe me lumturinë e qytetarëve; ("Bijtë e askujt" I, 441)

Siç shihet nga këta dy shembuj, çdo funksion i ironisë ka anën e saj të mirë ose të keqe, pra pozitive dhe negative. Funksioni pozitiv i fuqisë sugjeron saktësinë dhe jo dykuptimësinë - te teksti i parë, kurse funksioni negativ sugjeron nënkuptimin, aluzionin - te teksti i dytë.

Veçori të përgjithshme

Veçoritë e ironisë së Rexhep Qosjes në rrafsh të përgjithshëm janë:

-zhvendosja e ironisë nga ligjërimi artistik në ligjërimin "shkencor" e "publicistik" të romaneve, me ndërthurje mjeshtërore kur tematizohen çështje që lidhin kulturën shqiptare me kulturën botërore, sidomos letrare dhe politike;

-prirja për të nxitur dialog të hapur për çështje nga më të ndryshme të jetës njerëzore dhe përpjekja për të rivendosur mundësisht gjedhe të reja kulturore e shoqërore;

- ndërvarësia e dukshme midis prozës së tij, kontekstit ironik dhe kontekstit shoqëror-kulturor;

- përpjekja për të krijuar paradigma të reja e për të zëvendësuar paradigma të vjetra dhe jo pozitive në kontekstin e situatave të emërtuara si kriza; siç dihet për ndryshimin e paradigmeve nevojitet kriza, jo qëndrueshmëria dhe pasiguria;

- ndriçimi i raporteve midis përbërësve të rëndësishëm të mënyrës së jetës shqiptare;

- bashkimi në një rrafsh i letërsisë së quajtur e "lartë" dhe letërsisë së e quajtur e "ulët";

- njëjtësimi i jetës publike me jetën private në kontekstin e forcës;

- shpotitja e realizmit socialist dhe zëvendësimi i modernes me postmodernen, sidomos ne romanet e fundit.

Ironia - semantika dhe estetika

Ironia e Rexhep Qosjes në rrafsh të përgjithshëm semantik aktualizohet në këto fusha konceptore e tematike: fati i

individit dhe fati i shoqërisë; intelektualit - shteti - familja; raporti burrë - grua; jeta publike - jeta private; individi - politika; politika - morali; identiteti - gjuha - feja; letërsia - politika; modernia - postmodernia; vlera - kici; liria - robëria; lufta - paslufta; njeriu midis dhunës dhe nevojës për reagim; dashuria - urrejtja; lindja - perëndimi.

Duke qenë se ironia është mjet i fuqishëm i letërsisë, ajo paraqet edhe një mjet të fuqishëm stilistik që zbulon shumanshëm një vepër letrare, që zbulon polifoninë dhe harmoninë e saj, që zbulon në të vërtetë aftësinë dhe shkathtësinë e shkrimtarit për t'i bashkuar e për t'i vënë përballë ato që bashkohen dhe ato që nuk bashkohen, ato që pajtohen dhe ato që kundërvihen dhe për t'i njëjtësuar ato pastaj në një tërësi më vete. Se është e tillë apo më mirë të thuhet se mund të jetë e tillë ironia, e zbulojnë qartësisht dhe mjeshtërisht romanet e Rexhep Qosjes, e zbulon ironia e tij plotësisht e veçantë në letërsinë shqipe. Krahas ndërtekstorësisë dhe kompozicionit, ironia e tij e fuqishme është treguesi më i dukshëm i modernizmit dhe i postmodernizmit të romaneve të tij. Si teknikë e si strategji mbizotëruese e postmodernizmit të tij, si ironia ashtu edhe porosia e romaneve të tij janë të natyrës dyvlerëshe, përkatësisht janë kundërvënëse. Në romanet postmoderne të Rexhep Qosjes, ironia si strategji narrative paraqet veçorinë qendrore dhe formën themelore ndëruese.

Të shohim mënyrën kryesore të ndërtimit të ironisë në tekstin e tij letrar:

"Nëpër të gjitha sheshet, rrugët e rrugicat jehon lajmi i pikëllueshëm:

Ka vdekur Kush Akxhiu!

Ka vdekur, Çerem, ka vdekur!

Ka vdekur! Përgjithmonë!

Në qiellin e Vajazanit është shuar një yll i atdhetarizmit!

Ka vdekur një atdhetar i madh, të cilin vajazanasi aq shpesh e kishin dëgjuar duke u betuar për flamur!

Ka vdekur njeriu që sot ishte i këtyllë, nesër ishte i atillë e pasnesër i këtyllë dhe i atillë!

Siç e lyp Atdheu, thoshte!

Kohë kameleonësh!

Kurrkush si Kushi nuk e njihte dialektikën.

Teza.

Antiteza.

Sinteza.

Përfolshmëria: profesioni më i leverdishëm Atje dhe Këtu!

Sivjet janë shtuar shumë vdekjet, sidomos, vdekjet e papritura.


Ç't'i bësh? Vdekjen e kemi më afër se jakën e këmishës.

Këmisha na lë, po vdekja nuk na harron.

Qyteti po rritet, kurse varret po zgjerohen." ("Një dashuri", 307)

Në teorinë mbi ironinë thuhet se ironia duhet të ketë cilësi të veçanta së paku minimale estetike, ndryshe nuk mund të quhet ironi. Ironia e Rexhep Qosjes në pjesën më të madhe të saj karakterizohet prej vlerës së shquar estetike, siç shihet edhe nga teksti i paraqitur më lart.

Thuhet po kështu se ironia, për t'u quajtur



¹ Në librin e saj "Irony's Edge", Linda Hutcheon e quan praktikë ose strategji diskursive, që funksionon në rrafshin gjuhësor (verbal) ose në rrafshin e formës (muzikor, pamor dhe tekstor). Shih: Linda Hutcheon, "Irony's Edge, The Theory and politics of Irony", Routledge, London, Neë York, 1994, f. 3.

² Ag Apolloni, "Parabola postmoderne", "OM", Prishtinë, 2016, f. 47.

³ Linda Hutcheon, Po aty, f. 89.

e tillë, duhet të përmbushë tri elemente çelës:

1. të përbëhet prej dy shtresave ose dy rëfimeve;

2. të shquhet me praninë e kundërvënies së dy shtresave që mund të jenë kontradiktore, mospërputhëse dhe të papajtueshme;

3. të karakterizohet me një si pafajësi, sipas së cilës "viktima e ironisë nuk është e vetëdijshme ose ironisti shtiret se ajo nuk është e vetëdijshme", të cilën Muecke-u e quan *papërgjegjshmëri e përgjegjshme e shkrimtarit*⁴.

Të tria këto elemente i përmbush plotësisht ironia e shprehur në shembullin e mësipërm ashtu sikundër përgjithësisht ironia e romaneve të Rexhep Qosjes. Në tekstin e mësipërm flet rrëfimtari, por edhe Çerem Çapari përmes gojës së rrëfimtari; ndërliidhen monologu dhe dialogu imagjinar; kundërvihen konceptet *atdhetarizëm* dhe *tradhti*; Kush Akxhiu ishte edhe **Kush** edhe **kurrkush**; ishte: *njeriu që sot ishte i këtille, nesër ishte i atille e pasnesër i këtille dhe i atille*, prandaj:

Në Varre u soll si atdhetar e u varros si hafje! Atë ditë nëntori kishte filluar radha e vdekjeve të dyfishta në Vajazan!" ("Një dashuri", 344)

E gjithë ironia e Rexhep Qosjes ndërtohet mbi kundërvënien, mospërputhjen e papajtueshmërinë. Shkalla e mospërputhjes midis kundërshtive ironike është anasjelltas proporcionale me shkallën e pasigurisë, që ndien viktima ose që ironisti shtiret se ajo e ndien këtë pasiguri. Ironia e Rexhep Qosjes e karakterizon edhe një estetike e lartë - estetika e të shëmtuarës.

Funksioni i ironisë

Në romanet e Rexhep Qosjes ironia kryen funksion stilistik. Duke qenë shkrimtar me ndjenjë të mprehtë për të vërtetën, duke ndier neveri për shtirjen dhe patosin e rrejshëm, ai e përdor ironinë si instrument më se të gjetur për të realizuar qëllimin e tij artistik. Ironia e madhe thonë se qëndron në mendimet aforistike, në epigrafet, në titujt e nëntitujt e romaneve, në fjalitë nistore dhe ato fundore e të tjera Shkrimtari e ka shfrytëzuar gjerësisht këtë lloj të ironisë edhe në këto mikrostruktura⁵.

Ironia, si figurë gjuhësore, përdoret në dy kuptime: në kuptim të gjerë, kur fjala e caktuar shpreh kuptim të kundërt nga kuptimi i saj tekstual, i fjalëpërfjalshëm, dhe në kuptim të ngushtë kur fjala a shprehja gjuhësore ka karakter shpotitës, përçmues. Në raste të tilla përdoren edhe figura e trope, aforizma, frazeologji, e të tjera.

"Në kohën e Keopsit, për të cilin është ngritur kjo piramidë, nuk mund të ndodhte ashtu. Jo. Kurrë. Ju thashë! Po përsëris: ai donte ta bënte Shqipërinë shtet. Të fortë. Me identitet. Me dinjitet. Me kulturë. Me moral. Nuk arriti!

Keni dëgjuar çka i kanë bërë për së vdekuri: ia kanë hequr zvarrë përmendoren!

Cilët?

Rrogëtarët! Hyzmeqarët! Puthadorësit! Puthakëmbësit! Këngëtarët e bëmave të tij! Shkrimtarët – himnizuesit e bëmave, të ideologjisë dhe të politikës së tij.

Bijtë dhe bijat e tyre!

Për së gjalli ia pinin ujin e këmbëve e për së vdekuri ia hoqën zvarrë përmendoren!" ("Bijtë..." I, 214)

Kjo lloj ironie rrënon teknikat tradicionale të rrëfimit dhe realizon funksione të shumfishta, në të vërtetë ajo është figurë ligjërimore polifonike, funksioni i së cilës karakterizohet me largesën e shenjës dhe të kuptimit, në të vërtetë të asaj që themi dhe të asaj që mendojmë.

⁴ Douglas Colin Muecke, *The comps of irony*, Methuen, 1969, f. 19-22; 32; cituar sipas Josipa Korljan Bešlić, "Ironija u prozi" *Dubravke Ugrešić*, tezë disertacioni, Universiteti i Zagrebit, Zagreb, 2015, f. 58.

⁵ Sh. Islamaj, "Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë moderne e postmoderne të Rexhep Qosjes, IA, Prishtinë, 2021, f. 292.

Ironia përforcon shprehjen dhe, siç është thënë edhe një herë në këtë krye, ajo mban baraspeshën ndërmjet binomeve: *e butë - e vrazhdë; e matur - therëse*. Ironia e Rexhep Qosjes është shprehje e inteligjencës dhe e kulturës së gjerë. Është metoda e tij për të realizuar funksionet e gjuhës në mënyra të ndryshme.

Veçori tipologjike

Ironia e Rexhep Qosjes përmbush edhe kriterin e të qenët ironi **e thjeshtë** dhe **ironi e dyfishtë** - klasifikim ky i studiuesve që e shohin ironinë të përbërë prej dy pjesëve a elementeve kundërshtuese. **E para**, ironia e thjeshtë, është *korrigjuese*, **e dyta**, **ironia e dyfishtë**, është *kundërshtuese* në shkallë të ulët.

Të shohim shembujt e këtyre dy llojeve të ironisë:

Ironia e thjeshtë (kundërshtuese): *"gruaja më e mirë është gruaja e marrë... (se) të jep trupin dhe shpirtin"* ("Vdekja më vjen prej syve të tillë", 23);

Ironia e dyfishtë (korrigjuese): (disa gra) *"kur ta japin trupin s'ta japin shpirtin; (disa gra) kur ta japin shpirtin, kanë humbur bukurinë e trupit."* ("Vdekja më vjen prej syve të tillë", 23);

Në romanet e Rexhep Qosjes dallojmë edhe *ironinë verbale ose ironinë e fjalës* dhe *ironinë situatore*.⁶ Te **e para**, *ironia verbale* ose *ironia e fjalës*, rrëfimtari, përmes ligjëritimit ironik, tregon se po ndodh diçka ironike, kurse te **e dyta**, *ironia situatore* rrëfimtari, përmes ligjëritimit, kallëzon situata ironike.

Një klasifikim tjetër shquan këto lloje të ironisë⁷: *ironia e hapur*, *ironia e fshehur*, *ironia private*, të cilat cilësohen sipas këtyre treguesve: *jopersonale*, *vetëvlerësuese*, *e mprehtë* dhe *e dramatizuar*⁸. Edhe këto lloje të ironisë mbushin romanet e Rexhep Qosjes. T'i shohim shembujt:

Ironia e hapur vetëvlerësuese dhe **e mprehtë** është ajo lloj ironie në të cilën ndjenjat mbizotërojnë arsyen, mbështetet në kontekst të gjerë, nuk fshihet vlerësimi, stigmatizohet objekti me nënqeshje dyshuese dhe identifikohet përmes kontekstit, megjithëse kuptimi i shprehjes i kundërvihet formalisht.

"Nuk keni dëgjuar, ndoshta, se Vajazani në mesjetë ishte qytet më i zhvilluar se Londra dhe Parisi?"

Kam dëgjuar.

Nuk keni dëgjuar, ndoshta, se paraardhësit tanë, ilirët, e kanë shpikur të parët pirunin.

Kam dëgjuar.

Nuk keni dëgjuar, ndoshta, se të parët e kemi pranuar krishterimin në Evropë.

Kam dëgjuar.

Nuk keni dëgjuar, ndoshta, se të fundit në Evropë e kemi pranuar islamin!..." ("Nata", 94)

Forma më e shpeshtë e ironisë së fshehtë është ajo retorike, e cila i drejtohet gjithkujt dhe askujt, pra të gjithëve. Këtë lloj ironie e ndeshim në romanet, e sidomos në dramat e monodramat e Rexhep Qosjes.

MOLOSI

Është më e çmuar jeta e një gruaje apo ardhmëria e qytetit? Është më e shtrenjtë jeta e një gruaje apo dita e kiametit?

MONUNI


Ç'është tërë ky shqetësim? Ç'është tërë ky ngurrim tani, kur dyert e të fshehtës janë çelë? Do të sakrifkohet gruaja, do ta qajë i shoqi, do të qajnë fëmijët, do ta qajnë fqinjët, do ta qajnë të gjithë, por ajo nuk do ta qajë veten. Se viktima vullnetare nuk vdes, ajo jeton dhe na mëson ashtu si e shikuar në muret e kështjellës. Qëndronte krenare, si malet e amshueshme." ("Mite të zhveshura", 288)

Ironia retorike ndërtohet në kontekst të

⁶ Po aty, f. 42.

⁷ Po aty, f. 59.

⁸ Po aty, f. 59.



gjerë dhe kuptohet lehtë nga të tjerët. Ajo nuk përmban ton përqeshës, po më shumë befasi dhe paradoks.

Një tipologji tjetër standarde ironinë e klasifikon dy llojesh: **të veçantë** dhe **të përgjithshme**⁹:

Ironia e veçantë

Kjo ironi në romanet e Rexhep Qosjes realizohet në tekst e kontekst të ngushtë dhe lidhet me njerëz, ngjarje e dukuri, që i përkasin një hapësire a bashkësie të ngushtë. Shkrimtari ka ndjeshmëri të veçantë për fatet e njerëzve të thjeshtë, prandaj tekstet që përshkon kjo ironi janë të ngjeshura me emocione, me leksik të përzgjedhur dhe me figurshmëri të lartë:

Ndoshta Trashen e kam harruar, po kurrë s'mund t'i harroj ata lot të saj mbi fytirën time. Atëherë isha kalama, por deri në këtë moshë, kur më quajnë të pjekur e të djegur, unë s'kam parë lot ashtu të pastër, ashtu të ngrohtë, ashtu virgjër.

Njerëzit s'dinë të qajnë.

Athua edhe për këtë arsye më kujtohet mëkatnorja e pafajshme?" ("Vdekja", 32)

Ironia e përgjithshme

Me dallim prej ironisë së veçantë, ironia e përgjithshme zakonisht realizohet në makrokontekste, pra në kufij shumë të gjerë si tekstorë ashtu edhe hapësinorë, globalë. Në romanet e Rexhep Qosjes, ajo realizohet në kontekste të gjera së pari mbarëkombëtare, mbarëballkanike, evropiane e më gjerë ku shtrohen, diskutohen, kritikohen çështje nga më të ndryshmet me ton të fortë ironik si këto: ekzistenciale a ontologjike, etike, filozofike, ideologjike, fetare, shkencore, kulturore, të artit e letërsisë e të tjera. Po sjellim disa shembuj:

Përse njeriu është i dënuar të vdesë dhe, më në fund, a është dënim për njeriun Vdekja? Njeriu nuk vdes pse e vret dashuria ndaj Njeriut! Njeriu nuk vdes pse e vret dashuria ndaj Atdheut! Njeriu nuk vdes pse e vret dashuria ndaj të Bukurës! Njeriu nuk vdes pse e harron Jetën! Njeriu nuk vdes për shkak se mund ta vrasë çfarëdo dashurie tjetër!

⁹ Muecke, Po aty, f. 121.

Merreni me mend se çka do të bëhej sikur mos të vdisnin njerëzit dhe mos të cofshin shtazët! Toka do të bëhej aq e rëndë saqë do të fundosej prej peshës së vet. Krijesat e gjalla vdesin apo cofin për arsye se natyra duhet të çlirohet prej tepricës së vet. Aq më parë duhet të vdesin çiftat e Xhezairit që s'i përulen vullnetit suprem. ...

Po mos të kishte Vdekje, Toka jonë do të ndizej flakë dhe flaka e saj do t'i kapte edhe planetët, edhe yjet, edhe Diellin dhe krejt Gjithësia do të shndërrohej në një shkumb të qelbur." ("Vdekja", 282-3)

Në këtë tekst - fjalim mortor të lexuar në varrimin e Xhezairit të Gjikkës, autori i saj Astrit Zeka, njëri prej folësve në varrim, në vend se të fliste për të ndjerin që po varrosej, vendos të flasë për vdekjen dhe të mirën e saj duke e përgjithësuar vdekjen e tij. Fjalimi është kryekrejt ironik. Më lart kemi shkëputur vetëm një fragment të shkurtër nga një tekst i gjatë ironik.

Romanet e Rexhep Qosjes dëshmojnë potencial të madh dituror dhe dhunti për të krijuar ironinë e përgjithshme, për të krijuar situata groteske të kombinuara me sarkazmin dhe satirën.

Vend të veçantë dhe denduri të lartë përdorimi në romanet e Rexhep Qosjes ka ironia e përgjithshme e quajtura **ironia politike**. Tekstet ironike të Rexhep Qosjes janë tekste të veçanta me të cilat komunikohet me veten e me botën. Ironia, si veçori e ligjëritimit të tij, është e ngjeshur me intelektualizëm, ndërsa shprehja gjuhësore e pasuruar me shumë elemente simbolike. Larmia e temave, të formësuar me veprime simbolike realiste, ku shquajnë vëzhgimet kritike intelektualiste, edhe kur kemi të bëjmë me fabula të zakonshme, të thjeshta, prekin thellë problemin e konfliktit të njeriut me shoqërinë. Si të tilla këto tekste ironike krijojnë strukturën e përbërë semantike të romaneve të tij dhe mënjanojnë çdo përpjekje për thjeshtëzim dhe trajtim përjashtues a të veçantë nga tërësia e tyre.

Ironia e Rexhep Qosjes është ndërthurur mjeshtërisht brenda teksteve të pasura ligjërimore, ndërtimeve të larmishme sintaksore, gjedheve të goditura kompozicionale, teknikave dhe strategjive virtuozë, mjeshtërisë gjuhësore-stilistike, veprimeve risistare rrëfimtare dhe kujtesës shumë të pasur të autorit. Ironia e tij në të

vërtetë zbulon mjeshtërinë për ndërtimin e romanit postmodern dhe shquan, bashkë me ndërtëkstosorësinë, intuitën e veçantë dhe erudicionin e tij të rrallë.

Të lexojmë edhe një tekst ironik:

-Të veshur si shenjtorë këtu shpesh kanë ardhur shejtanë! Janë pritur derëçelur e krahehapur

me bukë

e kripë

e zemër

e, mandej, nuk kemi mundur t'i dëbojmë, me lutje jo se jo, por as me shpata, me pushkë e me topa. ("Një dashuri", 32)

Në romanet e Rexhep Qosjes, ironia krijohet në situata nga më të ndryshme dhe me mjete e strategji të larmishme. Ndër to shquhen: Ajo funksionon në përputhje me botëkuptimin dhe pikëpamjet e tij filozofike, politike, shoqërore, kulturore, letrare dhe në pajtim me konceptimin e tij të mikro e makrobotës, ku përkasin shkrimtari, rrëfimtari a personazhet e tij.

Të vështruara edhe nga kjo pikëpamje, romanet e Rexhep Qosjes mund të quhen edhe romane-ese, romane filozofike, romane monologuese-asociative.

Teksti dhe konteksti

Në romanet e Rexhep Qosjes mund të zbulohen a identifikohen gjedhet e sjelljes shoqërore, posaçërisht politike, kulturore dhe etike, që paraqiten në mbarë hapësirën shqiptare e posaçërisht në Kosovë. Këto gjedhe të sjelljes shoqërore jo vetëm identifikohen, nga ana e shkrimtarit, por edhe ironizohen e satirizohen fuqishëm dhe me këtë veprim ai i hap mundësinë rikonstruktimit të tyre sipas një paradigme të re shoqërore, posaçërisht kulturore. Duke zbuluar këto gjedhe, në të vërtetë duke zbuluar plagë e të këqija të shumta të shoqërisë shqiptare, ai vë në dyshim edhe ekzistencën e një baze të caktuar shoqërore të ligjshme, të skajuar, rrjedhojat e të cilës kanë lëkundur edhe moralin shoqëror në përgjithësi dhe moralin e individit në veçanti. Temat e dhembshme njerëzore si rrjedhojë e praktikave negative mbizotëruese shtetërore, politike dhe shoqërore në përgjithësi janë objektivi qendror i ironisë së Rexhep Qosjes.

Duke shfrytëzuar letërsinë, dhe jo vetëm, sepse lexuesi e di mirëfilli se shkrimtari është edhe personalitet i tejangazhuar i jetës publike me shkrime publicistike, reagime, paraqitje mediale, ai jo vetëm paraqet njëmendësinë shoqërore, por dhe mundësitë e mjetet për ndryshimin e kësaj njëmendësie mbarëshoqërore dhe mbarëkombëtare dhe, sidomos, për ndryshimin e vetëdijes së lexuesve. Në përmbushjen e këtij qëllimi dhe të porosisë që përçon vepra e tij, ironia e Rexhep Qosjes është më se funksionale.

Romanet e Rexhep Qosjes janë të kufizuara kontekstualisht. Pa njohur veçoritë e hapësirës, të kohës, të kontekstit politik, shoqëror dhe kulturor, pa njohur historinë shqiptare, të vjetrën dhe të renë, e posaçërisht pa njohur periudhën e tranzicionit dhe të postranzicionit si dhe të aspekteve të tjera të rëndësishme shoqërore, madje edhe sociologjike, që lidhen me to, nuk mund të kuptohet dhe interpretohet sa e si duhet ironia e romaneve të tij.

Ironia, siç dihet, deri në kohën tonë postmoderne, ka kaluar rrugë të gjatë dhe është formuar dora dorës nga Sokrati, Platoni, Aristoteli, Shlegeli, Kierkegardi, Mani, Kafka, Llukaçi, Sartri, Adorno, Rorti dhe nga një numër i madh mendimtarësh, filozofësh e shkrimtarësh të tjerë të rëndësishëm, që nuk u përmenden këtu e që e kanë ruajtur vazhdimësinë e saj deri sot. Këta janë mësuesit më të denjë të shkrimtarit erudit Rexhep Qosja. Ai është formësuar mbi mësimet e tyre, prandaj ironia e tij sjell edhe frymën e ironisë së shekujve pararendës, sepse ai e njeh mirë trashëgiminë e pasur kulturore të njerëzimit

nëpër shekuj. Të shohim disa shembuj dëshmuar:

"...robëria e pakufizuar dhe liria e pakufizuar i asgjësojnë kufizimet: robëria të lirisë dhe liria të robërisë;

domethënë: duhet të jemi të robëruar për të qenë të lirë dhe duhet të jemi të lirë për të qenë të robëruar dhe robëruar;

robërit e shijojnë lirinë e vërtetë vetëm kur i robërojnë të tjerët;

ata nuk dëshirojnë të bëhen shenjtorë për të gjallë;

ata dëshirojnë të bëhen shenjtorë pas vdekjes;" ("Nata", 373)

Të kuptuarit, shpjegimi dhe interpretimi i ironisë së Rexhep Qosjes, prandaj domosdoshmërisht kërkon njohjen e kontekstit shoqëror, politik dhe kulturor ku formësohet dhe lëviz artistikisht gjithçka. Por, kërkon edhe njohjen e traditës më të mirë të ironisë klasike mbi bazën e së cilës është krijuar.

Ironia - figurë dhe mjet stilistik

Kufijtë e ironisë së Rexhep Qosjes kudo e kurdo; sepse mund të jetë e hollë, e butë, finoke, e mezivërejtshme, e fshehur, e zhveshur, e tërthortë, e zgërtheshme, e fuqishme, e rreptë, e egër, e pamëshirshme, e tmerrshme, vulgare e kështu me radhë. Edhe vetë buzëqeshja gjysmironike e Mona Lizës, që është bërë objekt studimi e shumë studiuesve në botë, do të shfrytëzohet mjeshtërisht në romanet e tij. Të shohim disa shembuj:

E dija çka po vlonte në lukthin tim dhe çka po bluhej në mendjen time: ashtu siç nuk më pëlqejnë buzëqeshjet misterioze, si buzëqeshja e Monalizës, pas të cilave fshihen gjithfarë ndjenjash të pritura e të papritura, refuzuese dhe përvetësuese, po ashtu nuk më pëlqejnë as seriozitetet e shtangura,

pas të cilave fshihen shumë nga pasanikët e rinj të Vajazanit, pas të cilave fshihen trashësia, krenaria e rrejshme, mashtrimet e gjithfarëlllojshme." ("Nata", 183)

Jo vetëm buzëqeshjen ironike të Mona Lizës, por edhe shumë çka nga kultura jonë e kultura botërore është shfrytëzuar nga Rexhep Qosja për ironizim ose si lëndë ironizuese për të ndërtuar ironinë.

Shtrohet çështja ku realizohet ironia e tij?

Rrafshet kryesore ku realizohet ironia e tij janë: ligjërimi i rrëfimtari, monologët dhe dialogët e personazheve, komunikimi zyrtar, shkencor, letrare: letrat, miniesetë, kujtimet, ëndrrat, domethënë në të gjitha romanet e tij.

Ironia në romanet e Rexhep Qosjes, ashtu si edhe në jetë, përdoret për baraspeshë të komunikimit. Ironia thuhet se është "çmenduri", që e mban gjithsekush brenda vetes, po jo të gjithë e shprehin. Atë e gjejmë aq shpesh në ligjërimin e tij artistik sa të krijohet përshtypja se ai e përdor ironinë jo vetëm kur vërtet paraqitet nevoja, por edhe kur kjo nevojë është dukshëm më e vogël. E kuptueshme. Sot në jetën tonë ironia është kudo e pranishme, prandaj nëse ekziston ndjenja për realitetin atëherë ironia e tejkalon çdo përvojë tonë. Ajo, në të vërtetë, në komunikimin midis personazheve kryen jo vetëm funksion rregullues baraspeshë, por edhe funksion polemizues. Përmes saj, personazhet shprehin pikëpamjet e tyre të ndryshme, më së shpeshti me tone kritike, duke ndikuar kështu në krijimin e karakterit të veçantë, në marrëdhëniet njerëzore, në zbutjen e tonit kritik të gjykimeve negative ose përcmuese, por duke mos e zvogëluar, madje shpesh duke e shtuar, vlerësimin kritik. Ironia e Rexhep Qosjes shpesh merr edhe funksion konvencional duke ndikuar kështu në vendosjen e besueshmërisë në marrëdhëniet midis bashkëbiseduesve.

Veçori e dukshme e ironisë së Rexhep Qosjes është kthimi i saj i shpeshtë në sarkazëm të fuqishëm, në ironi sarkastike. Ndodh që të përzihet me të ose me satirën.

Ironia e Qosjes edhe lloje të tjera klasifikimi, fjala vjen sipas kriterit sociologjik, si: *ironia retorike, retorika e sjelljes, retorika e ndodhisë dhe ironia dramatike*. Edhe këto lloje të ironisë i gjejmë në romanet e Rexhep Qosjes dhe i gjejmë në një mënyrë të trajtuar edhe brenda klasifikimeve të tjera, për çka nuk e shohim të udhës të trajtohen këtu si të veçanta as ato as këto: *ironia tragjike, ironia dramatike dhe ironia sarkastike*.

Mjetet e ironisë dhe format kryesore.

Mjete kryesore që shfrytëzohet shkrimtari Rexhep Qosja për ironinë janë të disallojshme:

1. mjete parajuhësore: gjeste, shprehje të fytyrës, intonacion, përkatësisht toni i zërit, pauza, përmes shenjave të pikësimit, e të tjera, të cilat shërbejnë për të shprehur qëndrime vlerësuese-emocionale.

2. mjete gjuhësore-stilistike, përfshirë këtu njësi të ndryshme leksikore si neologjizma, arkaizma, epitete, vulgarizma e të tjera, si dhe ndërthurje të stileve dhe ligjërimeve.

3. mjete gramatikore dhe morfologjike, përfshirë këtu fjalët emocionale-shprehëse, onomatopetë, pezhorativët, pasthirrmat e të tjera.

Ndërkaq **format kryesore** për shprehjen e ironisë në romanet e Rexhep Qosjes janë: gjuha ezopike, aluzioni, alegoria, perifriza, parabola, antiteza, citatet, simboli, krahasimi, përshkrimet në formë skicash e të tjera.

Përfundim

Ironia e Rexhep Qosjes i ngjan ironisë së Sokratit. Ashtu sikurse ironia e tij, edhe ironia e shkrimtarit tonë, nuk ka vetëm funksion estetik, po krahas tij ka edhe funksion të iluminimit. Drejtpërdrejtësia dhe saktësia e ironisë së tij është mbresëlënëse. Me ironinë autori përshkruan në mënyrë objektive, por lehtësisht të fshehtë, gjendjen reale, dukuritë e ndryshme, personazhet e ndryshme, të mirat dhe sidomos të këqijat. Lexuesi ka mundësinë ta zbulojë dhe ta kuptojë ironinë e tij sado e përbërë dhe figurative të jetë ajo. Ironia e tij, prandaj, vendos lidhje të fortë midis rrëfimtari dhe lexuesit.

Ironia e Rexhep Qosjes është e shumëlllojshme, e shumëkuptimshme dhe shumëndikuese. Të tillë e bëjnë përmbajtja, situatat, personazhet, dialogët, monologët, ligjërimi, figurshmëria, gjuha, stili.

Dendësia semantike e ironisë së Rexhep Qosjes, sidomos e ironisë së situatës, është karakteristikë thelbësore e saj. Për faktin se karakterizohet edhe për epshmëri (elasticitet) dhe me ngjyresa pa fund të larmishme, ajo shquhet me natyrën e saj herë plot gëzim e ndriçim, herë të ftohtë dhe të errët, herë shumë emotive, herë të dykuptimshme e herë të dyshimtë, duke krijuar kështu antinomi origjinale e cila përjashton mendimin konvencional e logjik. Mbi të gjitha, ironia e Rexhep Qosjes ka karakter të fortë kritik, si karakteristikë e epërsisë shpirtërore e intelektuale të shkrimtarëve të mëdhenj.

Shkrimtari Rexhep Qosja nuk shkruan për ta argëtuar lexuesin, por për ta përfshirë në ato që ndodhin në botën artistike të romaneve të tij, në të vërtetë ai shkruan për ta ndryshuar lexuesin. Dhe, arma e tij e fuqishme për këtë qëllim të lartë është pikërisht ironia.

(P.s. Variant i shkurtuar i një punimi të gjatë).



Lajmi për ndarjen nga jeta të Profesor Rexhep Qosjes më gjeti larg Prishtinës.

Po kthehesha nga Ulqini pas promovimit një natë më parë të librit tim të botuar në Podgoricë. Gjithçka shkoi mirë, madje shkëlqyeshëm, falë kujdesit të botuesit dhe organizatorit të takimit. Rrugës, pak pasi dola nga qyteti, ra telefoni. Ishte kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, Faik Nika, me të cilin pothuajse sapo qemë ndarë. Më pyeti se a kisha pasur vështirësi për të dalë nga qyteti, ku po meremtohesha rrugët në prag të sezonit turistik. E falënderova për kujdesin dhe kur po bëhesha gati ta mbyllja bisedën, më tha: "Edhe diçka, profesor. Paska vdekur profesori për të cilin folëm pak më parë".

Më shkoi mendja te kolegu im i Fakultetit dhe intelektual i njohur i kësaj ane, Ruzhdi Ushaku, në gjendje të vështirë shëndetësore, të cilin e pata përmendur po ashtu në bisedë. "Jo, tha Faiku, Rexhep Qosja!". U stepa. Mbeta pa fjalë. Më informoi edhe se varrimi tashmë ishte kryer, në praninë e rrethit të ngushtë familjar, sipas porosisë me shkrim të Profesorit.

Sakaq më erdhi në mend biseda që patëm bërë pak më parë në hotel Continental. Duke pirë kafe rreth tryezës, ku ishin edhe ime shoqe, e fejuara e Faikut, Arlinda (moderatorja e mbrëmjes) dhe konsulli i Shqipërisë në Ulqin, Arben Doçi, pata evokuar një kujtim nga puna jonë e përbashkët me profesor Qosen.

Ishte anëtar komisioni i njërit nga kandidatët e mi në doktoratë, i cili ato ditë ma kishte dorëzuar versionin e tretë të punimit. Profesor Qosja, i cili si mësimdhënës nuk shquhej për kritere shumë të rrepta, kishte vërejtje për punimin. "Ky punim nuk është monografi, pati thënë, por përmbledhje artikujsh". Vërejtja ishte deri diku e drejtë, por unë si mentor tashmë ia kisha dhënë "vizën" kandidatit. Biseda, ku ishte i pranishëm edhe anëtari i tretë i komisionit, zgjati bukur shumë. Dikur unë, që kisha nisur ta humbi durimin, i thashë: "Profesor, kanë doktoruar kandidatë shumë më të dobët se ky!". Më pa në sy, përmby syze, siç vepronte në raste të veçanta dhe tha: "Po, por ata nuk shesin mend, këta (aluzion te kandidati dhe shokët e tij), shesin mend!". Dhe ma mbylli gojën. Mirëpo mbrojtja, megjithatë, u bë.

Dhe ja tani, lajmi për ikjen e njeriut që zhvilloi aq shumë beteja intelektuale në jetë, me gojë e me shkrim, dhe që tani e tutje nuk do të mund të flasë më, pos nëpërmjet veprës së tij të madhe e të papërsëritshme.

Lajmi më erdhi gand dhe m'u duk gati i pabesueshëm. Nuk kishte dy-tri javë, shumë-shumë një muaj, që kisha folur me të dhe as ndër mend nuk më shkonte se kjo do të ishte biseda jonë e fundit. E dija se i qe keqësuar gjendja shëndetësore, por, thosha me vete, është koskë e fortë dhe nuk dorëzohet lehtë.

Kisha në plan të shkoja nga Ulqini në Tiranë te çika (këtë fjalë përdorte profesor Qosja kur fliste për të bijat) dhe për të takuar miqtë e mi, shumica e të cilëve ishin dhe janë miq tanë të përbashkët, por ndërrova rrugë. Edhe pse varrimi tashmë ishte kryer dhe "të pame" nuk do të kishte, unë, megjithatë, nuk mund të mos isha në Prishtinë këto ditë. Nuk do t'ia falja vetes.

Te Ura e Bunës, aty ku takohen Drini dhe Buna, ky simbol i madh i bashkimit kombëtar, u ndala dhe piva një kafe për shpirt të Profesorit. Ndërkohë celulari im cingëronte pa pushim. Vazhdonin telefonatat e mesazhet ngushëlluese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe nga bota e jashtme (Visar Zhiti nga Çikago, ambasadori Këçmari nga Tokio, Xhafer Shatri nga Zvicra...) dhe thirrjet e pareshtura nga gazetarë që kërkonin t'u shkoja në emision ose të bëja ndonjë prononcim për mediet e tyre.

Ditën e nesërme, më 24 mars, në Kosovë ishte ditë zie. Fola në tre televizione të Prishtinës për Profesorin dhe mora pjesë në mbledhjen përkujtimore të mbajtur në Institutin Albanologjik, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri Kurti, që mbajti një fjalë të mirë si gjithnjë.

Desha të bëj një shkrim në formë studimi, por hoqa dorë. E lashë për më vonë. Sepse shkrime të tilla kam bërë edhe më parë. Vendosa të merrem këtë herë jo me temat, idetë dhe e mendimet e Qosjes, por me disa "cikërrime", sepse edhe ato janë pjesë e jetës dhe e jetëshkrimit të gjithsecilit, andaj edhe e njerëzve të mëdhenj.

Dy të mëdhenjtë e letërsisë shqipe, Kadareja dhe Qosja, patën disa përplasje gjatë jetës

Si e përjetova lajmin për ikjen e mësuesit dhe mikut tim të madh Rexhep Qosja

Qosja, Një Monument.

Nga Agim Vinca

Rexhep Qosja nuk është një individ, por një institucion. Me ikjen e tij mbyllet një epokë në letërsinë dhe kulturën shqiptare, por edhe në jetën tonë kombëtare: "Epoka Qosja". Njeri me energji të pashtershme krijuese dhe me përkushtim të madh ndaj punës krijuese, letrare dhe shkencore, për të mund të thuhet se krijoi një Vepër, pa të cilën nuk mund të imagjinohet kultura shqiptare e gjysmës së dytë të shekullit XX dhe e çerekut të parë të këtij shekulli.



Me Profesor Rexhep Qosjen në Institutin Albanologjik

së tyre. Më e madhja ndodhi në vitin 2006 kur debatuan për identitetin e shqiptarëve si komb, debat në të cilin u përfshinë edhe shumë të tjerë. Kadareja fliste me të drejtë për identitetin evropian të shqiptarëve, ndërsa Qosja, pa e mohuar këtë përkatësi, shtronte nevojën e vënies në pah edhe të elementit oriental, krahas atij perëndimor, në kulturën dhe qytetërimin shqiptar. Njëri fliste kryesisht si shkrimtar, tjetri kryesisht si studiues, që identitetin e shqiptarëve e sheh "të përbërë", të tillë çfarë është edhe shoqëria shqiptare. Ata që Qosen e shpallën "fundamentalist" me atë rast, do të jenë zhgënjyer e, mbase, edhe penduar, kur kanë parë se akademiku "i devotshëm" la amanet të varroset pa ceremoni fetare, që do të

thotë pa imamë e hoxhallarë.

Nuk përjashtohet mundësia që Qosja të ishte xheloz ndaj namit ndërkombehtar të Kadarese, ashtu sikurse Kadareja ta lakmonte ndikimin e fjalës së Qosjes te pjesa dërrmuese e inteligjencias shqiptare në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë.

Por le ta shohim edhe anën tjetër të medaljes.

Kur Ismail Kadareja u largua nga Shqipëria dhe kërkoi azil politik në Francë, në tetor të vitit 1990, Rexhep Qosja i pati dhënë "Zërit të Amerikës" deklaratën e famshme, ku, ndër të tjera, thuhej: "Unë do të doja që Ismail Kadare betejën e tij mendore për Demokracinë ta kishte bërë atje, në Shqipëri, bashkë me kolegët

dhe me vëllezërit e tij të tjerë. Por, Ismail Kadare ka zgjedhur rrugë tjetër. Kjo rrugë mund të mos na pëlqejë, por e ka zgjedhur intelektual që i thonë Ismail Kadare".

Vijmë te një moment tjetër, më i vonë. Kur u shua Kadareja, në korrik 2024, Rexhep Qosja nuk heshti e as nuk shau, por shprehu konsideratë të lartë për "rivalin" e vet dhe veprën e tij me "vlera të gjithmonshme". Njësoj veproi edhe disa muaj më parë, kur u shënua 90-vjetori i lindjes së Kadarese, në janar të këtij viti, duke treguar kështu etikë e fisnikëri konform traditës kombëtare, por edhe e kulturës së madhe humaniste, universale.

Mëma Shqipëri nuk mbajti zi për birin e saj të madh. Kryeministri u mjaftua vetëm me një fjalë në instagram: "Lamtumirë, shqiptar i mirë!" Aq. Asgjë më shumë. Shqiptar i mirë mund të jetë edhe bujku që punon në arë, edhe mësuesi që i mëson nxënësit në klasë, edhe nëpunësi që e kryen punën e vet në zyrë, edhe mjeku që mjekon të sëmurët në spital dhe shumëkush tjetër. Rexhep Qosja, i lindur në Vuthaj 89 vjet më parë dhe i ardhur në Kosovë, si shumë të tjerë, në vitet pesëdhjetë të shekullit që lamë pas (nuk munguan as ata që e quajtën "ardhacak"), nuk i takon vetëm Kosovës, por edhe Shqipërisë dhe mbarë Kombit shqiptar. Ishte dhe vazhdon të jetë Shqiptar i Madh, jo pse kërkonte bashkimin e shqiptarëve në një shtet (e jo "Shqipëri të Madhe", si thuhet gabimisht), por pse ishte atdhetar i madh, intelektual i madh, dijetar i madh dhe mendimtar i madh. Dhe mbi të gjitha studiues i madh i letërsisë dhe krijues i madh i saj. Në mos tjetër, Rexhep Qosja është një nga njerëzit që e sollën në pushtet Kryeministrin e përtashëm (fjalë e preferuar e profesor Qosjes), duke i thënë se si kryetar i PS-së duhej t'i nxirrte duart nga xhepat për të luftuar PD-në dhe Berishën, gjë që Edi e ka pohuar vetë në një rast.

Dhe ja çudia! Berisha e vajtoi Qosjen më mirë se Rama. Ai kishte të drejtë të heshte e mbase edhe të shante, sepse akademiku nga Prishtina s'ia ndau dajakun vite me radhë, por ndodhi e kundërta: Sala u shpreh me fjalë të zgjedhura për kritikun e tij të madh. Dhe ec e mos thuaj pastaj se Shqipëria është vend ku lulëzojnë paradokset!

Rexhep Qosja nuk është një individ, por një institucion dhe një epokë. Me ikjen e tij nga kjo botë mbyllet një epokë në letërsinë dhe kulturën shqiptare, por edhe në jetën tonë kombëtare: "Epoka Qosja".

Në vitin 2010 u botua VEPRA e Rexhep Qosjes në 29 vëllime, që është korpusi më i madh i botuar ndonjëherë në kulturën shqiptare, por kjo nuk është e tërë vepra e tij, sepse në të, përveç tre librave të parë, të fillimeve krijuese (*Episode letrare, Dialogje me shkrimtarët dhe Kritika letrare*), nuk është përfshirë ditari i tij *Dëshmitar në kohë historike*, që mbulon periudhën nga viti 1966 deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, si dhe dy-tri vepra të tjera të botuara më vonë. Vepra e fundit *Për Lirinë, të Vërtetën dhe të Drejtën* (2024) është një *Ultima verba* e njeriut që gjithë jetën ia kushtoi emancipimit shpirtëror të Kombit të vet, por edhe vlerave sublime të jetës njerëzore: Lirisë, të Vërtetës dhe të Drejtës.

Me veprën e tij të madhe, monumentale, ai i ngriti vetes përmendore qysh për së gjalli. "Exegi Monumentum", do të thoshte Horaci plak.


Do të mund ta mbyllja këtë fjalë të përmortshme me një citat.

Kur Tolstoi u sëmurë dhe ra në shtrat, Çehovi shkruante: "Unë frikësohem nga vdekja e Tolstoit, madje akoma më shumë jam në ankth. Përse? Sepse autoriteti i tij moral na mbron nga shija e keqe në letërsi dhe nga sjellja servile në shoqëri".

Qosja ishte autoritet moral, që do t'i mungojë mjedisit tonë krijues dhe intelektual.

Kurdo që ndodhte diçka, për mirë a për keq, në Kosovë a në Shqipëri, dhe kudo tjetër në hapësirën shqiptare, ne prisim çdo të thotë Rexhep Qosja. Kështu ndër vite e dekada. Dhe fjala e tij nuk mungonte: e drejtë, e rreptë, e qartë, kritike, por edhe e urtë, vlerësuese, frymëzuese e nxitëse, sipas rastit dhe nevojës.

Po tani çdo të bëjmë? Si do të veprojmë? Do të kërkojmë ç'ka thënë Rexhep Qosja në shkrime, në intervista, në artikuj, në studime, në drama, në romane, në tekstet polemike, në veprat letrare e shkencore... Sepse Rexhep Qosja, ai i vërteti, i dituri, mendjelarti, vizionari e i pavdekshmi, është aty, në librat e tij.



1-E pandodhur

Asgjë nuk ka ndodhur!
Veçse copëza të grisura, nga fustani i kujtesës
i mori era ...
U zbathën rrënjët, që nuk ngulëm dot thellë
ne, endacakët e shekullit të ri.
Recetat e nënës si lojë e mendjes
e vetmja dëshmi e origjinës
së shqyer nga uria
ngjita mbi frigorifer..
Ekzistenca luan nervash, të më bindë
se të gjitha dashuritë fillojnë në kuzhinë
Sajova fërgesën për time bijë
Për atdheun tërholla një byrek
me petë të pjekura
por, asgjë nuk ndodhi sërish!

Nuk munda të telkaloj vehten!
Lëkura e gruas së bindur nuk ra!
Nuk i zgjidha misteret me pyetje!
kur përgjigjet, nuk i kisha më
Mendova shekullin, bregun, dikushin
ankoruar në përpjekjen time
në kohë të gabuar, si panevojë!

Kisha dremitur pak ...
Ishtw zbardhur
kur kaosi i ra fjalëve
e harresa, njerëzimit
pa u shqetësuar, nga luhajat e historisë
I verbër pranimi
Një palë sy, për dy njerëz
plotësisht në dashuri me nj-tj
vrasin rutinën e re në këtë vend!

Asgjë nuk ka ndodhur
vec të ftohtit që ndjejnë kujtimet
kur i besuan copave të grisura
të një fustani, sjellë nga Atdheu
ku thuhej:
- 100%pambuk ,
-zbardhet nga agjentët atmosferikë
-I paimunitet të jetojë pa diell
në një qytet me liqen gjigand
e pa kështjellë...

Mbetëm rrënjëshkullor në të dy anët!

2-Legjenda e Malit të Vashës...

Dekori i pranverës rebelohet si fëmijë motak,
duke gjalluar rishtas brigjet e Shkumbinit;
ngop etjen e tij
mbi gjurmët e rizgjimit

Këmbët mbi Malin e Vashës
i dorëzohen shkëmbit
që bie thikë përmbi rrjedhë
jehona shkrepëtin zërin pa pezme
të një dashurie mes dy botësh ndryshe,
me shpinë nga lind dielli.

Fluturimi dhe era atje, mbi pyllnajë,
largojnë me gishta horizontin;
thyejnë heshtjen e mbivendosur
mbi ajrin bosh
nga legjenda e zverdhur tash sa mote.

Legjenda ish' dorëzuar majë mali...
Vasha drithëroi e klithi fort:
- "Nuk mundem pa ty, i dashur!"
Kërrusur nga dhembja, si pemë e thyer,
thithi aromën e fundit të natës
e hëna e plotë u fsheh në mosqenie,
Vasha u hodh mbi lumin
ku një herë në një mijë vjet flijohet
kurbani i një dashurie të pamundur...

3-Me vehten

Një flutur mes barit pranveror.
dhe vesa, gjerbon si vajtoçë,
sa për të zgjuar mëngjesin,
si drithërimë

Fletë me shkronja të panjohura,
ngecur në kangjella,
me fjalë që ngjiten në qiellzë,
deri në marrje frymë.
Shkumëzojnë sytë ketra të uritur,
Tavlla e duhanit, tkurr mërçitë



IRENA DRAGOTI

Gratë e moshës sime

Alarmi i zgjimit,
harruar në listën e humbjeve
për tri vende pune,
ku tani ecin të tjerë...
Llambat led nën fustanin e diellit
fshijnë me mëngët e kujtesës.
hidhësirën e debatit me tim bir

Një e qeshur zëllartë
rrëzon kafënë në thurjet prej kashte,
Koka, rënduar me ëndrra nate
ul ditën e pluhurosor,
si një kufi luftime
që bëj me veten papushim.

4-Kufi

Perëndimi nuk rri gjatë në një vend;
thërrmohet në zjarminë e yjeve,
sa herë zëri kapërdin heshtjen.

Preferoj parajsën, me pranim lutjesh
Zilisem zogjve që arrijnë qiellin;
Më mbahen fjalët në kapërcim të kufijve
për tu zbardhur
si një letër bosh...

5-Mungesash

Klithi gjumi në shtrat sonte.
E u ngrit mbështetur
në bërryla heshtjesh,
pa hënë, as mëngjes
ish' rrëzuar syve
e vvarë, nga mungesa...

6-Zgjedhje

Është fundjavë...
Rradha fërshellen si tren me avull,
poshtë kazinosë "Greek Town".
Lagjja dehet me muzikë buzuqesh;
si gërhitje e fjetur keq...
Në semafor të njëjtat drita pulsante,
që duket sikur kërcejnë këngë vaji.
Një zë burri ringjall harpën nga brinjët e lodhura
për të dashurën e tij,
që braktisi gjysëm shekulli më parë,

në Athinë..
Ai përsërit ngjirur, të njëjtat vargje
pa përcjellë të plotë historinë;
enigmash vërtitem si një konkurs
deri te vargu i dytë...
"Asnjë princ i kaltër nuk u nis për atdhe, -
thoshte kënga;
asnjë varr nuk mori trokun e kthimit."

Buzët avullojnë melodi Epiri,
në lagjen greke, këtu në Detroit.
Koha ngec aty , ku zgjedhim;
Duke e ndjekur,
kemi mbetur pa stacion;

7-Kuptim

Mëngjes me mendje shtrigash.
Gris natën në lëkurë të ajrit
nxjerr dritën prej syve të arnuar
kuptimin merr, mes buzësh,
si fjalët...

8-E pagjumë

Përgjatë natës, frymoj vetminë.
Gjumë nuk kam!
I gjej një shtrat dhe një ninullë
e bëj fëmijë;
ëndrrash luaj...

9-Pisha lojcake

Unë jam pisha e parafundit
në kufirin e gjelbër fqinjor,
me degëza të hajthme,
më e vogla flokëdritë,
që luan kukafshehtas
me hoizat e rrjetës së metaltë
të kopshtit fqinj,
ku dielli djeg vesën në fillim.

Kujdesem të thyej mitin.
Kufijtë më të hekurt
janë mendjet, që kullojnë gjelbër...

10-Sa keq më vjen për rrugët

Në këtë qytet të madh pa qendër
e bukura majë takash,
trotuaresh të zbrazëta
nuk përbën lajm!
Ajo është si një yll që bie
ditën për diell
pa asnjë dëshirë në krahë.

Në këtë qytet ku mbijeton harresa
e bukura vërtitet në orbitat e vetes
si një fjalë e pafolur sdihet se sa..
Sytë fsheh xhepash,
si mjegull e pagojë
aty ku ajri e lë kohën, bosh.

E gjersa ti vdesë dëshira e paradës,
mos e pyet ku ishte
as pse u plak...

Sa keq më vjen, për rrugët!

11-Këngë djepi

Kohë e vrenjtur edhe sot!
Mjegulla ka rënë në gjunjë!
Një ketër gri mendohet!
Fëmijë të panjohur lagjeje,
numëron kafja ime e parë.
Më derdhet vetja në prehër!
E kthej përmbys, të lexoj ëndrrat
si një ditë e lodhshme pune.
Kafja u ftoh!
nga shikimi i trishtë i qiellit,
që mban në duar, një djep
me dy këngë në të , në dy gjuhë...
për dy epoka që treten,
si dy raste përjashtimi,

Në luhajat stinësh
vetminë zhvesh me tingujt
e një të qeshure të panevojë.
Vera këtu nuk vjen asnjëherë në kohë

12–Pështjellim

Në moshën time
frika drithëron mes gulçimeve të veta
si deti!
Herë si shpresë në gjysëm rrugë
që nuk vjen pa lëshuar zë.
Kokën mbështet ,
në pafuqinë për të besuar
te hijet,
te hapësira e pushtuar nga dilemat
për të thënë me fjalë që bëhen gulç në fyt
pengje zemre.

Në moshën time
frika, si pema e tharë, e ëndrrave,
që guxove të braktisësh
kur gjithçka nisi të dhembë.
e lodhur pret të shpërngulet
brenda një luleje
që i dorëzohet edhe pranverës...

13–Ndoshta

Ndoshta duhen fshirë retë, që zënë rrugën.
Mjaft t'i lutemi diellit, t'i kthejë në shi
për të shuar etje pulëbardhash
mbi delta ngjyrë lumi,
sa një frymë dashurie..
Fosilet e algave me gojë të çelur
lëshojnë stërkala urie
për hijen e së shkuarës si ngushëllim

Udha e hareshme vdiq
prej gjurmëve të palodhura të ambicies
Tash' shoh lumturinë nga lart si gjithësia ,
Më jehojnë humbjet dhe fitoret
që u fundosën si britma,
në herbariume mosprekjesh,
me etiketa plastike!

Këto të gjitha
e ca mbetje fjalësh naive,
përcjellin përrallën e guximit
që nuk strehon dështakë
me gëzim pelegrinësh pa përvojë
duke ndalur vehten, aty ku s' e njohin

Ka ardhur koha të frigoresh
nëse hap një shteg nga pengjet
e punë e pambaruar ke lënë dhimbjen
e rob ke zënë guximin!

14–Mungesë

Jam një grua pa të shkuar!
Gjithçka flas janë mornica mushkërie në ag,
kur ëndërroj në këmbë si kuajt...

E ardhmja më zhvishet njëjtë.
kur gjyshja ime e patakuar,
dhe nëna ime e pafjalë
verbtaz ndoqën dritën e parajsës,
pa i ndërruar statusin mungesave!
Historia mbeti pezull
si faturë e papaguar lirie!

Ime bijë hedh dhe pret lirinë,
pa ankthin e rrëzimit...
Guximi i saj mund të mërdhijë,
pa vrazat e ndërgjegjes,
Ia njeh tiparet një qyteti
ku aroma e lirisë klith
si vera, nga britma e shirave.
Ime bijë i vë shenjë pragjeve të lirisë
me yjet;
rigjen botën nga eklipsi i zemrës
Vesh krahë ere
edhe pse ia dëshmovta pafuqishëm
mundësitë e një gruaje për të bërë gjëra të mëdha,
pa modele.

Jam një grua pa të shkuar,
Liria ime si besnikëria e kafshëve
Nuk e kafshon hijen e saj
Mëngjesesh ende luftoj
për një betejë të humbur kaq vite

15–Frymëzim

Kur u lindi,
u çirova nga dhembja,
sapo trupit më lanë gjakun.
Të terur më gjetën udhët e erës
kur më morën në krahë.
Më pranuan,
si një lindje e pakëmbyer me fatin.

Rakia nuk ishte gostia,
as krismat në qiell.
Isha vajzë;
unë, fëmija ardhur prej mungesash,
kur lëkura ndjeu të ngrohtë e syve,
dhurova lotët e faljes.
Isha gati për të dalë jashtë plaçentës
si një triumf i nënës sime mbi frikën.
Ajo më këndoi:
- "Bëhu rrjedhë lumi, pa humbur brigjet;
gjurmët lër në deltë,
si një këngë e lumtur për njerëz ..."

16–Armëpushim

Babai mbillte çdo vit
pronën që trashëgoi nga i ati,
t'a mbrojë nga harresa.
E vilte, që të sigurohej për kufijtë.
Koha ecte...
Rrëfenjat e babait për tokën e të parëve
i ngjanin tymit të ullinjve
që ai dogji vjeshtës së tretë
dhe i fiku me rrobat e tij, tekta flinte.

Koha ecte...
Ajo s'i teproi asnjëherë
për testamentin
Kur një ditë ai humbi kthimin,
ne fshimë arsyen..
I dënuar me liri
e burgosnin veç duelet-monolog
me ngrënësit e kufijve.

Prona, si pasthirmë i mbeti duarsh.
Vesa ia treti premtimet
Babai iku pa pronën e gjyshit me vete.
Amanet na la" armiqtë"

Unë jam ndryshe...
Pronën e babait e dhurova.
që të humbem
Ullinjtë ende kanë armiq.
Unë shpalla armëpushimin!

17–Gratë e moshës sime

Gratë e moshës sime,
si një stinë e arrirë
mëngjesesh, pulsojnë zemrës, sipas zërit.
Në trafikun dypërmasësh,
mbi hartën e pagjumësisë,
kafshojnë buzësh në vetmi
vargjet e një kënge nga atdheu.

Shpërthyesë,
si aroma kolumbiane e kafesë,
tek lexojnë tabelat e çmimeve të naftës,
kujtohen për rrudhat që ju bëjnë mungesat
dhe një pluhur harrese hedhin mbi mallin.
Gishtërinjtë iu qajnë nga lagështia;
Copëza kujtimesh zemrën iu thinjin.
Hapja e saj është e ndaluar
në një vend ku duhet durim.

Gratë e moshës sime,
shpikin përmasa të reja
në një vend ku koha rend si maratonomak,
duartrokiten nga të panjohur;
siparin e ditës hapin në errësirë
dhe e ulin natën.

Gratë e moshës sime,
përdorin këngët për të harruar;
shtrëngojnë duarsh, rebelimin
si një bust heroi që vjen nga origjina
t'mos e thyejnë...

18–Drithërimë

Po mardh...
Më futin erë plasaritjet e mallit,
lotoj shikimin që tërheq zvarrë,
degëthyerjet e kujtimeve;
Oshëtijnë buzëdrithjet mbi parvaze
Lagjja doli në rrugë,
mbajtur në bastun poroz;
Dikush telefonoi për ndihmë;
Unë qava...

Si nuk më lënë këta njerëz të duroj,
të mpihem nga drithjet,
derisa të arrij horizontin
ku deti tret diellin nën dallgë
Atje nuk bën ftohtë
retë i djeg rrufeja dhe zërin
nuk e merr era..
Mund të rënkoj sa të dua..
Të gjithë janë të dehur lumturie
të shohin si rrobat e reja të mbretit
Sa liri të plotë ka dhembja në atdheun tim!

19–Keqardhje

Marshimet e kamionëve të plehrave, të enjteve,
në lagjen time,
kanë ndërruar zakon.
Ata i marrin veç me një rrugë të gjitha,
pa i ndarë sipas llojit...

Veç koshat i përplasim njëjtë si dikur,
në beton...
... dhe ikin nxitimthi
nën mjegullën e përçmimit mëngjesor,
për të përsëritur veten në një tjetër portë.

Ata vrapojnë me lumturinë e hapjes së një dhurate;
unë tërheq koshin si të zbus dhembjen e tij.
Pezmi çan akullimën e indiferencës,
kurse dhembshuria ime
prej mungesash të vjetra,
ngre flamurin e bardhë të paqes,
në harqe shikimesh.

Më mbetet peng fjala,
pasqyra e genit durimtar të origjinës.
Jam rritur me përçmimin njerëzor;
një ritual rinie që binte si ulërimë,
nga lart-poshtë.

Sa vështirë të krahasosh...
... në një vend ku kujtesa thyen hënën;
se fati i plehrave është më i mirë,
se ai i frymorëve në hapësira
që i lan dielli shumë gjatë.

Futem në shtëpi me tipare të reja,
si një genie e ridimensionuar
që ka filluar t'i vijë keq për plehrat.
Sa çudi...!

20–Pa vetmi

Kam një mendje t' i lyp horizontit
ca re të bardha ,
të mbështjell brenda tyre, diellin,
të më humbet hija..

Kur vetëtimat të djegin qiellin
pa strehë të mbesë braktisja..

Nuk kam asnjëherë luksin e vetmisë!



MIRA MEKSI

Frosina e Janinës



Ribotohet “Frosina e Janinës” e shkrimtares Mira Meksi Romani i një dashurie të madhe, të penguar dhe tragjike.

Ngarjet zhvillohen në vitin 1801 në Janinë, në zemër të Epirit, e cila sundohet nga Ali pashai, që përpiqet me thonj e me dhëmbë të krijojë një principatë të pavarur nga Porta e Lartë në Shqipërinë e Jugut. Është koha e luftës së pamëshirshme për pushtet, për çlirim nga robëria osmane, koha e gjakësive të pashembullta dhe e mizorisë çnjerëzore. Në këtë klimë të rëndë lulëzon një dashuri e madhe: Frosina, gruaja më e bukur e Janinës, aristokrate greke, shpirti i artit dhe kulturës i atyre viseve, dashurohet me Muktar pashain, djalin e madh të Ali pashait. Aventura të jashtëzakonshme marrin jetë në oborrin e pashait shqiptar, ushqehen nga ambiciet e tij çmendurane, seliten prej luksit të shfrenuar oriental, përplasen me diplomacitë europiane, përndezin rrjetet e spiunazhit dhe magjinë e zezë, frymëzohen nga flladi i qytetërimit perëndimor – gjithçka për të ndërtuar dhe për të lartuar figurën e Frosinës së Janinës, martires së dashurisë dhe lirisë.



ENTON BIDO

Vdekja e mësueses

Tregim

Mësuesja e mizikës dha shpirt ndaj të gdhirë. Ishte pranverë, lulëzim ngado; zogjtë harbonin me fluturime dhe cicërima. Përisht për këtë dukej si stina më e papërshtatshme për të vdekur. E dimë të gjithë që, një ditë do të shkojmë doemos te Krijuesi, por na duket se vdekja nuk na përket neve vetë, por të tjerëve. Edhe pse çdo ditë që ikën, ajp na avitet, neve të vdekshmëve na duket sikur me të ndërruar jetë do të hasim të tërë kopshtet e lulëzuara të parajsës; do të takojmë Evën dhe Adamin (Havanë dhe Ademin), do të takojmë të dashurit që kanë fluturuar më herët në qiell. Në mos vetë ata, shpirtat e tyre. Unë për shembull mendoja se do të takoja Danten me Virgjinin, ose Pjetër Budin dhe Mitrush Kutelin dhe do t'u kërkoja autografe, mandej do të niste diskutimi i gjatë e plot pasion për letërsinë në veçanti dhe librat në përgjithësi.

Nga ana tjetër, mësuese Emira, ose shpirti i saj i bardhë do të donte të takonte, çka ma tha një herë në mirëbesim Verdin dhe Bahun.

- Vetëm këta të pëlqejnë, zysh? - e pata pyetur me kërshtëri.

- Jo. Ka edhe kompozitorë dhe muzikantë të tjerë, por këta të dy janë gjeni dhe, për mua, hanë bukë veç. Apo jo? Si mendon ti?

M'u përkëdhel sedra, që po më kërkonte mendim mua, çunakut, nxënësit të saj.

- Po, sigurisht zysh! Mirëpo, “Shijet dhe ngjyrat nuk diskutohen”, thoshin latinët.

Ajo buzëqeshi.

- Je i mençur Enio. Dhe merru me muzikë, se edhe vesh muzike ke, edhe merin e një kompozitori të famshëm e ke.

- Cilit?

- Enio Morricone, Italian. Gjeneri, jo llafe. Ka krijuar shumë në meloditë e filmave të famshëm botërorë.

- Falemnderit mësuese!

- Do të këmbëngul të prindërit e tu që ta ndjekin këshillën që po të jap. Domethënë të t'i krijojnë kushtet.

- Do të pranojnë, thua?

- E pse jo? Talentin dhe vullnetin për punë i ke të dyja. Pastaj, ata janë njerëz të ngritur, të shkolluar dhe i kam parë gjithmonë nëpër koncerte.

Gjithë sa më lart, më vinin ndër mend teksa mbi arkemortin e saj hidheshin grushtet e lopatat me dhë, ku të shumë nga të pranishmit fshin sytë nga lotët, sidomos familjarët e saj. Ajo që një grua e shtruar, në dukje e butë, por, pot a njihje nga afër, shihje një karakter të fortë, madje të paepur. Tjetër çshohim nga jashtë te njeriu dhe tjetër çka ai brenda. Fundja, thelbi rri në shpirtin dhe mendjen e njeriut dhe jo te dukja e jashtme e tij. Ajo, që në fillim, na u imponua me sjelljen dhe taktin e saj. Mbante një farë largesie nga ne, nxënësit, ama në çastin kur dikush i kërkonte ndihmë, nuk kursehej aspak. Dhembshurinë ne ia vumë re herët në rastin e plagosjes në kokë të Klodit. Ishte orë fizikulturë dhe ne kishim shkruar si zakonisht te parku sportiv. Ato dy orë kishim në program hedhje gjyleje. Meqë gjyle nuk kishim gjetur dot dhe, edhe po të gjenim, ishte shumë e rëndë për krahët tanë të njomë. Mësuesi zgjodhi një gur të rrumbullakët dhe pak të rëndë që do ta përdornim në vend të gjyles. Dhe kështu ne u rreshtuam, bëmë nja dy xhiro nxemjeje dhe u bëmë gati për garën. Ai që do kishte radhën rrinte në qendër të fushës dhe në anash, në mënyrë që të mos na kapte gjylja e sajuar po që se shtytësi e hidhte keq. E hodhën një nga një çunat gurin, kush larg, kush afër, sipas takatit të secilit. Mësuesi u mësonte teknikën e hedhjes, mënyra e mbajtjes së gjyles (gurit), vënia afër qafës, mënyra e mbajtjes së dorës, gjysmërrrotullimi rreth vetes, mandej shtytja me sa forcë kishte; kjo e gjitha pa dalë jashtë një rrethi të përcak-



tuar që ai e bëri me shkop si brazdë të thellë rrethore. Pas katër a pesë hedhjeve, radha i erdhi Edlirit. Ai, ashtu trupvogël, u afrua me drojë te rrethi i hedhjes, mori gurin, e vendosi rrëzë qafës me dorën e djathtë, u përkul, bëri gjysmërrrotullimin dhe e lëshoi tutje me sa fuqi pati. Kur..u dëgjua një ulërimë e thekshme. “OOOOuuu, (oiii, noneee!”

Ishte Klodi që po ulërinte dhe që pas pak çastesh i ra të fikët. Ne rpauma si të çmendur tek ai, ndërsa mësuesi u zverdh dhe u bë meit, u bë limon fare në fytyrë. (i iku gjaku nga fytyra). Guri i lëshuar nga Edliri kishte rënë mu në çaçkën e kokës së Klodit të shkretë. Mësuesi kish bërë një gafë të rëndë. Në vend të na rreshtonte neve që prisnin radhën pas atij që e hidhte atë, na pat rrethuar anash. Prandaj edhe Klodit desh iu hap koka. Me t'u mbledhur rreth Klodit të zalisur, ia morëm kokën e gjakosur në duar, dikush sooolii ujë dhe e agë, një tjetër mundahej të ndalte gjakun, mësuesi më në fund mbledhi dosi veten dhe vrapo e mori biçikletën. Ne e morëm në krahë të shkretin djallë dhe e hipëm ashtu siç mundëm te zgara e biçikletës. Sikur po vnte në vete, por nga koka i rridhte goxha gjak. Me ta hipur, mësuesi id ha pedaleve, doli nga parku sportive (i cili sot nuk ekziston më) dhe mori rrugën drejt spitalit. Të gjithë që stërviteshin aty u tubuan ted era e jashtme dhe ndiqnin me ankth largmin e shpejtë të biçikletës derisa ajo u zhduk në kthesë. Ne shokët ia dhamë vrapit dhe i ramë shkurt për te spitali. As që na shihnin fare sytë nëse kalonin apo jo makina. Mendjen e kishim te shoku, të cilit poi rrezikohej jeta. Duke vrapuar, shihja pas meje Edlirin e shkretë që i ishte lagur krejt fytyra jo nga djersa, por nga lotët. Ndjehej fajtor i ziu djallë që gjuajti pa dashje shokun. Porn ë fakt, faji që i mësuesit, jo i Edlirit.

Kur mbërritëm te spitali, shohim që para nesh kishte mbërritur mësuesja e muzikës Mira. E para, si e kish marrë vesh, ndërkohë që jepte mësim në shkollë, e dyta, si mbërriti aq shpejt para nesh. Megjithëqë shumë e shqetësuar, e tronditur, kur na pa u mundua të buzëqeshte.. kuptohet donte ta fshihte ankthin e saj që të na jepte kurajo neve. Ne e rrethuam dhe nisëm t'i shpjegojmë se si kishte ndodhur, por dukej që ajo e kishte marrë vesh “në kohë reale”, siç thonë gazetarët sot. Mirëpo, më prekësja dhe që na bindi edhe një herë se ç'shpiert njeriu ishte zysh Mira ishte sjellja e saj me Edlirin. E pa tek rrinte i mënjanuar dhe me sytë tërë lot, i skuqur në fytyrë dhe që dukej sikur donte të fshihej, të avollonte, të zhdukej. U shkëput prej nesh, i shkoi pranë, ia fshiu lotët me shami, e mbështeti pranë vetes dhe i përkëdhelte flokët duke i thënë me ngadalë:

“Do të shërohet. Do të shërohet. Nuk është faji yt. Qetësohu, xhan!”

Reagimi i Edlirit që i papritur. Menduam se do t'i shterretë të qarat dhe do të qetësohej, kurse ia ia nsi sërish, por kësaj here në heshtje, dëneste si në një film pa zë. Kjo na preku të gjithëve, madje disa nga gocat që kishin ardhur e prisnin aty jashtë spitalit me ne, iu rodhën lotë mallëngjimi. Gjatë gjithë kohës së ptijes zysh Mira ndenji me Edlirin. Nuk iu nda gjersa ai u qetësua dhe rreshti së qari. Ndjehej vetëm një psherëtimë e herëpashershme e tij. Sytë i mbante përdhe dhe shpesh kafshonte buzën e poshtme.

Pas një pritjeje të gjatë, ku ne herë-herë provonim të shihnin ndonjë gjë nga plasat e xhamave të urjencës së spitalit, mjeku doli dhe na qtësoi:

“Ja kemi qepur të carën në kokë, gjaku i ka ndalur së rrjedhuri. Tani po fle. Është jashtë çdo rreziku”

“A do ta marrë veten më pas, doktor?” – pyetën gati njëzëri mësuesi i fizikulturës dhe zysh Mira.

“Po. E çara ka qenë e thellë, i kemi bërë shtatë qepje, por gjithçka do të normalizohet.

“Domthënë, xhaxhi doktori, Klodi do të jetë si më parë? – pyetën disa nga ne.

“Po, xhan, njëlloj si më parë”.

Atëbotë, Edliri iu shkëput vrik zyshës dhe iu hodh në krahë mjekut dhe e përqafonte sikur ta kishte baba. Mjeku në fillim u habit, mandej zuri të qeshë dhe e mbante shtrenguar fëmijën, që shendohej si kurrë më parë.

Këto më kujtoheshin kur morëm vesh se zysha ndërroi jetë. Ishte e pabesueshme, jo aq vdekja, sesa ajo që morëm vesh më vonë. Arsyet e vdekjes dhe fund i hidhur. Kishte kujtuar se do t'i vrisnin të birin dhe pat helmuar veten. Ai, domthënë i biri që ngatërruar në borxhe dhe kumar. Pasi kishte rënë brenda, siç qe shprehja, pat aq shumë borxhe sa, huadhnësit i kërkuan të shiste shtëpinë. Mirëpo, ai të vetën e kishte me qira. E ëma si prindi për fëmijën, për ta shpëtuar shet shtëpinë e saj. Ama, paret e grumbulluara nga kjo shitje, nuk kapin as gjysmën e shumës së kërkuar. Atëherë, i biri, i frikësuar nga një sms e borxhlinjve e tipit “O të tëra paratë, o të iku koka”, lë familjen, gruan me fëmijë dhe arratiset, madje pa lamjëruar askënd. Në qytet, pas do ditësh qarkullon lajmi se do ta vrasin. Për faqt të keq ai lajm i shkon në vesh mësueses së gjorë. Ajo, e tronditur dhe më maktin se do ta shohë djalin të vvarë, blen helm dhe e gëlltit. Me gjithë përpjekjet për të shpëtuar si nga falijarët, ashtu edhe nga mjekët, helmi e ka bërë të plotë efektin. Mes përpëlitjesh, spazmash, të vjellash, pra mees një vuajtje të pafund, mësuesja mbyll përgjithmonë sytë në të gdhirë të ditës së saj të lindjes.

Mbrëmjen e ditës kur e çuam në përtejbotë, pyeta një nga të afërmit që i kish ndenjur te koka gjersa dha shpirt.

“A la ndonjë amanet? A munda, më saktë? – e pieta.

“Sa ishte e kthjellët nuk la. Veç, çastin e mbramë se nga mori një forcë si prej perëndie, hapi sytë e lodhur, bëri të ngrihej capak dhe foli qartë duke më parë drejt e në sy:

“Qumështin nuk ia bëj harram.”

Mandej i mbylli sytë, psherëtiu aq thellë sikur dilte psherëtima nga të thellët e tokës, iu tendos një hop krejt trupi dhe dha shpirt me dorën e djathtë mbi flokët e mi. M'u duk sikur donte të ledhantonte për herë të mbrame flokët e të birit.

Një ditë pasi e përcollëm në varreza e qytetit, poshtë një selvie të lartë, shkova dhe i vura një trëndafil të kuq. Ia vura poshtë fotos rumbullake të porcelanit, të cilën e përkëdhela gjatë. E di që i fola, sikur doja të kuvendoja me të reth kujtimeve të shkollës dhe ta pyesja me dhimbje se pse e mori atë vendim fatal, që i solli fundin e pamerituar. Rreth shkollës i fola, por pyetjen që më gërryen edhe sot nuk i bëra. Nuk ua bëra as fëmijëve, as të afërmeve të saj. Ishte kërshtëri e përtërt. Nënatinë të japin jetën për bijtë, edhe kur ata nuk e meritojnë.

Thuajse trokiti maja-gishtash në portën e rrethinës së qelqtë të dushit që shfaqej si ishull i mbytur në mugull avujsh. Pa mundur të vështronte dot kurrë, iu bë se e qelqta u çelë paksa, pa u thyer.

S'mund të mos ndodhte pikërisht kësh-tu, përderisa aty, brenda apartamentit, përballë dhomës së tyre të gjumit, vetëm ai - zotëria i saj mund të ishte. Me po aq siguri sa, brenda asaj kutie të qelqtë, në avuj uji, mund të ishte vetëm ajo, gruaja e tij.

Në atë trokitje, më shumë fshikje, maja-gishtat lanë gjurmën në atë veshje avujsh mbi qelq, si përcjellje dëshire dhe ndjesie se jo vetëm vazhdonte ta donte në mirënjohje të tërë këtyre viteve bashkë, por edhe që ai e kishte edhe më tej ëndje dhe kureshtje, ende-joshje që, madje edhe për trupin e saj, pavarësisht këtyre viteve. Për të mbetej, edhe më tej po ajo, si dikur, kur dukja ishte mbase më e madhe se qenia.

Edhe mund të rrëfehej nëse ndodhi ç'pritej, çfarë imtësisht, pas njomjes së lehtë të mollëzave të gishtave të dorës në brymën e avujve, edhe pse asgjë e re, kurrëgjë e tjetërt nga ç'kishte ndodhur, si me tërë të tjerët, edhe me ta.

Megjithatë, kundruar jo si çdo herë tjetër, duke dalë si prej një mjegulle nga dushi, e fshehur e tëra nën një peshqir të bardhë e të bollshëm, prej gojës së saj u dëgjua zëshëm vazhdimi i pantomimës nisur prej brenda avujve të vetmisë se ngrohtë.

“Edhe unë ndjehem mirë, kur dëgjoj se vazhdon ta dëshirosh ende trupin tim. Edhe pse, në dije të hershme, nuk kemi parapëlqyer kurrë që trupi të na shfaqej thjesht e thjesht si kurth i bekuar fizik!”

“Mbase jemi shprehur edhe që dëshirimi më i dëshiruar ndodh në kundrimin pjesë-pjesë, si zbulesë për herë të parë!”, shtoi ai, duke qeshur.

Në të vërtetë përgjorohej, pa fjalë, besonte i tëri se femra ishte tempulli i bekuar ku përulëj së brendshmi besimtari i vet.

Nuk ishin aq të rralla çastet kur do donte ta thoshte zëshëm këtë, edhe pse arrinte ta mbikëqyrte veten të mos ngutej, thjesht e vetëm se fill pas këtyre fjalëve do duhej të shtonte doemos diçka tjetër. Ngaqë me kohë ishte bindur se s'ishin të mjafta vetëm ëndja e ngasja, për tu kuptuar pasi të bënte këtë.

Ndjehej në drojë se të shumtët e njerëzve që kishte njohur, nuk e kishin pasur dot këtë mundësi, të pasjes së qetësisë së domosdoshme - në mos të plotë, prej pranisë së gjërave të domosdoshme, atyre elementare, për të gëzuar në to si komoditet të merituar intim përjetuar si privilegj jetik.

Edhe ata të dy bashkë, të shumtën e vjetëve, nuk e patën. Ngushëllohej se mungesën për to e kishin ndërë vetëm së voni, vetëm kur filluan t'i plotësonin. Mbase kështu ishte rregulluar kjo jetë: të mos i dinin tërë gjërat që mungonin, të mos vinin ashtu në dyshim përkatësinë njerëzore.

Tërë njerëzve të lindur dhe rritur në mos-kamje të mjaftë, varfëria u shfaqej e plotë vetëm pasi ata dilnin prej saj. Kur s'e vuanin më, mungesën e ujit brenda shtëpive, kujtonin mungesën e tij dikur; kur po i gëzoheshin pasjes së ujit të ngrohtë për në kuzhinë dhe dush, habiteshin se si kishte mundur tu mungonte gjer edhe kjo gjë...

Sidomos për mungesat e vrazhda dikur, ai zgjidhte të mos flisnin në sy të fëmijëve ende të pa rritur. Nuk i druhej udhës nga kishin ardhur si prindër por, përderisa s'kishte qenë e shkuar e drejtpërdrejtë e fëmijëve, përse tu bëhej kujtesë?

Më tej akoma, gjithnjë duke iu bindur ndikimit të kushteve e rrethanave të jetëve të njeriut, të lloj-lloj njerëzve që kishte njo-



FARUK MYRTAJ prej avujve, sapo kishin mësuar...

Tregim

hur, admiruar apo keq ardhur, jo vetëm besonte, e thoshte me thellësi bindjeje, dëshironte t'ia dëgjonin të tjerët: “Nuk është i pa-dashurueshëm kurrkush në këtë jetë...”

Hezitonte pak, kur matej të mendonte, edhe më pak të shprehej, se “s'kishte njerëz të pa-dashuruar.”

Besonte se, në secilën rrethanë, secili njeri, e kishte dhe bënte sa mund ta gjente dashuruesin e vet. Ishte e kollajtë, sipas tij, ta besonin këtë, mjaft të kujtoheshin se s'ke mi asnjë të drejtë ta krahasojmë dashurinë e dikujt me të tjetrit. Jo thjesht, për shkak të dukjeve të tjera, linjave elegante a fytyrave joshëse, se sa pikërisht prej mungesave të pafundme përqark. Edhe vet dukja, pamja njerëzore, në sytë e tij dhemshurohej, teksa kujtonte se më të shumtëve prej njerëzve që njihje dhe dinte, u kishin munguar gjëra elementare, as “një strehë, s'e kishin...”, për tu mbyllur e gëzuar aty si në shtëpi të vetën prej shpirti të dy trupave në një...

E lejonte veten të shtyhej aq larg në domosdonë e dhembshurisë brenda dashurisë sa druhej për ndonjë moment keqkuptimi të pafajshëm...të shpallte se pa dhembshuri në të, as dashurinë s'mund ta kishte njeriu.

Kjo gjendje mbrëmësore, mbase e të dyve në të njëjtën kohë, në vegim të dyfishtë, ai i dehur me kundrimin e avullit që gufonte si frymëmarrje prej poreve të qelqta, ajo në ngazëllim që e kishte kapur prej atje brenda trokitjen në drojë të tij, shëmbëllyen me dy adoleshentë të pafajësisë së parë.

Në atë mjegullimë të thurur nga të dy, ngaqë ajo vet e kishte çelur paksa atë qelqurinë që megjithatë quhej derë, dhe ngaqë ai kishte provuar të rikthehej në kohën dikur, në heshtje të thellë të gjëmimite po zhvendoseshin për nga njeri-tjetri. Mbase kështu i kishte ndodhur njeriut të parë, joshur kush e di si në domosdi fjalë, që vetëm dashurie mund të ishte ndaj njeriut tjetër ndodhur pranë tij.

Sidomos këto raste që sado si mund

të ishin edhe më të shumtë, u kujtonin se mbase kishin humbur tërë ato kohë, mungesë të këtyre gjesteve a fjalëve që fare kollaj mund të ishin dhuruar ndaj njeri-tjetrit, për ta zhbërë që në krye të herës atë distancën që, prej një mijë pretekstesh apo arsyesh të vogla, guxonte të shfaqej midis njerëzve. Fill pas tyre, bëhej gjithnjë e dritëshme udha për të arritur në atë gjendjen flurore, si të kësaj mbrëmjeje pas kondensimit të këtij avulli, të shpërhapur avashëm në atë hapësirën e kaltër ku gjërat kote humbnin vetiu peshën. Thjesht se, në të vërtetë, s'e kishin pasur kurrë.

Ndaj duhej besuar se kënaqësi të tilla, që edhe pse duket sikur e kanë fillësën prej trupit, vetëm thjesht fizike s'mund të ishin. Padyshim edhe fizike, por vetëm sa energjia pranon të jetë e tillë.

Mbërritja më në fund në këto momente të symbyllta i siguronte sërish se, edhe nëse qenë vonuar, për mrekulli të tilla kurrë nuk bëhej vonë. Për këto lloj pemësh të për-bashkëta kurrë s'bëhej vjeshtë e vonë. Prej fryteve të tyre, vetëm zhveshje s'do tingëlonte rënia e mjegullës së avujve, as rënia paksa në supet e peshqirit të hedhur.

Ngaqë besohej se ai dinte të priste më gjatë, zgjodhi ajo të fliste e para.

Në dije të thellë të brenda vetes se asgjë s'mund të ndodhte vetëm prej njërit, as me vetëm në njërin, ajo shtoi se edhe më e këndshme do të ishte, nëse ai do vononte të hynte në dhomën e gjumit, deri sa ajo t'i bënte një shenjë, fare pak më vonë...

Prej avujve sapo kishin mësuar se bëhej më mirë po të hyhej duke trokitur, qoftë edhe fshikazi, si në brymën mbi qelq. Edhe për në dhomën e gjumit, hyrja mund të bëhej edhe më e dëshiruar, pas një pritje të shenjës, prej brenda...

Po i bëhej se ishte duke e dëgjuar edhe ai, si diçka të shenjët, privilegj hyjnor, idenë se dhoma e gjumit, edhe pse e mbarte kuptimin prej pranisë së të dyve atje brenda, kuptimin e parë fare e merrte prej pranisë së Saj, pra edhe prej lejes së saj, për të hyrë në të...

Janar 2011

Mariana hap derën kur Konelli i bie ziles. Mban veshur ende uniformën e shkollës, por ka hequr pulovrin, ndaj është vetëm me këmishë, me fund dhe nuk ka këpucë, vetëm geta.

Oh, ç'kemi, thotë ai.

Eja brenda.

Kthehet dhe ecën nëpër korridor. Ai e ndjek, duke mbyllur derën pas vetes. Poshtë shkallëve në kuzhinë, nëna e tij Loraina po heq një palë doreza gome. Mariana kërcen mbi banak dhe merr një kavanoz të hapur me çokokrem, brenda të cilit kishte lënë një lugë çaji.

Mariana po më thoshte se sot keni marrë notat e provimeve paraprahe, thotë Loraina.

Morëm ato të anglishtes. Erdhën të ndara. Ikim tani?

Loraina bën bashkë dorezat prej gome dhe i vendos sërish poshtë lavamanit. Pastaj fillon të zgjidhë flokët. Konellit i duket diçka që ajo mund ta bëjë në makinë.

Dhe dëgjova se ia ke dalë shumë mirë, thotë.

Ishte më i miri i klasës, thotë Mariana.

Ashtu, thotë Konelli. Edhe Mariana shumë mirë doli. Mund të ikim?

Loraina ndalon së zgjidhuri përparësen. Nuk e dija se e kemi me ngut, thotë.

Ai i fut duart në xhepa dhe me një frymëmarrje të rëndë ndalon një ofshamë irritimi e cila, prapëseprapë, ashtu tingëllon.

Ja, më ka mbetur vetëm të nxjerr rrobrot nga makina tharëse, thotë Loraina. Mandej, ikim. Mirë?

Ai nuk thotë asgjë, veçse var kokën teksa Loraina del nga dhoma.

Mos do pak nga kjo? thotë Mariana.

Mban para vetes kavanozin me çokokrem. Ai i fut duart edhe më thellë në xhepa, sikur po përpiqet t'i bëjë vend për njëherësh tërë trupit në ta.

Jo, faleminderit, thotë.

E more notën e frëngjishtes sot?

Dje.

Mbështetet pas frigoriferit dhe e sheh tek lëpin lugën. Në shkollë, ai dhe Mariana bëjnë sikur nuk njihen. Aty e dinë se Mariana jeton në një vilë të bardhë me pamje nga rruga dhe se e ëma e Konellit është pastruese, por askush nuk e di marrëdhënien e veçantë mes këtyre fakteve.

Mora A1, thotë ai. Po ti, çfarë more në gjermanisht?

A1, thotë ajo. Po mburresh?

Do të mbledhësh gjashtëqind, apo jo?

Ajo ngre supet. Ti, ka mundësi, thotë.

E po, ti je më zgjuar se unë.

Mos u ndie keq. Unë jam më e zgjuar se të gjithë.

Tani Mariana po llastohet. Haptazi, tregon përçmim për ata në shkollë. Nuk ka miq dhe kohën e drekës e kalon vetëm duke lexuar romane. Shumë njerëz e urrejnë vërtet. I ati i ka vdekur kur ishte trembëdhjetë vjeçe dhe Konelli ka dëgjuar se atë tani e ka zënë një sëmundje mendore a diçka e tillë. Është e vërtetë se është më e zgjuara e shkollës. Kur mbetet kështu vetëm me të, e kap frika, por po ashtu e kap veten duke fantazuar gjëra që mund t'i thotë për ta impresionuar.

Nuk je më e mira e klasës në anglisht, vëren ai.

Ajo lëpin dhëmbët, e pashqetësuar.

Mbase duhet të më bësh mësim private, Konell, thotë.

Ai ndien t'i përflaken veshët. Ka mundësi që të jetë thjesht duke u tallur dhe jo duke dhënë sugjerime, por, në qoftë kjo e dyta, po e bën vetëm për ta denigruar duke e lidhur me emrin e saj, pasi ajo konsiderohet si diçka e neveritshme. Vesh sheshka të shëmtuara me shollë të trashë dhe nuk vendos tualet. Thonë se nuk depilon as këmbët, as asgjë. Konelli ka dëgjuar se njëherë, pasi në mensën e shkollës i kish pikuar akullorja me çokollatë, kish shkuar në banjën e vajzave,

SALLY ROONEY

Njerëz normalë

Fragment nga romani

Përktheu: Andreas Dushi

kish hequr këmishën dhe e kish larë në lavaman. Kjo është një histori e njohur mbi të, të gjithë e kanë dëgjuar. Po të donte, mund të bënte një shfaqje të madhe duke përshëndetur Konellin në shkollë. Shihemi këtë pasdite, mund të thoshte, para të gjithëve. Pa dyshim, kjo do ta vendoste atë në një pozitë të sikletshme, në një nga ato që zakonisht duket sikur asaj i shijojnë. Por ajo nuk e ka bërë asnjëherë.

Për çfarë po flisje sot me zyshë Nerin? thotë Mariana.

Oh. Asgjë. S'e di. Provime.

Mariana e rrotullon lugën brenda kavanozit.

Mos, vallë, të ka qejf a diçka? thotë Mariana.

Konelli e sheh tek lëviz lugën. Veshët i ndien ende shumë të ngrohtë.

Pse po e thua këtë?

O Zot, nuk është se ke një aferë me të, apo jo?

Jo, është e qartë. Mendon se është diçka për të bërë shaka?

Më fal, thotë Mariana.

Ka një shprehje të fokusuar, sikur po i sheh përmes syve pjesën e pasme të kokës.

Ke të drejtë, nuk është për të qeshur, thotë. Më fal.

Ai tund kokën, shikon përreth dhomës për pak, ngul majën e këpucës në brazdën mes pllakave.

Ndonjëherë më duket sikur sillet disi çuditshëm pranë meje, thotë. Por nuk do t'ua them të tjerëve këtë, as asgjë.

Mendoj se edhe në klasë flirtton goxha me ty.

E mendon vërtet këtë?

Mariana pohon me kokë. Ai fërkon qafën. Zyshë Neri jep ekonomi. Ndjenjat e tij të hamendësuar ndaj saj janë gjerësisht të diskutuara në shkollë. Disa madje thonë se ai është përpjekur ta shtojë në Facebook, diçka që ai nuk e ka bërë dhe nuk do ta bënte asnjëherë. Në fakt, ai as nuk i bën, as nuk i thotë gjë, vetëm sa ulet qetësisht teksa ajo i bën dhe i thotë gjëra. E mban ndonjëherë pas mësimi për të folur rreth drejtimit të

jetës së tij dhe një herë i ka prekur nyjën e kravatës së uniformës. Nuk i tregon dot njeriu për mënyrën si ajo sillet, pasi do të mendonin se po përpiqet të mburret për këtë. Në klasë ndihet shumë i turpëruar dhe i shqetësuar për t'u përqendruar në mësim, thjesht ulet aty, me sytë ngulur librit, derisa grafikët fillojnë të sfumohen.

Njerëzit më bezdisin sa herë thonë se e kam qejf a ku di unë, thotë ai. Por, në fakt, s'e kam, fare. Dua të them, nuk të duket se unë po hiqem sikur teksa ajo sillet ashtu, apo jo?

Me sa kam parë unë, jo.

Pa menduar, ai i fshin duart përmbi këmishën e shkollës. Të gjithë janë aq të bindur për tërheqjen e tij ndaj zyshë Nerit, saqë ndonjëherë ai vetë fillon të dyshojë në instinktet e tij rreth kësaj. Po sikur, në ndonjë nivel përmbi a nën perceptimin e tij, në fakt, ta dëshirojë? Ai as nuk e di si supozohet t'i duket dëshirimi. Sa herë e ka bërë në jetën e vërtetë, seksi i është dukur shumë stresues, si të ishte thellësisht i pakëndshëm, çka e ka shpënë në dyshimin se ka diçka që nuk shkon me atë vetë, se është i pazoti të krijojë intimitet me një vajzë, se, mbase, është me ndonjë të metë në zhvillim. Pasi mbaron, shtrihet aty dhe mendon: E urrej kaq shumë që ndihem keq. Mos, vallë, thjesht është kështu? Mos, në fakt, neveria që ndien kur zyshë Neri i mbështetet mbi tavolinë është mënyra se si ai e përjeton një trill seksual? Nga mund ta dinte?

Po deshe, mund të shkoj te zoti Linos për ty, thotë Mariana. Nuk do t'i them se më ke treguar gjë. Do t'i them vetëm se e kam vënë re vetë.

Krisht, jo. Absolutisht jo. Mos i thuaj asgjë askujt, mirë?

Mirë, në rregull.

Ai e shikon për t'u siguruar se e ka seriozisht dhe pastaj pohon me kokë.

S'është faji yt që ajo sillet kështu me ty, thotë Mariana. Ti nuk gabon gjëkund.

Qetësisht, ai thotë: Po pse atëherë gjithë të tjerët mendojnë se jam unë ai që e ka qejf tjetrën?

Mbase ngase skuqesh shumë kur ajo të flet. Por ti, e ke parasysh, skuqesh për gjithçka, thjesht e ke këtë kompleks.

Ai i jep një të qeshur të shkurtër, të palumtur. Faleminderit, thotë.

E po, e bën.

Po, e kam vënë re.

Në fakt, tani po skuqesh, thotë Mariana.

Ai mbyll sytë, mbështet gjuhën përkundër qiellzës. Mund ta dëgjojë Marianën tek qesh.

Pse duhet të jesh kaq e vrazhdë me njerëzit? thotë.

Tani nuk jam e vrazhdë. S'dua t'ia di nëse po skuqesh. S'do t'i them njeriu.

Vetëm ngaqë s'do t'i thuash njeriu, s'do të thotë se mund të thuash çfarëdolloj gjëje që do.

Dakord, thotë ajo. Ndjesë.

Ai kthehet dhe sheh kopshtin nga dritarja. Në të vërtetë, kopshti më shumë është si "fushë". Përfshin një fushë tenisi dhe një statujë të madhe guri të një gruaje. Sheh "fushën" dhe e afron fytyrën më pranë ajrit së ftohtë në xham. Kur njerëzit tregojnë atë historinë për Marianën që lan këmishën e saj në lavaman, sillen thua se është histori për të qeshur, por Konelli mendon se qëllimi i vërtetë i saj është tjetërkund. Mariana nuk ka shkuar kurrë me ndonjërin prej atyre të shkollës, askush nuk e ka parë asnjëherë të zhveshur, askush madje nuk e di në i pëlqejnë djemtë apo vajzat, ajo s'i tregon njeriu. Njerëzit e kanë zët këtë dhe Konelli mendon se kjo është arsyeja pse e tregojnë historinë, si një mënyrë për të rrëmuar në diçka që nuk u lejohet ta shohin.


Nuk dua të zihem me ty, thotë ajo.

Nuk po zihemi.

E di se ka gjasa të më urresh, por, në fakt, je i vetmi që më flet.

Nuk e kam thënë kurrë se të urrej.

Kjo ia tërheq vëmendjen dhe ajo ngre

Përktheu:
Andreas Dushi

Onufri

sytë. I paqartë, ai vazhdon ta mbajë shikimin larg saj, por me cep të syrit e sheh se ajo po e vështron ende. Kur flet me Marianën, ka një ndjesi privatësie tërësore mes tyre. Mund t'i tregojë gjithçka rreth vetes, edhe gjëra të çuditshme dhe ajo nuk do t'i përsërisë asnjëherë, ai e di këtë. Të jetë vetëm me të është si të çelë një derë larg jetës normale dhe ta mbyllë pas vetes. Nuk frikësohet prej saj, në fakt, ajo është një njeri vërtet i qetë, por druhet t'i rrijë pranë për shkak të mënyrës së ngatërruar se si vë re se sillet, gjërave që thotë, të cilat zakonisht nuk do t'i thoshte kurrë.

Pak javë më parë, teksa ai priste Lorainën në holl, Mariana zbriti nga shkallët me një robdëshambër. Ishte vetëm një robdëshambër i bardhë, pa asgjë, i lidhur normalisht. Flokët i kishte të lagët dhe nga ai shkëlqim në lëkurë, dukej sikur sapo kishte vënë krem fytyre. Kur pa Konellin, hezitoi në shkallë dhe tha: Nuk e dija se ishte këtu, ndjesë. Mbase dukej e tronditur, por jo në një mënyrë tërësisht të keqe, as asgjë e tillë. Atëherë u ngjiti sërish për në dhomën e saj. Pasi iku, ai qëndroi aty në holl duke pritur. E dinte se ndoshta po vishej në dhomë dhe çfarëdo rrobash të kishte veshur kur të zbriste, do të ishin rroba të zgjedhura pasi pa atë në holl. Megjithatë, Loraina u bë gati të iknin para se Mariana të rishfaqej, kështu që ai asnjëherë nuk ia pa ato rroba. Nuk ishte se i interesonte thellësisht ta dinte. Sigurisht që nuk do t'i tregonte askujt në shkollë për këtë, se e kishte parë me një robdëshambër, ose se ajo dukej e tronditur; nuk ishte puna e askujt për ta ditur.

E po, të kam qejf, thotë Mariana.

Për pak sekonda ai nuk thotë asgjë dhe intensiteti i privatësisë mes tyre rëndohet, duke i ushtruar përmbi fytyrë dhe trup një trysni thuajse fizike. Atëherë Loraina kthehet në kuzhinë me shallin që po e lidh rreth qafës. Troket lehtë mbi derë ndonjëse është e hapur.

Ikim? thotë.

Po, thotë Konelli.

Faleminderit për të gjitha, Loraina, thotë Mariana. Shihemi javës tjetër.

Konelli po del jashtë kuzhinës kur e ëma i thotë: Mund të thuash mirupafshim, ë? Ai kthen kokën që të shohë përmbi shpatull, por kupton se nuk mund ta shohë dot Marianën në sy, ndaj i drejtohet dyshemesë. Mirë, pafshim, thotë. Nuk dëshiron ta dëgjojë përgjigjen e saj.

Në makinë, e ëma vë rripin e sigurimit dhe tund kokën. Mund të jesh pak më i mirë me të, thotë. Nuk është se e ka edhe aq të thjeshtë në shkollë.

Ai fut çelësin në kuadër, me sytë në pasqyrën përballë. Mirë sillem me të, thotë.

Është njeri vërtet shumë i ndjeshëm, thotë Loraina.

Mund të flasim për diçka tjetër?


Loraina rrudh buzët. Ai ngul sytë përtej xhamit të përparmë dhe bën sikur nuk e sheh.

Tri javë më vonë (Shkurt 2011)

Ajo ulet në pupën e tavolinës së saj të tualetit duke parë veten në pasqyrë. Fytyrës i mungojnë konturet përreth faqeve dhe nofullës. Fytyra është si një pajisje teknologjike dhe dy sytë si kursorë që pulsojnë. Ose është reminishencë e hënës së reflektuar në diçka të valëzuar dhe të pjerrët. Shpreh në të njëjtën kohë gjithçka, çka është një lloj si të mos shprehë asgjë. Arrin në rezultatin se, po të vendosë tualet për këtë rast, do të ishte e turpshme. Pa ua ndarë sytë syve të vet, zhyt gishtat në një kuti të hapur me zbutësh buzës dhe i lyen ato.

Poshtë, kur merr pallton nga varësja, Alani, i vëllai, del nga dhoma e ndenjjes.

Ku po shkon? thotë.



Po dal.

Për ku?

Fut krahët në mëngët e palltos dhe rregullon jakën. Tani fillon të ndihet nervoze dhe shpreson që heshtja e saj të komunikojë paturpësi në vend të pasigurisë.

Po dal sa të ec pak, thotë ajo.

Alani lëviz për t'i zënë derën.

E po, e di se s'po del të takohesh me miq, thotë. Pasi nuk ke asnjë mik, apo jo?

Jo, nuk kam.

Ajo tani buzëqesh, një buzëqeshje e patrazuar, me shpresën se kjo sjellje nënshtrimi do t'ia fashisë atij trazimet dhe do ta lëvizë nga dera. Në vend të gjithë kësaj, ai thotë: Për çfarë po e bën atë?

Kë? thotë ajo.

Atë buzëqeshje të çuditshme që po bën.

Ai i imiton fytyrën, duke u shtrembëruar në një ngërdheshje të shëmtuar, me dhëmbët përjashta. Paçka se po ngërdheshet, fuqia dhe ekstremizmi i kësaj shprehje e bën të duket me nerva.

A je e lumtur që nuk ke miq? thotë ai.

Jo.

Ende e buzëqeshur, bën pas dy hapa të vegjël dhe mandej kthehet e ecën për nga kuzhina, ku është një derë xhami me shinë për në oborr. Alani i shkon pas. E kap nga pjesa e sipërme e krahut dhe e tërheq larg derës. Ajo e ndien nofullën të shtrënguar. Gishtat e tij ia shtrëngojnë krahun nën xhakëtën e saj.

Veç po iu qave mamës për këtë, thotë Alani.

Jo, thotë Mariana, jo. Po dal sa për të ecur pak tani. Faleminderit.

Ai e lëshon dhe ajo rrëshqet jashtë nga dera prej xhami, duke e mbyllur nga pas. Përjashta, ajri duket shumë i ftohtë dhe dhëmbët fillojnë t'i kërcëllin. Ecën anash shtëpisë, deri te rruga e makinës në oborr dhe pastaj jashtë në xhade. Krahu, aty ku ia kapi ai, po i pulson. Merr nga një xhep telefonin dhe shkruan një tekst duke shtypur në mënyrë të përsëritur tastin e gabuar, e fshin të gjithin dhe e rishkruan. Më në fund, e dërgon: Jam rrugës. Para se ta fusë prapë telefonin aty ku e mori, merr një përgjigje: bukur, shihemi së shpejti.

Në përfundim të semestrit të fundit, skuadra e futbollit e shkollës arriti në finalen e një gare dhe të gjithë nxënësve të atij viti shkollor iu desh t'i linin tri orët e fundit

që të shkonin e t'i shihnin. Mariana nuk i kishte parë asnjëherë më parë të luanin. Nuk kishte asnjë interes për sportin dhe në orën e fizikulturës vuante nga ankthi. Në autobus, rrugës për te ndeshja, vetëm sa dëgjoji në kufje, askush nuk i foli. Përtej dritares: bagëti të zeza, livadhe të gjelbra, shtëpi të bardha me tjegulla kafe. Skuadra e futbollit ishte e gjitha bashkë në krye të autobusit, duke pirë ujë dhe duke i rënë njëri-tjetrit shpatullave për të ngritur moralin. Marianës i dukej sikur jeta e saj e vërtetë po ndodhte diku tjetër, shumë larg, po ndodhte pa të dhe nuk e dinte nëse do ta gjente ndonjëherë se ku ishte e të bëhej dot pjesë e saj. Në shkollë e kishte shpesh këtë ndjesi, por nuk i shoqërohej prej ndonjë imazhi specifik të asaj se si mund të dukej apo të ndihej jeta e vërtetë. Gjithë çfarë dinte ishte se, kur të fillonte, nuk do t'i duhej më ta imagjinonte.

Gjatë ndeshjes nuk pati reshje. Ata i kishin sjellë me qëllimin që të rrinin mënjandë dhe të brohorisnin. Mariana ishte pranë portës, me Karenin dhe disa vajza të tjera. Të gjithë përveç Marianës dukej se disi i dinin përmendsh këngët e shkollës, me vargje që ajo s'i kishte dëgjuar ndonjëherë. Në fund të pjesës së parë rezultati ishte ende zero me zero dhe zyshë Keni shpërndau lëngje frutash në kuti dhe energy bar. Për pjesën e dytë u këmbyen fushat dhe sulmuesit e shkollës po luanin aty pranë ku po rrinte Mariana. Konell Ualdroni ishte në qendër, para. Ajo mund ta shihte tek rrinte me uniformën e futbollit, pantallonat e bardha të shndritshme, fanella e shkollës me numrin nëntë në kurriz. Kishte posturë shumë të mirë, më të mirë se gjithë lojtarët e tjerë. Figura e tij ishte si një vizë e drejtë dhe elegante e bërë me penel. Kur topi lëvizte në gjysmëfushën e tyre, prirej të vraponte pak përreth e mbase të ngrinte një dorë në ajër dhe mandej kthehej të rrinte sërish i palëvizur. Ndillte kënaqësi ta shihje dhe ajo nuk mendonte se ai e dinte apo se i plaste për vendin ku ajo po rrinte. Ndonjë ditë pas mësimit mund t'i thoshte se ka qenë duke e parë dhe ai do të qeshte me të e do ta quante të çuditshme.

Në minutën e shtatëdhjetë, Aidan Kenedi mori topin nga e majta e fushës dhe ia krosoi Konellit, i cili qëlloi nga këndi i zonës së penalltisë, përmbi kokat e mbrojtësve dhe topi u rrotullua e përfundoi në rrjetë. Të gjithë ulëritën, edhe Mariana,

dhe Karenin i zgjati krahun përreth belit dhe e shtrëngoi. Po brohorisnin së bashku, kishin parë diçka të magjishme, e cila shpërbëri marrëdhënien e zakonshme shoqërore mes tyre. Zyshë Keni po fërshëllente dhe po përplaste këmbët. Në fushë, Konelli dhe Aidani u përqaftuan si vëllezër të ribashkuar. Konelli ishte aq i bukur. Marianës i shkoi ndër mend se sa shumë dëshironte ta shihte duke bërë seks me dikë; s'kishte pse të ishte ajo, mund të ishte kushdo. Do të ishte bukur vetëm ta shihte. Ajo e dinte se këto lloje mendimesh e bënin ndryshe prej të tjerëve në shkollë dhe më të çuditshme.

Dukej se të gjithë shokët dhe shoqet e klasës të Marianës e pëlqenin shkollën dhe se për ta ishte normale. Të visheshin çdo ditë me të njëjtën uniformë, të pajtoheshin gjatë gjithë kohës me rregulla arbitrare, të ishin të monitoruar dhe të kontrolluar imtësisht për sjellje jo të duhura, kjo ishte normale për ta. Nuk e kuptonin shkollën si një ambient shtypës. Vitin e kaluar, Mariana pati një debat të zhurmshëm me mësuesin e historisë, mësues Keriganin, pasi ai e zuri duke parë nga dritarja gjatë orës së mësimit dhe askush në klasë nuk mbajti anën e saj. Atëherë i dukej aq e qartë se ishte çmenduri fakti që çdo mëngjes i duhej të vishej me të njëjtin kostum, të ballonte përreth një godine të madhe gjatë tërë ditës dhe të mos i lejohej as të lëvizte sytë aty ku donte, edhe lëvizjet e syve ishin nën juridiksionin e rregullave të shkollës. Po të shohësh jashtë dritares duke ëndërruar me sy hapur, nuk do të mësosh, i tha mësues Kerigani. Mariana, e cila e kishte humbur qetësinë atëherë, ia ktheu aty për aty: Mos e gënje veten, nuk kam asgjë çfarë të mësoj prej teje.

Konelli tha tani vonë se e mbante mend incidentin dhe se atë kohë i qe dukur se u soll shumë ashpër me mësues Keriganin i cili, në fakt, ishte një prej mësuesve më të arsyeshëm. Por e shoh ku e ke fjalën, shtoi Konelli. Rreth ndjesisë se je pak si e burgosur në shkollë, e shoh këtë. Duhet të të kishte lejuar të shihje nga dritarja, këtu jam dakord. Nuk po bëje asnjë dëm.

Pas bisedës së tyre në kuzhinë, kur ajo i tha se e kishte qejf, Konelli filloi të vinte më shpesh në shtëpinë e saj. Do të arrinte më herët për të marrë të ëmën nga puna dhe sillej nëpër dhomën e ndenjjes pa folur shumë, ose rrinte pranë oxhakut me duart në xhepa. Mariana asnjëherë nuk e pyeti pse ka ardhur. Flisnin pak, ose ajo fliste dhe ai pohonte me kokë. Ai i tha se ajo duhej të përpiquej të lexonte Manifestin komunist, mendoj se do t'i pëlqente dhe u ofrua t'i shkruante titullin që ajo të mos e harronte. E di si quhet Manifesti komunist, tha ajo. Ai ngriti supet, dakord. Pas një çasti shtoi, duke buzëqeshur: Po përpiquej të sillesh si superiore, por, si të thuash, as nuk e ke lexuar. Asaj atëherë iu desh të qeshte dhe ai qeshi pas saj. Nuk mund ta shihnin njëri-tjetrin teksa qeshnin, sytë duhej t'i mbanin te këndi i dhomës ose te këmbët e tyre.

Konelli dukej se e kuptonte se si i dukej shkolla asaj; i tha se i pëlqente të dëgjonte opinionet që kishte. Dëgjon mjaft prej tyre në klasë, tha ajo. Me një ton të thjeshtë dhe pa emocion, ai u përgjigj: Ti sillesh ndryshe në klasë, nuk je vërtet ashtu. Dukej se mendonte që Mariana mund të qasej në një sërë identitetesh të ndryshme, ndërmjet të cilave ajo rrëshqiste pa mundim. Kjo e befaso, pasi zakonisht ndihej e izoluar brenda një personaliteti të vetëm, i cili ishte përherë i njëjti pavarësisht asaj çfarë bënte apo thoshte. Në të shkuarën qe përpjekur të ishte ndryshe, si një lloj eksperimenti, por asnjëherë nuk kishte funksionuar. Në qoftë se ishte ndryshe me Konellin, ndryshimi nuk po ngjante brenda saj, në personin e saj, por në të ndërmjetmen mes tyre, në dinamikë. Ndonjëherë ajo e bënte atë të qeshte, por ditë të tjera ai ishte i heshtur, i pakuptueshëm dhe kur ikte, ajo ndihej njëherazi euforike, nervoze, energjike dhe tmerrësisht e shtuar.

Në tetor të vitit 1962, kur “Ivan Denisoviç” ende nuk ishte botuar, por nga lart po vinin shpresa se ishte miratuar dhe do të dilte në numrin e ardhshëm, ndërkohë që “e gjithë Moskë” sigurisht e kishte lexuar tashmë, Koplevët më pyetën: “A do të doje të takoje Anna Andrejevna Ahmatovën?” Unë madje u trondita: nuk isha gati për një takim të një niveli të tillë. A do të pranonte ajo të më takonte? Më siguruan se po — ja, për shembull, i kishte pritur edhe ata. Dhe menjëherë Koplevi filloi t’i telefononte — nga toni nuk dukej aspak i turpshëm dhe kuptohej që nga ana tjetër përgjigjeshin me miratim. U morën vesh. Të nesërmen, më 29 tetor, në mes të ditës, po shkoja në rrugën Novo-Horoshevskoe, në një oborr gjysmë-barakë shkrimtarësh, ku A.A. po qëndronte tek Maria Sergejevna Petrova.

Po shkoja i emocionuar: për herë të parë në jetën time do të prekja drejtpërdrejt letërsinë e vërtetë ruse — në fakt, askush tjetër nuk kishte mbijetuar deri në atë kohë, vetëm ajo. Letërsia, që më dukej prej kohësh e vrarë dhe e ndërprerë, rezultoi se ende kishte mbijetuar për të më shtrënguar dorën si një bekim për rrugën time.

Natyrisht, jo për të më shtrënguar dorën — unë po shkoja që të filloja me një puthje të respektueshme dhe të vëmendshme të dorës së saj. Por ja gabimi: nuk më shkoi ndër mend të pyes Koplevët se si dukej tani A.A. Nuk mendoja se mund të mos e njihja; prisja me siguri një plakë të hollë, të errët, të rraskapitur nga përndjekjet e Zhdanovit, të tharë nga një jetë e rëndë. Por ja: dera u hap, hyra në një korridor të vogël, prej tij dy dyer të tjera, dhe në secilën qëndronte nga një grua, të dyja buzëqeshnin. Në të majtë — një grua shumë e plotë, flokëthinjur, trupmadhe — dhe mendova se ajo duhet të ishte M.P. Ndërsa drejt përballë — ajo i përshtatej më shumë imazhit që kisha në mendje, ndoshta A.A.? Hezitova dhe fatmirësisht nuk gabova, nuk ndodhi ndonjë siklet. Zonja e plotë më ftoi me siguri në dhomën e saj, por puthja e dorës që kisha menduar nuk ndodhi. Për më tepër, nuk kisha as lule — pas viteve në kamp dhe nga varfëria, një zakon i tillë nuk ekzistonte më tek unë. Shkuam dhe u ulëm në divan.

Thashë frazën që kisha përgatitur, duke e thjeshtuar me tonin tim solemnitin e saj, por kjo ishte pikërisht ajo që ndjeja:

- Më jepet rasti të prek letërsinë e mirë të vjetër. Pra, shkretëtira dhe errësira, janë kaluar!

Ajo u përgjigj:

- Kjo tingëllon fisnike, por në të vërtetë gjithçka e shtrembërojnë.

Biseda mori menjëherë një drejtim të trishtuar. Ajo përdori një krahasim të tillë për jetën e saj: “si një gropë vorbulle me gjysmën e një maceje të vrarë”. (E kam shënuar saktësisht atë mbrëmje, edhe pse sot nuk e kuptoj plotësisht.) Tha se kishte dhënë “një intervistë të vetme në jetë për një korrespondent anglez dhe gjithçka u shtrembërua”. Në Perëndim shkruajnë për të “poezi alkovi”, “heshtje e çuditshme për kaq shumë vite” — “por unë as nuk mund të përgjigjem”. Një botues amerikan i veprave të plota të Gumiljovit “shkroi rreshta të turpshëm rreth një poezie të Gumiljovit për një grindje”, sikur ata të ishin ndarë prej kohësh dhe ia dërgoi asaj korrekturën. Dhe çfarë t’i përgjigje?

Unë atëherë ende nuk isha futur aspak në mjedisin letrar, nuk mund ta vlerësoja dhe përfshija gjendjen e Ahmatovës përballë gjithë vulgaritetit perëndimor dhe keqkuptimit të rëndë — “heshtje e gjatë”! Veç kësaj (këtë e kuptova më vonë, ne nuk folëm për këtë): disa ditë më parë ajo ishte anashkaluar për Çmimin Nobel, për të cilin e kishin propozuar italianët (atë vit iu dha Steinbeck-ut) dhe nuk ishte vetëm ai vit që

ANNA AHMATOVA

Ese nga Aleksander Solzhenicin

Botimi, përgatitja e tekstit,
shënimi hyrës nga bashkëshortja e shkrimtarit,

Natalia Dimitrievna Solzhenicina

Në Arkivin e A.I. Solzhenicinit ruhet një fletore e trashë, e titulluar “Takime dhe shënime letrare”. Fletorja është nisur në korrik të vitit 1962 dhe në të A.S. ka regjistruar me shumë hollësi takimet dhe bisedat me A.T. Tvardovskin, diskutimet mbi dorëshkrimet e “Ivan Denisoviçit”, “Matrenës”, “Rrethit”, “Pavijonit të kancerozëve” në redaksinë e “Novyj Mir”, e më pas edhe në mbledhjen e Sekretariatit të Lidhjes së Shkrimtarëve — pikërisht kjo hollësi e shënimeve siguroi më vonë saktësinë faktologjike të “Eseve të jetës letrare” (“Viçi u përplas me lirin”). Në fletore gjenden edhe shënime të takimeve me A.A. Ahmatovën, B.A. Mozhaevin, V.T. Shalamovin, trupën e teatrit “Sovremennik” etj. Disa prej tyre janë bërë shkurt, gjatë udhëtimit, në fletëza të vogla nga blloqe shënimesh, të cilat më pas janë ngjitur në fletore.

Në verën e vitit 1981, në Vermont, Solzhenicini lexon me pasion vëllimin e dytë të “Shënime për Anna Ahmatovën” (1952–1962), të botuar së fundmi në Paris, i përgjigjet atyre në një letër drejtuar L.K. Çukovskajës dhe përmend, ndër të tjera, shënimet e tij “menjëherë pas ngjarjes”:

“Në shënimin e datës 30.10.62 lexova për herë të parë se çfarë përshtypjeje kishte pasur Ahmatova nga takimi me mua. Më bëri të ndihem i vlerësuar dhe i ngrohtë kur e kujtova atë takim. Ka pasur disa të tilla, por ende nuk kam gjetur kohë t’i përshkruaj, ndonëse

Akademia Suedeze e kishte anashkaluar — cilin nga shkrimtarët rusë janë ata të aftë ta vlerësojnë në kohën e duhur?

Anna Andrejevna tha me vendosmëri:

- Unë preferoj Zhdanovin: të paktën, gjithçka është e qartë. Ndërsa atje [në Perëndim] as nuk mund ta kuptosh, një rrëmujë dhe pa kuptim.

(Këtë e kam shënuar fjalë për fjalë. Por atëherë isha ende larg të kuptuarit plotësisht të saktësisë së fjalëve të saj dhe faktit që Ahmatova po më paralajmëronte qartë për atë që do të më duhej të mësoja gjatë një çerek shekulli.)

Çfarë mund t’i sillja si ngushëllim? Nga zemra:

- Për mua: Pushkini, Lermontovi, Bloku — dhe ju!

Ajo buzëqeshi gjerësisht:

- Do të më prishni.

Iu përgjigja Tvardovskit se tashmë është vonë të më prishin mua, e aq më pak ju!

Ajo tha se kishte kaluar tashmë infarktën e tretë. Jeton duke përkthyer poetë kazakë, sipas përkthimeve ndërmjetëse. Përkthime me përgjegjësi të madhe, si ato të Shekspir — i shmang.



kam bërë shënime menjëherë pas tyre dhe ato ekzistojnë ende. Ndoshta, kur të jem më i lirë, do t’u rikthehem. Nëse jeta më mjafton. Por, sa herë që e kujtoj veten, detyrat që kam marrë mbi supë gjithmonë kanë qenë më të mëdha se sa koha për t’i përmbushur.”

Në përgjigjen e saj, Lidija Kornejevna shkruan: “Jam e bindur se shënimet tuaja për takimet me A.A. kanë një interes të jashtëzakonshëm.”

Pas gjashtë vitesh, Solzhenicini më në fund “gjeti kohë” për të përshkruar takimet e tij me Ahmatovën. Ai shkroi një ese më 6 qershor 1986 dhe nuk iu kthye më kurrë asaj. Për ekzistencën e këtij teksti dinte N.A. Struve, botues dhe mik

i kahershëm i A.S. Duke u përgatitur të shënonte 100-vjetorin e Ahmatovës në revistën që ai botonte, Struve i shkruante Solzhenicini:

“Kam ndërmend të botoj për gjysmën e parë të vitit 1989 dy numra, ku i dyti do t’i kushtohet në një masë të madhe Ahmatovës, dhe këtu nuk mund të mos ju pyes nëse do të pranoni (edhe pse pa shumë shpresë për një ‘po’) të jepnit disa kujtime të shkurtra për takimin me të? E di që i konsideroni të papërpunuara, por ndoshta mund të paraqiten pikërisht si një përgjigje ndaj kërkesës së redaksisë për të ndarë kujtime me rastin e 100-vjetorit.”

Solzhenicini nuk e konsideroi esenë e tij të denjë për korin jubilar: “Tani ju pyesni nëse do të jap esenë për Ahmatovën? — jo, ajo është e dobët, e papërpunuar (dhe ndoshta nuk do të përpunohet më kurrë...)”

Megjithatë, në “Koleksionin letrar” autori e përfshiu esenë, duke e vendosur në rubrikën “Disa takime të mia letrare. (Sipas shënimeve të po atyre ditëve)”.

Në këtë numër të “Fletoreve”, ne i ofrojmë lexuesit botimin e parë të esesë “Anna Ahmatova”. Teksti botohet sipas dorëshkrimit që ruhet në Arkivin e A.I. Solzhenicinit. Dorëshkrimi, me shumë shtesa, fshirje dhe riorganizime, përbën redaktimin e parë dhe të vetëm të esesë.

heshtjeje — çfarë të zgjidhni? Çfarë rëndësie ka? — të gjithë janë njësoj.

Si “progresistët”, ashtu edhe “reaksionarët” — të gjithë i kuptoja atëherë drejt si shërbëtorë të rremë dhe të përkulur të regjimit sovjetik.

Nga çanta nxori edhe atë fotografi të saj të re, me balluke të rralla, nga e cila ishte marrë ai portret tipografik. Oh, sa e ndryshme ishte tashmë, sa larg nga ajo vajzë.

Tha:

- Gjithmonë përpiqem të shkruaj më shkurt. Më duket se vargjet janë ende të gjata, edhe tetë rreshta janë shumë.

E jashtëzakonshme! Ky është kulmi.

E nxita të përqendronte të gjitha forcat në përgatitjen e përmbledhjeve dhe cikleve.

Për “Ivan Denisoviçin”: duhet që këtë vepër ta lexojnë 200 milionë njerëz. Në të “nuk ka thjeshtë vëzhgime, gjithçka i shërben një qëllimi”. (E krahasoi me Heminguejin: peshku pështyn dy herë, por asgjë nuk del më pas prej kësaj.) Që nga cilat vite shkruani?

- Është për të qeshur, por pothuajse që në moshën 9-vjeçare vendosa se do të bëhesha shkrimtar.

- Ashtu duhet të jetë.
- (Dhe vërtet kështu është!)
- A keni ndonjë tregim tjetër?..
- Unë...

Këtu u ngatërrova. Përmbajtje nga përvoja e kampit. Ato që ishin tashmë në "Novyj Mir" — po, dy tregime. Por që kisha një roman të gatshëm ("Rrethi"), dhe që kisha menduar e filluar një përmbledhje sistematike të gjithë sistemit të kampeve ("Arkipelagu") — këtë nuk e thashë. (Më vonë L.K. Çukovskaja do të më qortonte për këtë fshehtësi: "Anna Andrejevnës mund t'i besojë — dinte të ruante sekrete si askush tjetër".)

- Do të shpërnguleni në Moskë?
- Jo, nuk mendoj. Nuk më tërheq Moska.
- Ju presin sprovë të ashpra nga fama. Pasternaku nuk i përballoi.

Unë, me siguri, do t'i përballoj, madje nuk e kuptoj çfarë ka për të përballuar këtu?

- Dyzet e katër vjeç? Kjo është shumë pak, sa i ri jeni.

U ndamë shumë ngrohtë. Me Petrovan nuk biseduam fare (thonë se është e jashtëzakonshme).

Një muaj më vonë, më 30 nëntor, me ftesë të A.A., isha përsëri tek ajo, këtë herë në banesën e Glenit, redaktore së Goslitizdatit. (Në Moskë A.A. nuk kishte një vend të vetin; qëndronte si mysafire herë tek njëri, herë tek tjetri, duke u zhvendosur që të mos i rëndonte shumë të tjerët dhe gjithmonë duke e ndierë veten pa shtëpi.)

A.A. donte të më takonte si thjesht, ashtu edhe për një qëllim të veçantë: përmbledhja e vetme pasluftës e saj, "Poezi", ishte botuar me kopertinë të zezë, ndërsa seria e vogël, me të bardhë. Këtë të fundit ajo e ruante për të përzgjedhurit dhe tani nxori edhe një kopje. Ma dedikoi para syve të mi: "A. Solzhenicinit në ditët e famës së tij". (Duke parashikuar me arsye se do të ishin vetëm ditë.) — Sulmi dhe presioni ndaj jush, janë të gjitha përpara, ky është vetëm fillimi. Por edhe unë e shihja kthjellët se sa shpejt do të ndërpritej vrulli i famës dhe i kureshtjes ose, më saktë, do të shndërrohej në armiqësi — për këtë nuk kisha asnjë iluzion. Sigurisht, edhe unë i solla një kopje të botimit në revistë të "Denisoviçit". Nuk e mbaj mend si e firmosa, por duket se nuk gabova, sepse ajo tha me pak pakënaqësi:

- Tani mua më firmosin pa mbiemër.

Domethënë vetëm me emër dhe atësi? Me sa duket, ajo e vlerësonte "Ahmatova"-n. Nuk e pyeta kurrë pse kishte marrë një pseudonim tatar. Ajo tregonte se në teatrin "Sovremennik" aktorët e rinj i kishin zili më të vjetrit, të cilëve unë u kisha lexuar një "dramë gjeniale". (E tillë ishte jehona e famës sime dhe e temës së kampeve — sipas përmasave sovjetike "gjeniale" quhej tashmë ajo që nuk ishte e sajuar, por e shkruar me gjakun e zemrës. Lexuesi rus ishte lodhur aq shumë, sa kishte etje për "gjenialitet".)

- Në Moskë, në hollësi, është përhapur biseda jonë: çfarë më thatë ju mua, çfarë ju thashë unë.

- Këtë sigurisht nuk e kam bërë unë! Unë thjesht nuk i kam treguar askujt.

Duke buzëqeshur me njëfarë dinakërie:

- Ndoshta nga unë... (Ja kështu t'ju besosh sekrete! Jo, kalitja ime nga kampet nuk do të dorëzohet. Për takimet dhe bisedat tona, A.A. vërtet tregonte gjerësisht, dhe nga ata që e dëgjonin, disa më vonë i shkruan versionet e tyre në kujtime, duke shtuar edhe trillime dhe shtrembërime.)

Dhoma e tanishme ishte tri herë më e vogël se ajo ku ishim takuar herën e parë: muret dukej sikur ngushtoheshin rreth Ahmatovës, duke shprehur gjithnjë e më shumë kufizimin e jetës së saj. Dhe ajo ishte e sëmurë — e veshur, por shtrirë, ndërsa unë rrija ulur pranë divanit. Tha se jetonte më mirë në shtëpinë e krijimtarisë



në Komarovo, ku ishte qetësi; a nuk do të doja të shkoja edhe unë atje? (Por unë nuk u nxitova kurrë ta përdorja dhe gjatë viteve nuk e përdora asnjëherë këtë "të drejtë" shkrimtari. Mbete i huaj për atë mjedis dhe zakonet e tij.)

Këtu Anna Andrejevna tha: "Unë jam pushkiniste me profesion" — (nuk e dija fare!) — dhe kishte arritur të zbulonte disa gjëra për të cilat ishte krenare. (I lexova vetëm shumë vite më vonë, në Vermont. Rezultoi se ishin studime tekstologjike ose mbi fatin personal, por me një përmasë dhe rëndësi të madhe.)

Shënimet e këtij takimi, për fat të keq, nuk janë të detajuara: i kam shkruar në një bllok të vogël, diku rrugës, në metro ose në tren elektrik. Folëm për muzikën. Ajo e donte shumë Musorgskin, u pajtuam për Beethovenin, Shubertin dhe Shopenin. (Mozarti nuk figuron në shënimet e mia, nuk e di pse.)

Ajo tregoi për vdekjen e Gumiljovit dhe se si gjithë çështja e tij ishte e sajuar (4–25 gusht 1921).

Papritur pyeti:

- A e njihni Bulgakovin? Si e vlerësoni atë?

U gjallërova menjëherë: si jo! Ai është një dashuri e veçantë për mua, që nga "Turbinët", që para luftës. Madje në "Aleksandrinka" kisha parë edhe "Arratisjen". Ndjej me të një afërsi shpirtërore.

- A dëshironi të njiheni me vejushën e tij?

U gëzova shumë.

Menjëherë, pranë divanit, ishte telefoni; ajo formon numrin:

- Elena Sergejevna! Tek unë është ulur tani më i madhi. Më kryesori dhe më i

popullarizuar në Moskë. E kuptuat? Ai dëshiron të njihet me ju, po ia jap receptorin.

Duket se A.A. kishte një qëndrim disi të ftohtë ndaj E.S. Por unë isha jashtëzakonisht i lumtur. Dhe kjo pati vazhdim.

Anna Andrejevna shtoi menjëherë:

- Ju jeni më i fortë se Bulgakovi.

A donte të më inkurajonte? A ekziston gjithmonë një llogaritje e tillë midis shkrimtarëve? Por kjo nuk përputhej me ndjenjat e mia ndaj Bulgakovit: nuk doja të krahasohesha me të, por ta vazhdoja — vijën e "Gardës së Bardhë".

Më 14 shkurt 1963 e vizitova përsëri A.A. — këtë herë në banesën e Ardovëve, në Zamoskvoreçje, dhe kjo nuk ishte më një dhomë, por një lloj qelie burgu: midis derës dhe një dritareje të vogël ishte vendosur një shtrat përgjatë murit, që zinte dy të tretat e gjerësisë; A.A. rrinte ulur në shtrat, ndërsa unë — në të vetmen karrige për vizitorin, aq sa gjunjët më mbështeteshin te shtrati.

Ashtu si A.A. jetonte në Moskë si mysafire, gjithmonë tek të tjerët — po ashtu edhe unë vija shpesh, pa pasur ku të qëndroja, vija nga Rjazani për pak ditë e orë, bëja gjithçka me ritëm të shpejtë, intensiv dhe gjithçka vetëm punë. Dhe në këtë ritëm bëra një gabim të pafalshëm. Pa arritur të kuptoja sa i pazëvendësueshëm ishte për mua ky kontakt me Ahmatovën, sa shumë traditë dhe të kaluar mund dhe duhej të merrja prej saj — këtë herë vendosa t'i verifikoj A.A.-së mendimin e Tvardovskit për "Dorogjenkën". Pra, as unë vetë nuk e konsideroja një arritje poetike, por ndoshta kompensohej nga përmbajtja? Doja të merrja një mendim vendimtar. Dhe i kërkova leje t'i lexoja pjesë nga poema. Ajo dëgjoi pa u shqetësuar — ndërsa unë lexoja kapitullin e parë, pastaj

të dytin, mbase edhe një pjesë nga i treti. Ajo nuk më ndali, por unë ndjeva: nuk ishte e duhur, ishte e papërshtatshme, madje e turpshme të lexoja kështu.

Ajo tha:

- Nuk duhet një zhvillim kaq linear. Në poezi duhet të ketë mister. Është tepër i drejtpërdrejtë, çfarë është kjo — biografi. Ka rrokje të tepërta. Është interesante (ndoshta vetëm sepse është nga ju), por e zgjatur. Megjithatë, për mua tani gjithçka është e zgjatur që ka më shumë se katër vargje. Proza juaj është e mbrojtur në mënyrë të shkëlqyer, ndërsa kjo, është e pambrojtur, mos e botoni tani.

U ndieva në siklet që i kisha marrë aq shumë kohë.

Janë shënuar fjalët e saj nga ai takim, pa një lidhje të vazhdueshme:

- Letra nga lexuesit? Marr më shumë kërkesa për para. Ju ende nuk ju dërgojnë?

- Poezia gjithmonë i "sulmon" prozën dhe i rrëmben pjesë... "Evgeni Onegini", si një tra ndalues, ua ka mbyllur rrugën të gjithëve — Lermontovit, Baratynskit, Blokut me "Hakmarrjen". Ta anashkalojë këtë pengesë arriti vetëm Nekrasovi. Lirika e tij është e dobët, por ka poema të mrekullueshme — "Ngrica, Hunda e Kuqe". Ai është një poet i jashtëzakonshëm, i ndotur nga epoka, nga koha.

Ky gjykim për Nekrasovin ishte shumë i papritur për mua: isha mësuar ta anashkaloja dhe ta përçmoja për lidhjet e tij me demokratët revolucionarë.

Ajo tregoi edhe për veten. Në vitin 1925 u mor një vendim i veçantë dhe Ahmatovës iu ndalua botimi. Trockistët Lelevič dhe

Analiza me inteligjencë artificiale zbulon se si një nuse e shekullit XV u detyrua të zgjidhte midis parave të familjes dhe burrit që dashuronte

Letra më e vjetër e dashurisë në botë, e deshifruar pas 540 vjetësh, zbulon dilemën: dashuria kundrejt parave

Nga Shivali Best
redaktore e shkencës dhe teknologjisë

Letra më e vjetër e dashurisë në botë është deshifruar pas 540 vitesh, duke zbuluar një dilemë klasike – dashuria kundrejt parave.

Ekspertë nga MyHeritage përdorën mjetin e tyre të ri Scribe AI për të analizuar letrën, e cila ishte shkruar në shkurt të vitit 1477.

E shkruar nga një grua e quajtur Margery Brews për të fejuarin e saj, John Paston III, letra aludon për marrëveshjet e pajës për martesën e tyre të afërt.

Megjithatë, siç mund të shihet edhe nga imazhi më poshtë, ajo është e vështirë për t'u deshifruar.

Letra është shkruar në një stil joformal, me disa elemente personale dhe "pa ndonjë kujdes të veçantë për njëtrajshmërinë e drejtshkrimit".

Fatmirësisht, inteligjenca artificiale arriti të analizojë tekstin dhe të zbulojë kuptimin e tij në gjuhën e sotme.

"Shumë letra historike janë të vështira për t'u interpretuar nga lexuesit modernë që në shikim të parë," shpjegoi një zëdhënës i MyHeritage.

"Por përmbledhja e informacionit thelbësor shpjegon shpejt personat, emocionet, kontekstin historik dhe rëndësinë e dokumentit."

Letra e dashurisë është pjesë e "letrave Paston" – një koleksion i jashtëzakonshëm që përmban mbi 400 letra, të shkruara gjatë tre brezave nga një familje në Norfolk.

Ndërsa familja Paston u ngrit nga fshatarësia në një aristokraci të ulët, letrat pasqyrojnë lëvizjen shoqërore të asaj kohe.

Shumë prej tyre – përfshirë edhe letrën e dashurisë – janë shkruar nga gra, ndërsa disa janë shkëmbyer mes të afërmeve ose njerëzve që njiheshin mirë me njëri-tjetrin.

Në shikim të parë, do të vini re se shkrimi i letrës së dashurisë nuk është i lehtë për t'u deshifruar.

Znj. Brews përdori shkronjën anglosaksone thorn, si dhe disa shkurtime të vjetra, përfshirë një shenjë mbi një shkronjë për të treguar mungesën e "m"-së dhe shenja të ndryshme të vendosura sipër shkronjave.

"Gjuha mund të duket e panjohur për lexuesit modernë, sepse drejtshkrimi, gramatika dhe shqiptimi ishin shumë të ndryshme nga anglishtja që përdorim sot," shtoi zëdhënësi i MyHeritage.

Studiuesit i dhanë një imazh të letrës mjetit Scribe AI, i cili arriti shpejt të deshifrojë kuptimin e saj të vërtetë.

Sipas këtij sistemi, letra është shkruar në Topcroft në shkurt të vitit 1477, i cili më vonë është shënuar si shkurt 1476/7.

Pasardhësit e tyre, të identifikuar më parë përmes MyHeritage, u lidhën me çiftin përmes brezave të mëvonshëm dhe disa prej tyre ndanë reflektimet kur mësuan për lidhjen e tyre me këtë letër.

Znj. Brews i shkruan të fejuarit se ka një "zemër plot e rënduar", pasi nëna e saj nuk ka arritur ta bindë të atin të rrisë pajën e saj.

Megjithatë, ajo e siguron John-in për dashurinë e saj, duke thënë se nuk do ta braktiste edhe sikur ai të kishte "gjysmën e të ardhurave" që kishte.

Ajo gjithashtu i kërkon që ta mbajë letrën private. Fatmirësisht, në fund gjithçka shkoi mirë për Margery-n dhe John-in, të cilët u

martuan dhe patën një djalë, William, në vitin 1479.

Fatkeqësisht, Margery vdiq në vitin 1495 dhe John në vitin 1503.

Pasardhësit e tyre, të identifikuar më parë përmes MyHeritage, u lidhën me çiftin përmes brezave të mëvonshëm, dhe disa prej tyre ndanë reflektimet kur mësuan për lidhjen e tyre me këtë letër.

"Vërtet të kujton se njerëzit që studiojnë shumë të ngjashëm me ne," tha Rob Edwards, i cili vetë është arkeolog.

"Ata kanë të njëjtat ndjenja, dhe fakti që janë të afërm e shton një dimension tjetër.

Mund ta imagjinosh, duke u përpjekur të marrësh pak më shumë për martesën nga prindërit. Këto para do të të sigurojnë fillimin e jetës." Një tjetër pasardhës, Richard Buckworth-Herne-Soame, shtoi:

"Ne ende e kemi atë kokëfortësi."

Letra e dashurisë: Transkriptim i plotë

Letra LXXII, f. 210

I nderuari dhe i respektuari im shumë i dashur Valentin, ju përshëndes me gjithë zemër, duke dëshiruar të dëgjoj për mirëqenien tuaj, të cilën i lutem Zotit të Plotfuqishëm ta ruajë gjatë, sipas vullnetit të Tij dhe dëshirës së zemrës suaj. Dhe nëse ju pëlqen të dëgjoni për gjendjen time, nuk jam mirë as nga trupi, as nga zemra, dhe nuk do të jem derisa të dëgjoj nga ju, sepse askush nuk e di çfarë dhimbjeje po përjetoj. Dhe, për të thënë të vërtetën, nuk guxoj ta shpreh plotësisht.

Dhe zonja ime, nëna ime, e ka trajtuar këtë çështje me tim atë me shumë përkushtim, por nuk mundi të arrijë më shumë se sa ju e dini, për çka Zoti e di se jam shumë e trishtuar. Por nëse më doni, siç besoj vërtet se më doni, nuk do të më lini për këtë arsye, edhe sikur të kishit vetëm gjysmën e pasurisë që keni; do të bëja punën më të madhe që mund të bëjë një grua në jetë, dhe nuk do t'ju braktisja.

Dhe nëse më urdhëroni të qëndroj besnike kudo që të shkoj, ju siguroj se do të bëj gjithçka që kam në dorë për t'ju dashur dhe askënd tjetër më. Dhe nëse miqtë e mi thonë se po veproj gabim, ata nuk do të më ndalojnë, sepse zemra ime më urdhëron gjithmonë t'ju dua me besnikëri mbi çdo gjë tokësore. Dhe edhe nëse ata zemërohen shumë, besoj se në kohën që vjen gjithçka do të jetë më mirë.


Nuk kam më shumë për t'ju thënë në këtë kohë, por Trinia e Shenjtë ju ruajtë. Dhe ju lutem që kjo letër të mos shihet nga asnjë krijesë tjetër tokësore përveç jush.

Kjo letër është shkruar në Topcroft, me zemër shumë të rënduar.

E juaja përgjithmonë,

M. B.

Shkurt 1476 (sipas kalendarit të kohës).





NATSUME SOSEKI

Vigjilja e Njëqind Viteve

Përktheu:
Artemisa Kuznetsov

Këtë pashë në ëndërr.

Isha ulur pranë shtratit të saj me duart e mbledhura, kur ajo, ashtu e shtrirë në shpinë, më tha me zë të qetë se do të vdiste.

Flokët e saj të gjatë ishin derdhur mbi jastëk, duke rrethuar fytyrën ovale me tipare të holla.

Një skuqje e lehtë i kish skuqur mollëzat e bardha, ndërsa buzët i kuqëlonin krejt natyrshëm.

Ajo nuk dukej sikur po vdiste. Megjithatë, me zërin e saj të qetë tha qartë se do të vdiste. Edhe unë, në atë çast, mendova se mund të vdiste me të vërtetë. Prandaj, duke e vështruar, e pyeta nëse ishte e vërtetë që ajo do të vdiste. Ajo hapi sytë gjerësisht dhe pohoi se do të vdiste.

Sytë e saj të mëdhenj e të lagësht, të rrethuar nga qerpikë të gjatë, ishin pis të zinj. Reflektimi im notonte me një qartësi të gjallë brenda të zezës së thellë të irisëve të saj.

Ndërsa zhytesha në brendinë vezulluese të syve të saj, pyeta veten sërish nëse po vdiste vërtet. Me kujdes, afrova gojën pranë jastëkut të saj dhe e pyeta përsëri nëse nuk do të jetonte, nëse nuk do të ishte mirë. Ajo, me sytë e saj të errët, të hapur gjerë e të sflitur, m'u përgjigj qetësisht se do të vdiste, se duhej të vdiste.

I brengosur, e pyeta nëse mund ta shihje fytyrën time. Ajo më buzëqeshi dhe më tha se po, a nuk po e shihja veten time të reflektuar në sytë e saj? U largova heshturazi nga jastëku i saj. Duke kryqëzuar krahët, po bluaja me vete nëse vërtet ishte e thënë që ajo të vdiste.

Pas pak, gruaja foli sërish.

- Të lutem, më varros pasi të kem ndërruar jetë. Gërmoje varrin tim me një guackë të madhe perle. Vendos një copëz ylli, të rënë nga qiejt, mbi varrin tim si shenjë. Pastaj, qëndro e prit pranë varrit tim. Prit derisa unë të kthehem.

E pyeta kur do të kthehej.

- Ti e di që dielli do të lindë. Dhe e di që ai do të perëndojë. Do të lindë sërish e do të perëndojë sërish. Dielli i kuq do të shtegtojë nga lindja drejt perëndimit. Ndërsa ai shfaqet në lindje për t'u zhytur sërish në perëndim... a do të më presësh?

Iu përgjigja me një pohim të lehtë koke. Atëherë ajo foli sërish, me atë zërin e saj të qetë, por një notë më lart.

- Më prit për njëqind vjet, - tha me një ton të prerë. - Qëndro pranë varrit tim dhe më prit për njëqind vjet. Të premtoj se do të kthehem.

Iu përgjigja shkurt se do ta prisja. Teksa flisja, shëmbëlltyra ime, që dallohej aq qartë në ata irisë të zinj, nisi të thërrmohej. E kuptova se po shkonte,

si një imazh i pasqyruar mbi ujin e qetë që trazohet nga një lëvizje e papritur.

Pastaj sytë iu mbyllën dhe një lot i vetëm, duke rrëshqitur nga qerpikët e gjatë, i ra mbi faqe. Ajo kishte vdekur.

Dola në kopsht dhe gërmoja varrin e saj me një guackë të madhe perle, me skaje të mprehta e të lëmuara. Me çdo grusht dheu që hidhja, rrezet e hënës thyheshin mbi kurrizin e guackës, duke i dhënë një shkëlqim të magjishëm. Toka e lagur lëshonte një aromë të freskët, plot jetë. Pas pak, varri ishte gati. E shtriva trupin e saj brenda dhe e mbulova me kujdes me dheun e butë. Drita e hënës vazhdonte të rrezatonte mbi guackë me çdo lëvizje timen.

Më pas, mora copën e yllit të rënë, e solla te varri dhe e ula me kujdes mbi dhe. Ishte e rrumbullakët; mendova se skajet duhej t'i ishin lëmuar gjatë rënies së gjatë nga qiejt. Një ngrohtësi e lehtë më pushtoi kraharorin e krahët tekta e mbaja pranë vetes për ta vendosur në vend.

U ula mbi një shpat myshku. Me mendjen te pritja prej njëqind vitesh që më priste, kryqëzova krahët dhe ngula sytë mbi gurin e rrumbullakët të varrit. Dielli shkrepri në lindje, pikërisht ashtu siç kishte thënë ajo. Ishte një diell i madh e i purpurt. Pas pak, ai u zhyt sërish në perëndim, siç kishte thënë ajo. Ishte ende i kuq flakë ndërsa po uler.

Numërova: një.

Pa kaluar shumë, dielli i purpurt u ngjit sërish lart. Pastaj u zhyt sërish në heshtje.

Numërova: dy.

Teksa ditët rridhnin kështu, e humba fillin e diejve të përflakur që digjeshin mbi kokë. Sytë nuk i numëronin dot më perëndimet e panumërta, ndërsa njëqind vjetët dukej se nuk do të plotësoheshin kurrë. Më në fund, duke vështruar gurin e rrumbullakët që tani ishte veshur tërësisht me myshk, fillova të dyshoja se mos gruaja më kishte gënjer.

Pikërisht në atë çast, një filiz i gjelbër doli nga poshtë gurit dhe u zgjat drejt meje. Ai u rrit para syve të mi derisa m'u afrua pranë kraharorit. Për habinë time, në majë të asaj kërcelli të hollë e paksa të përkulur, që lëkundej me hir, hapi petalet e saj një lule e mahnitshme.

Përpara meje qëndronte një zambak i bardhë, i plotë. Aroma e tij më depërtoi gjer në shpirt. Atëçast, një pikë vese e rëndë zbriti nga lart dhe lulja u drodh nën peshën e saj. U përkula përpara dhe preka me buzë petalet e bardha, të njoma nga vesa e freskët. Teksa largoja fytyrën nga zambaku, instinktivisht ngrita sytë drejt lartësive të largëta dhe pashë një yll të vetëm që vezullonte në qiellin e agimit.

Atypari e kuptova: njëqind vjet kishin kaluar.

(Vijon nga faqja 21)

Selivanovski hodhën mbi të rrëke balte. Por në vitin 1939 Stalini pyeti për të — dhe menjëherë filluan ta botonin.

A do të arrijnë ndonjëherë pendët tona të përshkruajnë atë "liri të kuqe" të mallkuar të viteve '20 dhe gjysmës së viteve '30?..

Dhe përsëri, në verën e vitit 1963 isha në Leningrad dhe vizitova (këtë herë me bashkëshorten time N.A. dhe me një buqetë të madhe) A.A.-në në Shirokaja, ku ajo jetonte tek njerka e saj.

Ky takim nuk është shënuar nga unë, dhe për çudi nuk ka mbetur as në kujtesë, përveç një gjëje — sjelljes sime të vrazhdë. Pasi kisha lexuar tashmë "Rekuiemin" e saj, dhe në gjoks mbaja planin e plotë të ardhshëm të "Arkipelagut", i thashë:

- Mendoj se titulli "Rekuiem" nuk i përshatet kësaj poeme. Rekuiemi, sipas traditës, përfshin "Dies irae", Gjykimin e Fundit dhe tronditjen e universit; përmasa milionëshe. Dhimbja e vetmuar e një nëne — nuk është ende një rekuiem.

Jam i sigurt që e lëndova, dhe padrejtësisht. (Të tjerëve u kishte thënë se unë nuk e kuptoj përkufizimin e "rekuiemit".)

Në Paris ajo i tregonte N. Struve për takimet tona, ndër të tjera: "Më lexoi një poemë, i thashë - 'shkruani prozë, në të jeni i paprekshëm', - ai e priti mirë", - e gjitha kjo është e vërtetë, por: "Pas kësaj nuk u shfaq më." Domethënë u ofendua nga kritika? Jo, kjo nuk është e vërtetë për mua.

Pra, nuk e kishte kujtuar as takimin tonë të katërt në Leningrad. Ndoshta më mirë kështu? Atëherë nuk mbajti mend as çfarë thashë për "Rekuiemin"?

Nuk mund ta shpjegoj saktësisht pse nuk lindi tek unë një afërsi e qëndrueshme shpirtërore me A.A.-në, një nevojë për ta parë më shpesh dhe për t'u ushqyer shpirtërisht prej saj? — sepse unë e dua jashtëzakonisht shumë poezinë e saj. Në atë tension luftarak në të cilin ndodhesha atëherë, në atë mungesë hapjeje ndaj lëvizjes së lirë, nuk mora as një të njëzetën e asaj që mund të kisha marrë nga takimet me Ahmatovën.

Dhe që atëherë, nuk u pamë më kurrë, vetëm në qershor 1964 i dërgova një telegram për 75-vjetorin e saj. Më vonë, nga L.K. Çukovskaja mësova disa gjëra të shkëputura:

- A.A. vinte në dyshim mundësinë e "Rastit në stacionin Kreçetovka" (Stalingrad-Caricyn?.. çudi që askush nuk e beson, por ishte pikërisht kështu — kjo është epoka!).

- A.A. ishte fyer që nuk i dhashë të lexonte "kapitujt për takimin në burg" (ndoshta ato disa kapitujt nga "Rrethi", që si "Fragment" ia kisha propozuar Tvardovskit; ai i refuzoi dhe unë nuk i shtyva më përpara, por duket se fjala ishte përhapur).


- Më kritikonte që refuzova të firmos një letër në mbrojtje të Brodskit. (Unë as nuk e mbaja mend. Por vërtet më kishin kërkuar Etkindët dhe unë refuzova pa asnjë hezitim apo pendesë: duke mbajtur brenda vetes "Arkipelagun" dhe "Rotën e Kuqe", e konsideroja veten të lirë nga çdo "letër proteste". Një gjë është kur një i njohur imi, Zhores Medvedev, u mbyll në spital psikiatrik — atëherë reagoja fuqishëm; ndërsa këtu një i ri leningradas do të dërgohej në një internim të lehtë? — vetëm sa do të merrte pak nga jeta e vërtetë.)

L.K.Ç. më qortoi shumë që nuk ia kisha zbuluar Ahmatovës "Arkipelagun" (në vitet 1964-65 ai po shkruhej me intensitet të plotë): "A.A. gjithmonë ishte e kujdesshme ndaj spiunëve, ndonjëherë duke i parë edhe aty ku nuk kishte. Vërente ndjekjen. E mbajti 'Rekuiemin' pa e shkruar për 24 vjet! Kujdesi politik ishte mania e saj." Por, kam frikë se edhe unë kisha të drejtë: nëse A.A. fliste aq hapur edhe për detaje politike të bisedave tona.

Është e dhimbshme: një bashkatdhetare e madhe, një bashkëkohëse, një zemër kaq e madhe dhe kuptuese — dhe të mos hapesh para saj, të mos mundesh...

Kështu që, megjithëse u takuam disa herë, unë dhe A.A. — në thelb, sikur e humbëm njëri-tjetrin.

E përktheu Bujar Hudhri



Karikaturë nga Arben Mexsi

